

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

STRATEGJIA FISKALE E RISHIKUAR E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT PËR
PERIUDHËN
2024 – 2028

Shkup, dhjetor 2023

Rezyme e Strategjisë fiskale të rishikuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024-2028

Sistemi i menaxhimit të financave publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është i rregulluar me Ligjin e Buxheteve. Me këtë ligj, përveç procedurës së hartimit, miratimit dhe realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të buxheteve të njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe të Qytetit të Shkupit, për herë të parë janë përcaktuar rregullat fiskale numerike dhe parimet fiskale, themelimi i Këshillit Fiskal, avancimi i planifikimit buxhetor afatmesëm, risqet fiskale, përgjegjësia fiskale dhe bazat për krijimin e sistemit të integruar informativ të menaxhimit financiar.

Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe përforsimi i buxhetimit afatmesëm në 5 vitet e ardhshme janë një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pjesë e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Strategjia fiskale është përpiluar në përputhje me kornizën kohore të përcaktuar me dispozitat e ligjit të ri, respektivisht Ligjit të Buxheteve, ku për nga përmbajtja përfshin më shumë të dhëna cilësore dhe sasiore të mundësuarat përmes analizës sektoriale të shpenzimeve.

Për qëndrueshmërinë e politikës fiskale në periudhën afatmesme, projeksionet fiskale ofrojnë kornizë për arritjen e rregullave fiskale numerike, të cilat janë të projektuara që të jenë të harmonizuara dhe konsistente edhe me rregullat fiskale të BE-së.

Strategjia fiskale përfshin indikacionet dhe qëllimet afatmesme të politikës fiskale, projeksionet bazë makroekonomike, vlerat për kategoritë kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve të vlerësuarat, si dhe projeksionet për deficitin buxhetor dhe borxhin.

Në periudhën afatmesme, me uljen e efekteve negative të goditjeve të njëpasnjëshme, pritjet normalizimi i zhvillimeve globale, ulja e presioneve inflacioniste dhe përforsimi i aktivitetit ekonomik midis partnerëve tanë kryesorë tregtarë, fakt ky që do të kontribuojë në rritjen dhe përmirësimin e kërkesës së jashtme të mjedisit të investimit.

Në periudhën e kaluar, ekonomia e brendshme ka regjruar rezistencë ndaj goditjeve të njëpasnjëshme të shkaktuara nga faktorët globalë. Responsiviteti në kohë i politikës fiskale kufizoi në masë të madhe ndikimin e këtyre goditjeve. Që në fillim të krizës, si vazhdimësi e masave përkrahëse dhe rimëkëmbëse në periudhën e pandemisë dhe pas saj, Qeveria reagoi me shpejtësi, me pikësynimin për ngadalësimin e efektit transferues të inflacionit të importuar dhe për sigurimin e furnizimit të plotë dhe stabil me energji elektrike, por edhe për shmangien e goditjeve të çmimeve. Masat u targetuan në drejtim të kategorive më të ndjeshme të qytetarëve të prekur nga kriza për mbrojtjen e standardit të jetesës, por edhe për ruajtjen e likuiditetit të kompanive dhe për përkrahjen e investimeve në efikasitetin energjetik dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë për sigurimin e stabilitetit energjetik në periudhë afatgjate.

Konsolidimi fiskal vazhdon nëpërmjet përkrahjes së ekonomisë me anë të investimeve në projektet infrastrukturore, projektimit të strukturës së financave publike nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale, si dhe përforsimit të procesit të planifikimit, realizimit dhe raportimit të financave publike.

Në periudhën afatmesme, politika fiskale parasheh konsolidim fiskal në etapa, me ç'rast sipas projeksioneve të reja fiskale, niveli vjetor i deficitit buxhetor është konsistent me projeksionet e Strategjisë fiskale paraprake. Njëkohësisht, deficitin buxhetor si pjesëmarrje në përqindje të PBB-së zvogëlohet në 4.8% në 2023, 3.4% në vitin 2024, 3.0% në vitin 2025, 3.0% në vitin 2026, 2.8% në vitin 2027 dhe 2.5% në vitin 2028. Njëkohësisht, bilanci primar buxhetor ka trend rënës,

përkatësisht 3.3% e PBB-së në vitin 2023, 1.7% në vitin 2024, 1.1% në vitin 2025, 1.0% në vitin 2026, 0.7% në vitin 2027 dhe 0.5% në vitin 2028.

Rëndësi esenciale ka edhe pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale me mesatare prej rreth 5% në PBB në nivel vjetor, përmes së cilës do të gjenerohej rritja dhe zhvillimi ekonomik.

Prioritetet kryesore në fushën e sistemit tatimor janë përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në arkëtimin e të hyrave, rritja e transparencës tatimore, cilësia më e mirë e shërbimeve të ofruara nga institucionet e sistemit tatimor në mënyrë të thjeshtësimit dhe përsheptimit të procedurave dhe reduktimit të barrës administrative përmes dixhitalizimi të mëtijshëm të shërbimeve, si dhe vendosjes së tatimit ekologjik (të gjelbër) për stimulimin e obliguesve tatimorë nëpërmjet detyrimeve publike që të kontribuojnë në ndotje më të ulët. Qëllimi kryesor i politikës tatimore është sigurimi i rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke mundësuar siguri juridike për obliguesit tatimorë dhe arkëtim të rregullt të të hyrave publike.

Edhe në periudhën vijuese vazhdon përcaktimi që shpenzimet të jenë në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike, të përsheptimit të rritjes ekonomike, të vazhdohet me procesin prioritar integruar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE dhe detyrimeve që rezultojnë nga anëtarësimi në NATO.

Me procesin e decentralizimit vazhdon përmirësimi i shërbimeve publike dhe zhvillimi lokal i përforcuar në interes të qytetarëve, si dhe arritja e zhvillimit të barabartë rajonal. Me përmirësimin e efikasitetit të administratës dhe sigurimin e të hyrave të reja lokale do të ndërmerren veprime për rritjen e të hyrave vetanake të pushtetit lokal.

Për avancimin e decentralizimit fiskal janë planifikuar disa aktivitete dhe masa, të cilat grupohen në tri shtylla: I. Përmirësimi i kapaciteteve fiskale dhe rritja e të hyrave të komunave, II. Rritja e disiplinës fiskale dhe III. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies gjatë punës së tyre. Qëllimi përfundimtar i këtij procesi është arritja e cilësisë më të lartë të shërbimeve publike, shkallës më e lartë e zhvillimit ekonomik dhe përmirësimit të standardit të jetesës.

Qëllimi kryesor i politikës së menaxhimit të borxhit publik është sigurimi i mjeteve të domosdoshme për financimin e deficitit buxhetor, shlyerjen e borxheve si rezultat i huamarrjeve të viteve paraprake dhe për financimin e projekteve, pa shkaktuar rritje të pajustificuar të borxhit deri në atë nivel që mund ta cënojë stabilitetin e ekonomisë dhe rritjen ekonomike të vendit.

Grafiku 1: Ecuria e rritjes ekonomike, deficitit buxhetor dhe borxhit publik



PËRMBAJTJA

Hyrje

1. Zhvillimet dhe projeksionet makroekonomike
 - 1.1 Zhvillimet dhe projeksionet ekonomike ndërkombëtare
 - 1.2 Zhvillimet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut
2. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut
 - 2.1 Realizimet në vitet 2022 dhe 2021
 - 2.2 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023
 - 2.3 Realizimet në periudhën janar – mars të vitit 2023
 - 2.4 Korniza afatmesme e Buxhetit
 - 2.4.1 Të hyrat
 - 2.4.2 Shpenzimet
 - 2.4.3 Deficiti i Buxhetit të RMV-së dhe financimi
 - 2.4.4 Buxheti i pushtetit të përgjithshëm (buxheti i konsoliduar i RM-së dhe buxheti i komunave)
 - 2.4.5 Qasja sektoriale ndaj shpenzimeve
 - 2.5 Buxheti i pushtetit lokal
 - 2.5.1 Realizimet në periudhën janar - mars 2023
 - 2.5.2 Korniza afatmesme e buxhetit të pushtetit lokal
 - 2.6 Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të shtetit
3. Aspektet e tjera dhe përmirësimi i menaxhimit të financave publike
 - 3.1 Programi i Reformës në menaxhimin e financave publike 2022 - 2025
 - 3.2 Raporti mbi detyrimet e paraqitura sipas Ligjit të Paraqitjes dhe Evidencës së Detyrimeve
4. Shfrytëzimi i ndihmës paraaderuese nga BE-ja
 - 4.1 IPA 1 - Perspektiva financiare 2007-2013
 - 4.2 IPA 2 - Perspektiva financiare 2014 - 2020
 - 4.3 IPA 3 - Perspektiva financiare 2021 - 2027
5. Borxhi publik
 - 5.1. Vlera e borxhit publik dhe shtetëror
 - 5.2. Borxhi i garantuar dhe risku i aktivizimit të garancive shtetërore
6. Analiza krahasuese e projeksioneve makroekonomike dhe fiskale për periudhën 2024 - 2028
 - 6.1 Krahasimi me Strategjinë fiskale të rishikuar 2023 - 2027
 - 6.2 Krahasimi me projeksionet e institucioneve të tjera vendase dhe ndërkombëtare
 - 6.3 Analiza krahasuese e nevojave dhe burimeve të huamarrjes
7. Analiza e risqeve fiskale dhe senzitive
 - 7.1 Risqet makrofiskale dhe senzitiviteti i deficitit buxhetor dhe borxhit shtetëror

Në bazë të nenit 17 paragrafi (5) të Ligjit të Buxheteve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.203/2022), Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më datë __.12.2023, miratoi Strategjinë fiskale të rishikuar të Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2024 – 2028.

Hyrje

Strategjia fiskale është dokument i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilin janë pasqyruar supozimet për projeksionet makroekonomike dhe indikacionet (hapat) e politikës fiskale për vitin aktual dhe për pesë vitet e ardhshme. Strategjia fiskale e miratuar e fundit është baza për përgatitjen e dokumenteve të tjera të politikës fiskale, duke përfshirë dokumentet e dorëzuara në institucionet e BE-së. Ministria e Financave përpilon Strategjinë fiskale dhe ia dorëzon atë Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke marrë parasysh prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe propozimet e shfrytëzuesve buxhetorë.

Ministria e Financave publikoi këtë vit në faqen e saj të internetit për herë të parë planin me afate kohore të përpilimit të Strategjisë fiskale. Gjithashtu, në përputhje me afatet e reja ligjore, Ministria e Financave u ka dorëzuar shfrytëzuesve buxhetorë letër qarkore për strategjinë fiskale me udhëzime për përpilimin e Strategjisë fiskale në përputhje me planin me afate kohore. Projeksionet fiskale bëhen në bazë të legjislacionit ekzistues dhe detyrimeve ekzistuese (skenari bazë) dhe propozimit për projektet e reja dhe detyrimet e reja financiare (iniciativa të reja). Më tej, Qeveria miraton Strategjinë fiskale, duke përfshirë aneksin që përfshin vlerat maksimale të mjeteve të aprovuara (limitet e shpenzimeve) sipas shfrytëzuesve buxhetorë, që do të jenë pjesë integrale e qarkores buxhetore për përgatitjen e buxhetit për vitin vijues.

Strategjia afatgjatë fiskale është në përputhje me qëllimet afatgjate fiskale dhe prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mundëson monitorimin e dinamikës së të hyrave dhe shpenzimeve në raport me qëllimet fiskale.

Elementët kryesorë të politikës fiskale afatmesme paraqesin riprojektimin e politikave buxhetore dhe konsolidimin fiskal, të cilat janë në drejtim të përkrahjes së stabilitetit makroekonomik, rritjes ekonomike dhe në këtë mënyrë edhe përforcimit të potencialit të rritjes së ekonomisë vendase.

Krahas angazhimit për konsolidimin fiskal dhe kursimeve buxhetore, vazhdon përkrahja e ekonomisë me investime në projekte infrastrukturore, me uljen e strukturës së financave publike nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale dhe përforcimit të transparencës dhe llogaridhënies.

1. Zhvillimet dhe projeksionet makroekonomike

1.1 Zhvillimet dhe projeksionet ekonomike ndërkombëtare

Gjatë vitit 2023, ekonomia globale vazhdoi të rimëkëmbej nga goditjet që lidhen me pandeminë, invazionin rus ndaj Ukrainës dhe inflacionin dyshifror. Probleme shtesë janë mungesa e përkrahjes fiskale në kushtet e niveleve të larta të borxhit publik, rritja e fragmentimit gjeopolitik dhe gjeoekonomik, si dhe ndryshimet klimatike. Lidhur me këto rrethana, ekonomia globale ka treguar rezistencë të lartë. Pavarësisht çrregullimeve në tregjet e energjisë dhe produkteve ushqimore, të shkaktuara nga ndryshimet klimatike dhe lufta në Ukrainë, si dhe

shtrëngimit të theksuar të politikës monetare, rritja e ekonomisë globale është ngadalësuar, por nuk është ndalur. Aktiviteti ekonomik global arriti nivelin më të ulët në fund të vitit të kaluar, ndërkohë që inflacioni (si inflacioni i përgjithshëm, ashtu edhe ai bazik) po vihet gradualisht nën kontroll.


Sipas projeksioneve të FMN-së nga muaji tetor i vitit 2023, rritja e ekonomisë globale pritet të ngadalësohet nga 3.5% në vitin 2022 në 3.0% këtë vit dhe 2.9% në vitin 2024. Rritja në vendet e zhvilluara pritet të ngadalësohet dukshëm nga 2.6% në vitin 2022 në 1.5% në vitin 2023 dhe 1.4% në vitin 2024, në kushtet e aktivitetit më të fuqishëm ekonomik në SHBA dhe rritjes më të ngadalësuar ekonomike në Eurozonë. Rritja te vendet në zhvillim pritet të ngadalësohet nga 4.1% në vitin 2022 në 4.0% në vitin 2023 dhe 2024, në rrethana të krizës në tregun e patundshmërive në RP të Kinës. Në periudhën afatgjate, aktivitetet ekonomike botërore pritet të rifillojnë ku pritet rritje mesatare vjetore prej 3.2% për periudhën 2025-2028. Aktiviteti ekonomik në BE në vitin 2023 pritet të mbetet i ulët dhe të shënojë rritje prej 0.7%, ndërsa në vitin 2024 rritja pritet të jetë 1.5%, që paraqet rishikim të lehtë në rënie krahasuar me pritshmëritë paraprake. Në periudhën 2025-2028, rritja mesatare ekonomike në BE pritet të jetë 1.9% në nivel vjetor. RF e Gjermanisë, ku orientohet pjesa më e madhe e eksportit të kompanive vendase, pritet të rikupërohet dhe të shënojë rritje prej 0.9% në vitin 2024, pas rënies së projektuar prej 0.5% në vitin 2023, në ndërsa në periudhën afatmesme, përkatësisht në periudhën 2025-2028, pritet rritje mesatare vjetore prej 1.5% (Grafiku 2).

Grafiku 2. Rritja ekonomike globale (në %)



Inflacioni global pritet të shënojë rënie nga 8.7% në vitin 2022 në 6.9% në vitin 2023 dhe 5.8% në vitin 2024. Projektioni për vitin 2024 është rishikuar në rritje për 0.6 p.p., si rezultat i inflacionit bazik, i cili është më i lartë se sa pritej. Rikthimi i inflacionit në targetin e përcaktuar nuk pritet para vitit 2025 në shumicën e vendeve evropiane. Inflacioni në Eurozonë projektohet në 5.6% në vitin 2023 (që është në përputhje me projeksionet e BQE-së) dhe 3.3% në vitin 2024. Nga viti 2025, pritet stabilizimi i mëtejshëm i inflacionit rreth nivelit të targetuar prej 2%.

Grafik 3. Inflacioni (në %)



1.2 Zhvillimet ekonomike në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në kushtet e krizës së vazhdueshme dhe pasigurisë së shkaktuar nga faktorë të jashtëm të pafavorshëm, ekonomia e brendshme u tregua rezistente dhe vijoi të jetë në rrugën e rritjes. Gjatë aktivitetit të ngadalësuar dhe normave negative të rritjes në ekonomitë që janë partnerët kryesorë tregtarë, aktiviteti ekonomik në tremujorin e tretë të vitit 2023 shënoi rritje prej 1.2%, pas rritjes prej 1.5% në tremujorin e parë dhe 1.1% në tremujorin e dytë, respektivisht rritja në nëntë muajt e parë të vitit shënon 1.2%.

Grafiku 4. Struktura e shpenzimeve të rritjes ekonomike (kontributi në rritje, p.p.)



Rritja e aktivitetit ekonomik në këtë periudhë vjen si pasojë e kontributit pozitiv të eksportit neto, ndërkohë që kërkesa e brendshme është ulur në kushtet e rritjes divergjente të konsumit privat dhe rënies së investimeve bruto. Konsumi privat, pavarësisht presioneve inflacioniste dhe rritjes së kostove të financimit, u rrit për 2.1% në bazë reale, me ç'rast rritja e përshpejtuar në tremujorin e dytë dhe të tretë, e përkohur nga rritja e pagave mbi rritjen e kostove të jetesës, rritja e remitancave nga jashtë, rritja e kreditimit dhe masat e qeverisë për përkrahjen e ekonomisë dhe për përkrahjen e standardit të jetesës së popullsisë. Konsumi publik u ul për 2.8%, si rezultat i politikës së reduktimit të shpenzimeve joprioritare. Investimet bruto në nëntë muajt e parë të vitit shënuan rritje prej 14.5% në bazë reale, si rezultat i reduktimit të stokeve, që u rritën dukshëm gjatë vitit të kaluar për shkak të tejkallimit të situatës së shkaktuar nga lufta në Ukrainë dhe pasigurisë në lidhje me disponueshmërinë dhe çmimet e lëndëve të para dhe

energjisave. Ndërkohë që rënia e investimeve bruto, që u ngadalësua dukshëm në tremujorin e dytë, u thellua sërish në tremujorin e tretë. Si rezultat i përkeqësimit të mjedisit të jashtëm dhe ngadalësimit të kërkesës së jashtme, por edhe bazës së lartë krahasuese (rritje prej 16.3% në tremujorin e tretë të vitit 2022), rënies së eksportit të mallrave dhe shërbimeve, i cili filloi në tremujorin e dytë, vijoi në tremujorin e tretë me rënie prej 5.0%, me ç'rast mesatarja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve në nëntëmujorin e parë shënoi rënie minimale prej 0.2%. Sipas të dhënave mujore të shkëmbimit të tregtisë së jashtme, kontributin më të madh pozitiv e ka eksporti i makinerive dhe pajisjeve transportuese, ndërsa kontributin më të madh negativ e ka eksporti i metaleve dhe produkteve metalike. Njëkohësisht, importi i mallrave dhe shërbimeve u zvogëlua me dinamikë më të fuqishme, ku në nëntëmujorin e parë shënoi rënie prej 5.6% në bazë reale, me ulje tërësisht si pasojë e rënies së importit të produkteve intermediare (të ndërmjetme), ndërsa produktet kapitale dhe produktet për konsum më të gjerë shënojnë rritje. Kështu, eksporti neto kishte kontribut të theksuar në rritje në nëntë muajt e parë të vitit 2023. Deficiti tregtar në nëntëmujorin e parë ishte 29.5% më i ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Grafiku 5. Struktura e rritjes ekonomike sipas metodës së prodhimit (pikë përqindje)



Sa i përket aspektit të sektorëve, shtytësi kryesor i rritjes në tre tremujorët e parë të vitit 2023 ishte sektori i shërbimit, i përkrahur nga bujqësia dhe industria, të cilët patën kontribut pozitiv. Aktiviteti në sektorin e shërbimit u rrit për 2.8%, ku kontributin më të madh mbi rritjen e kishin aktivitetet e tregtisë, transportit dhe hotelerisë, por me dinamikë më të ngadalësuar. Rritje të dukshme u vu re edhe në aktivitetet e informacionit dhe komunikimit, veprimtaritë financiare dhe veprimtaritë që lidhen me pronën e patundshme. Prodhimi industrial, i cili u rimëkëmb në gjysmën e parë të vitit, shënoi rënie të moderuar prej 0.8% në tremujorin e tretë, me ç'rast në nëntëmujorin e parë u shënuar rritje minimale prej 0.1%. Përveç kësaj, në kushtet e rritjes në shumicën e degëve, faktori më i madh kufizues për dinamikën e rritjes është rënia e prodhimit të metaleve si rezultat i ndikimit të krizës energjetike. Masat përkrahëse për shfrytëzimin e plotë të kapaciteteve vendase të prodhimit të energjisë elektrike kontribuan në rritje të prodhimit prej 18.6% në nëntë muajt e parë. Sipas të dhënave mujore, prodhimi industrial në muajin tetor shënoi rritje të dukshme prej 9.9% në bazë vjetore (pas rritjes prej 4.5% në muajin shtator), në kushtet e rritjes së fuqishme në të gjithë sektorët. Prodhimi bujqësor u rikuperua në tremujorin e dytë dhe të tretë dhe shënoi rritje mesatare prej 0.8%. Përrjashtim bën vetëm ndërtimtaria, që pas rritjes në tremujorin e parë, shënoi rënie në tremujorin e dytë dhe të tretë,


me rënie kumulative prej 6.5% në nëntëmujorin e parë, në kushtet e uljes së aktivitetit në të dy segmentet, në ndërtimin e lartë dhe atë të ulët, zhvillime që pritet të korrigjohen nga dinamizimi i projekteve infrastrukturore.

Në vitin 2023, rritja e PBB-së pritet të jetë 2.3% në bazë reale, e përkrahur kryesisht nga rritja e konsumit privat dhe kontributi pozitiv i eksportit neto.

Trendi pozitiv në tregun e punës vazhdoi në kushtet e uljes së papunësisë dhe rritjes së punësimit. Sipas të dhënave të ESHS-së, shkalla e papunësisë në tremujorin e tretë në vitin 2023 në kategorinë 15-74 ishte 12.8% dhe ishte ulur për 0.3 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak. Shkalla e papunësisë në kategorinë 15-64 vjeç shënon 12.9%, ndërsa tek të rinjtë (15-29) shënon 24.0% dhe krahasuar me tremujorin paraprak ulen repsektivisht për 0.3 p.p. dhe 0.5 p.p.. Numri i përgjithshëm i personave të papunuar të moshës 15 deri në 74 vjeç në TM3 të vitit 2023 është 102,134 persona, që është 1.7% më i ulët (1.754 persona). Shkalla e punësimit në tremujorin e tretë të vitit 2023 në kategorinë 15-89 shënon 45.7%, ndërsa në kategorinë 15-64 shënon 57.1%, krahasuar me tremujorin paraprak, shkalla e punësimit për grupet e sipërpërmendura është rritur respektivisht për 0.2 p.p. dhe 0.3 p.p.. Përveç kësaj, numri i personave të punësuar të moshës 15-64 vjeç në tremujorin e tretë është rritur për 0.9% krahasuar me tremujorin e dytë, përkatësisht për 1.6% krahasuar me tremujorin e parë, ndërsa numri i personave të punësuar në kategorinë 15-89 është rritur për 0.4% krahasuar me tremujorin e dytë dhe 1.4% krahasuar me tremujorin e parë të vitit 2023. Te personat e moshës 15 deri në 29 vjeç, shkalla e punësimit është 33.0% dhe është ulur për 1.8 p.p. krahasuar me tremujorin paraprak. Sa i përket aktivitetit, popullsia e përgjithshme aktive nga 15 deri në 89 vjeç është 794.902 persona, pra 52.4% e popullsisë së përgjithshme të aftë për punë. Në kategorinë 15-64, shkalla e aktivitetit është 65.6%, ndërsa tek të rinjtë nga 15 deri në 29 vjeç është 43.3%.

Paga mesatare neto në periudhën janar - shtator të vitit 2023 është rritur për 14.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të viti paraprak, përkatësisht 2.5% në bazë reale. Rritja e pagës neto është shënuar në të gjithë sektorët, me rritjen më të lartë në ndërtimtari, veprimtaritë administrative dhe industrinë e përpunimit.


Grafiku 6. Rritja e pagës mesatare neto (në %)



Gjatë vitit 2023, inflacioni vijon të ngadalësohet dhe në muajin nëntor arriti në 3.1% në nivel vjetor. Masat për uljen e çmimeve të produkteve ushqimore bazë dhe vendosja e “çmimit të garantuar” rezultuan në rënie të çmimeve të produkteve ushqimore për 3.8% në nivel mujor në muajin tetor, trend i cili vazhdoi edhe në muajin nëntor me ulje të çmimeve të produkteve

ushqimore për 0.3%. Kumulativisht, në periudhën janar-nëntor të vitit 2023, norma e inflacionit ishte 9.9%. Rënie vërehet në çmimet e derivateve të naftës (prej 8.8%), ndërkohë që produktet ushqimore mbeten shtytësi kryesor i rritjes (me rritje prej 12.8%), por me rritje vjetore më të ngadalësuar, si dhe me kontribut të reduktuar në inflacionin e përgjithshëm. Inflacioni bazik, i cili është ende në nivel të lartë, kumulativisht arrin në 8.4% deri në muajin nëntor të vitit 2023, ndërkohë që ngadalësimi i rritjes stagnoi në muajt e fundit. Si rezultat i masave qeveritare për uljen e çmimeve të produkteve bazë, pritet ulje e mëtejshme e inflacionit në fund të vitit dhe mesatarisht të jetë 9.2% për vitin 2023.

Grafiku 7. Inflacioni i përgjithshëm dhe ai bazik (në %)



Ecuria në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në nëntëmujorin e parë të vitit 2023 rezultoi me suficit prej 241.3 milionë eurove (1.7% e PBB-së së projektuar), që është përmirësim i dukshëm në pozicionin e jashtëm krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur deficitin u realizua prej 522.8 milionë eurove. Përmirësimi vjen si rezultat i reduktimit të deficitit tregtar, në radhë të parë të deficitit tregtar energjetik, si dhe rritjes së transfertave rrjedhëse (remitancat nga jashtë).

Në periudhën janar - shtator të vitit 2023, fluksi hyrës i IHD-ve shënon 352.1 milionë euro, që paraqet rënie prej 30.2% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kur u arrit fluksi rekord i IHD-ve. Në strukturën e IHD-ve, investimet në kapitalin pronësor dhe riinvestimin e fitimit u dyfishuan, duke arritur në 478 milionë euro në tre tremujorët e parë, por instrumentet e borxhit kishin kontribut të theksuar negativ.

Rezervat devizore, në fund të muajit nëntor të vitit 2023, arritën në 3.964 milionë euro, që paraqet rritje prej 3.6% në bazë vjetore, duke siguruar mbulim 4 mujor të importit të mallrave dhe shërbimeve.

Gjatë vitit 2023, Banka Popullore vazhdoi me shtrëngimin e politikës monetare dhe në disa raste arriti normën bazë të interesit, ku gjatë muajit nëntor arriti në 6.30%. Në muajin tetor të vitit 2023, kreditë e përgjithshme u rritën për 5.3% në bazë vjetore, në kushtet e rritjes së kredive për ndërmarrjet prej 4.1% dhe kredive për amvisëritë prej 6.3%. Potenciali i përgjithshëm i depozitave në muajin tetor të vitit 2023 shënoi rritje prej 8.0% në bazë vjetore, me ç'rast depozitat e amvisërive u rritën për 6.8% dhe ato të ndërmarrjeve për 14.1%.

Grafiku 8. Saldoja e llogarisë rrjedhëse dhe fluksi hyrës i IHD-ve (në milionë euro)



1.3 Projektionet afatmesme makroekonomike

Tendosja e marrëdhënieve ekonomike dhe politike ndërkombëtare, e shkaktuar nga lufta në Ukrainë, vijuar nga presionet inflacioniste të intensifikuara dhe afatgjata, pritshmëritë për ulje të tregtisë globale dhe kërkesës së jashtme, si dhe rigoroziteti i kushteve të financimit global, përkeqësojnë mjedisin global dhe në mënyrë shtesë e rrisin pasigurinë për perspektivën ekonomike.

Këta faktorë kontribuojnë në rimëkëmbjen e ngadalësuar pas pandemisë. Pritshmëritë për rritjen e aktivitetit global dhe mbi të gjitha për atë evropian janë ulur krahasuar me projektionet paraprake. Njëkohësisht, në Gjermani, si ekonomia më e madhe evropiane dhe partnerja jonë më e rëndësishme tregtare, pritet ngadalësim më i madh i aktivitetit ekonomik se paraprakisht. Dukuritë e tilla pritet të ndikojnë negativisht mbi kërkesën e jashtme, si dhe mbi kërkesën e brendshme, respektivisht mbi investimet në mjetet fikse dhe konsum, fakt ky që kushtëzon prolongimin e caktuar të dinamikës së arritjes së normave më të larta të rritjes ekonomike të parashikuara në Strategjinë fiskale 2024 - 2028 nga muaji qershor i vitit 2023.

Në periudhën e kaluar, ekonomia e brendshme tregoi rezistencë ndaj goditjeve të njëpasnjëshme të shkaktuara nga faktorët globalë. Masat që po zbatohen në vazhdimësi nga vendi për përballimin e krizës energjetike dhe atë të çmimeve pritet të ndikojnë në mbrojtjen e standardit të jetesës së qytetarëve, sigurimin e stabilitetit energjetik dhe likuiditetin e kompanive. Njëkohësisht, ato do të sigurojnë edhe përkrahje financiare për subjektet afariste, për rimëkëmbjen më të shpejtë ekonomike dhe krijimin e bazës së përsheptimit të rritjes ekonomike në periudhën e ardhshme, me stabilizimin gradual të pritshëm të zinxhirëve globalë të furnizimit dhe mjedisit më të favorshëm investues.

Si rezultat i kësaj, sipas skenarit makroekonomik bazë, rritja ekonomike në vitin 2024 projektohet në 3.4%, (kundrejt rritjes së pritur prej 4.0% sipas projeksioneve paraprake). Rritja e aktivitetit ekonomik do të vijojë të nxitet nga kërkesa e brendshme, ndërkohë që eksporti neto pritet të ketë kontribut negativ, në kushtet e rritjes më të moderuar të eksportit dhe importit të mallrave dhe shërbimeve.

Politikat dhe masat ekonomike të integruara në Planin e qëndrueshmërisë fiskale dhe përkrahjes së rritjes ekonomike, Planin e investimeve publike dhe Planin e rritjes së

përsheptuar ekonomike (“Growth Acceleration Plan”) si kornizë e përgjithshme, do të kontribuojnë në rritjen e potencialit të rritjes dhe realizimit të normave më të larta të rritjes në periudhën afatmesme, respektivisht dyfishimin e rritjes ekonomike krahasuar me mesataren prej 2.5% në dekadën e fundit, ndërkohë që rritja mesatare e aktivitetit ekonomik në periudhën 2024-2028 pritet të arrijë në 5.1%. Krahas politikave dhe masave ekonomike, normalizimi i zhvillimeve globale në periudhë afatmesme, ulja e presioneve inflacioniste dhe rritja e besimit të subjekteve afariste pritet të kontribuojnë mbi rritjen e investimeve private, si dhe përkrahjen e vendit për avancimin e sektorit privat dhe përforsimin e konkurrencës, inovacionit dhe zhvillimit teknologjik të ndërmarrjeve përmes sigurimit të burimeve dhe instrumenteve alternative të financimit që është një nga aspektet kryesore të Planit të rritjes së përsheptuar. Riprojektimi i shpenzimeve publike, nëpërmjet përforsimit të ciklit të investimeve publike dhe masave të orientuara në arritjen e rritjes ekonomike të përsheptuar, inkuzive dhe të qëndrueshme, do të ketë ndikim të rëndësishëm mbi kërkesën e investimeve dhe në potencialin e rritjes ekonomike.

Impuls shtesë për dinamizimin e rritjes ekonomike pritet edhe nga “Plani i rritjes për Ballkanin Perëndimor” i promovuar nga Bashkimi Evropian. Plani, i cili përbëhet nga katër shtylla, parasheh: 1) rritjen e integritetit ekonomik me tregun e vetëm të Bashkimit Evropian, 2) inkurajimin e integritetit ekonomik rajonal në Ballkanin Perëndimor, 3) përsheptimin e reformave strukturore dhe përkrahjen e procesit të integritetit evropian, si dhe 4) rritjen e përkrahjes financiare të reformave dhe rritjen e përkrahjes së vendeve, respektivisht investimeve. Zbatimi i këtij plani duhet ta përsheptojë rritjen në rajon dhe konvergjencën drejt BE-së, si dhe ta dyfishojë PBB-në për çdo banor në dhjetë vitet e ardhshme.

Grafiku 9. Struktura e shpenzimeve të rritjes së PBB-së (kontributi në rritje, p.p.)



Investimet do kenë rol të rëndësishëm në ruajtjen e aktivitetit ekonomik dhe intensifikimin e tij në periudhë afatmesme. Krahas faktorëve kufizues që rezultojnë nga sfidat dhe pasiguria në nivel global mbi vendimet lidhur me investimet, kontributin më të madh në rritje në vitin 2024 pritet ta kenë investimet bruto me rritje prej 8.4% kryesisht si rezultat i intensifikimit të zbatimit të projekteve të mëdha infrastrukturore të financuara nga shteti (korridori 8 dhe 10 dhe infrastruktura hekurudhore), së bashku me masat dhe aktivitetet për realizim më të madh të investimeve kapitale. Në periudhën 2025-2028, investimet pritet të shënojnë rritje mesatare vjetore prej 8.8%, si rezultat i rritjes së pritshme të investimeve private, fluksit hyrës më intensiv të investimeve të huaja dhe realizimit të investimeve të paralajmëruara për zgjerimin dhe

ndërtimin e kapaciteteve të reja në zonat teknologjiko-industriale, rritjes së shpenzimeve kapitale, por edhe përkrahjes së vazhdueshme për zhvillimin e sektorit privat dhe përforcimin e konkurrencës dhe zhvillimit teknologjik të ndërmarrjeve. Njoftimi rreth Planit të rritjes për Ballkanin Perëndimor, ku fokusi është përsheptimi i proceseve reformuese në vend në periudhën e ardhshme 2024-2027, do të sigurojë përkrahje më të madhe për investimet dhe do ta përmirësojë më tej besimin mes investitorëve. Kushtet e favorshme në vend si dhe rritja e interesit dhe përkrahjes së investimeve në burimet e ripërtëritshme të energjisë do ta përkrahin më tej aktivitetin investues.

Konsumi privat parashihet të shënojë rritje reale prej 3.1% në vitin 2024, në kushtet e presioneve të reduktuara inflacioniste, rritjes së mëtejshme reale të pagave dhe punësimit, rritjes së kreditimit dhe ruajtjes së nivelit solid të remitancave nga jashtë. Zhvillimet e favorshme të konsumit privat pritet të vazhdojnë edhe në periudhën 2025-2028 me rritje mesatare vjetore prej 3.5%, mbështetur nga pritshmëritë për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes së tregut të punës, rritje të transfertave private dhe rritje të të hyrave të disponueshme të amvisërive.

Konsumi publik pritet të arrijë rritje të moderuar prej 1.0% në vitin 2024, si rezultat i përcaktimit për reduktimin dhe racionalizimin e shpenzimeve më prioritare dhe zbatimin e procesit të konsolidimit fiskal nëpërmjet riprojektimit të shpenzimeve publike të përfshira në Planin e qëndrueshmërisë fiskale dhe përkrahjes së rritjes ekonomike. Në periudhën 2025-2028, konsumi publik pritet të rritet me ritmin e njëjtë, me rritje mesatare vjetore prej 1%.

Rimëkëmbja e aktivitetit ekonomik midis partnerëve tanë më të mëdhenj tregtarë (BE-së dhe Gjermanisë) dhe stabilizimi i mëtejshëm i zinxhirëve globalë të prodhimit pritet të ndikojnë pozitivisht mbi kërkesën e jashtme dhe dinamikën e tregtisë së jashtme. Aktiviteti eksportues i kompanive vendase parashihet të shënojë rritje prej 4.6% në vitin 2024, i nxitur nga pritshmëritë për rritje të mëtejshme të kompanive në zonat industriale dhe njoftimi për investime të reja. Në periudhën afatmesme, me ezaurimin e goditjeve të pafavorshme në ekonominë globale, stabilizimin e kërkesës së jashtme dhe rritjen e potencialit eksportues në vend nëpërmjet fluksit hyrës të investimeve të huaja, eksporti pritet të ketë kontribut solid mbi rritjen ekonomike, respektivisht të shënojë rritje mesatare vjetore prej 7.7% në periudhën 2025-2028.

Rritja e kërkesës së brendshme dhe rritja e aktivitetit eksportues në vitin 2024 pritet të kontribuojnë mbi rritjen e importit të të mirave intermediare, investuese dhe të konsumit, me të cilat rritja reale e importit të mallrave dhe shërbimeve projektohet në 5.5%, me ç'rast eksporti neto do të kishte kontribut negativ mbi rritjen. Në periudhën afatmesme, kërkesa importuese pritet të stabilizohet, me rritje mesatare vjetore të importit të mallrave dhe shërbimeve të projektuara në 6.5% në periudhën 2025-2028, që do të kontribuojë në ngushtimin gradual të kontributit negativ të eksportit neto mbi rritjen ekonomike.

Tabela 1. Treguesit makroekonomikë bazë për Maqedoninë e Veriut

	2021	2022	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*
EDT, për anëtarin e pakt	4,5	22	23	34	40	55	57	61
Stabiliteti i inflacionit (p.p.c)	3,2	14,2	9,2	3,6	2,0	2,0	2,0	2,0
Erëjtje investimi (% e EDT)	32,2	36,0	32,6	33,4	34,5	35,5	36,6	37,6
Çmimi i të mirave monetare (% e EDT)	-2,0	-6,1	-1,4	-2,2	-2,1	-1,9	-1,5	-1,1
Hem-mata - nominalen aspekt (% e EDT)	5,7	10,9	13,5	8,4	6,6	6,0	5,9	6,0
Stabiliteti i kualitetit (p.p.c)	15,4	14,4	12,0	11,9	11,0	10,1	9,2	8,3
Stabiliteti i kualitetit (p.p.c)	40,2	47,3	45,5	47,3	48,6	49,7	50,6	51,3

Notat: (PPC, HEPC M i përqindje (% e M i investimit i saktëzimi)

Zhvillimet pozitive në tregun e punës pritet të vazhdojnë edhe në vitin 2024, si rezultat i rritjes së investimeve dhe nevojës për fuqi punëtore, masave dhe programeve aktive të punësimit dhe përkrahjes së ndërmarrjeve vendase dhe të huaja për hapjen e vendeve të reja të punës. Kështu, në vitin 2024, numri i të punësuarve pritet të rritet prej 2.0%, që do të rezultojë në ulje të mëtejshme të shkallës së papunësisë në nivel prej 11.9%. Me masat për zhvillimin e kapitalit njerëzor në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, pritet të kontribuohet në rritje dhe zhvillim ekonomik më të qëndrueshëm dhe inkluziv, si dhe në aspektin e ballafaqimit me sfidat që lidhen me produktivitetin, përfshirjen në tregun e punës dhe plakjen e popullsisë. Me dinamizimin e aktivitetit ekonomik në periudhën 2025-2028 punësimi pritet të rritet me ritëm më të lartë, respektivisht parashihet rritje mesatare vjetore prej 3.1%. Lëvizjet e tilla në tregun e punës do të kontribuojnë që shkalla mesatare e papunësisë në vitin 2028 të ulet në 8.3%, ndërsa shkalla mesatare e punësimit të rritet në 51.3%. Në periudhën e ardhshme trendi i rritjes së pagave pritet të vazhdojë, me ç'rast në vitin 2024 parashihet rritje prej 8.4%, në kushtet e rritjes së pagës minimale në muajin mars, si dhe harmonizimit të pagave me pagën minimale. Si rezultat i kësaj pritet që rritja e pagave në veprimtaritë industriale dhe të shërbimit të vazhdojë, veçanërisht në veprimtaritë me produktivitet të lartë, si veprimtaritë informative dhe komunikuese, veprimtaritë profesionale, shkencore dhe teknike. Në periudhën afatmesme, në kornizën kohore 2025-2028, rritja nominale e pagës mesatare pritet të jetë 6.1% në nivel vjetor.

Norma e inflacionit në vitin 2024 pritet të stabilizohet dhe projektohet në 3.6% në kushtet e ruajtjes së nivelit stabil të çmimeve të energjensave dhe produkteve ushqimore në tregjet ndërkombëtare, si dhe ngadalësimit të mëtejshëm të inflacionit bazik. Në periudhën afatmesme, me ezaurimin e efekteve të faktorëve të jashtëm, inflacioni pritet të stabilizohet në nivel prej 2%, në kushtet e pritshmërive për ulje të përgjithshme të çmimeve në bursë të produkteve ushqimore dhe naftës, si dhe ngadalësimit të mëtejshëm të inflacionit të huaj efektiv. Megjithatë, risqet për ecurinë e inflacionit lidhen me pasigurinë rreth zhvillimit të luftës në Ukrainë dhe Lindjen e Mesme, si dhe ndikimin e tyre në çmimet e energjensave dhe produkteve ushqimore.

Deficiti i llogarisë rrjedhëse, i cili u zgjerua dukshëm gjatë vitit 2022 për shkak të ndikimit të krizës energjetike, pritet të ulet në mënyrë të theksuar gjatë vitit 2023. Në vitin 2024 pritet rritje e moderuar e deficitit të llogarisë rrjedhëse në nivel prej 2.2%, si rezultat i dinamizmit të shkëmbimit të tregtisë së jashtme. Në periudhën e ardhshme afatmesme, deficiti i llogarisë rrjedhëse pritet të përmirësohet, respektivisht ulja e tij në nivel prej 1.1% në vitin 2028, që rezulton nga ngushtimi i projektuar i deficitit tregtar. Zhvillimet pozitive të fluksit hyrës të IHD-ve pritet të vazhdojnë edhe në periudhën 2024-2028, që do të ndikojë pozitivisht në ruajtjen e rezervave devizore në nivel adekuat.

Skenari makroekonomik bazë është i shoqëruar me risqe, të cilat janë kryesisht në rënie në raport me rritjen e projektuar. Risqet për normat e projektuara të rritjes së ekonomisë globale janë të rëndësishme. Lufta në Ukrainë, e ndjekur nga konflikti i vazhdueshëm në Lindjen e Mesme, rrit tensionet gjeopolitike që ndikojnë negativisht në tregtinë globale, investimet dhe rrjedhimisht, aktivitetin ekonomik. Shpërthimi i konfliktit në rajonin e Lindjes së Mesme do të ndikojë negativisht në pritshmëritë e çmimit të naftës, që mund të çrregullojë përpjekjet globale për ta mbajtur nën kontroll inflacionin, ndërsa kostot e financimit duhet të mbesin në nivel të lartë. Ndër faktorët e brendshëm, ngadalësimi i zbatimit të projekteve të mëdha infrastrukturore mund ta ngadalësojë rritjen, ndërkohë që hapja e kapitujve të negociatave për anëtarësim në BE mund të ketë ndikim më të rëndësishëm favorizues në aktivitetin investues dhe në zbatimin e reformave strukturore dhe institucionale.

2. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut

2.1 Realizimet në vitet 2022 dhe 2021

Të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 janë realizuar në vlerë prej 243,1 miliardë denarëve ose rreth 99% e Buxhetit për vitin 2022, gjegjësisht janë më të larta për 11.5% krahasuar me vitin paraprak. Nga kjo vlerë, 142.6 miliardë denarë janë të hyra tatimore dhe shënojnë rritje prej 13.4% krahasuar me vitin e kaluar. Të hyrat nga TVSH-ja janë realizuar në vlerë prej 64.8 miliardë denarëve dhe dominojnë në strukturën e të hyrave tatimore me 45.4%. Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale janë realizuar në vlerë prej 23.9 miliardë denarëve, të hyrat nga tatimi mbi fitimin janë arkëtuar në vlerë prej 15.8 miliardë denarëve, ndërsa akcizat arritën nivelin prej 25.5 miliardë denarëve. Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin, TVSH-ja, detyrimet e importit dhe të hyrat e tjera tatimore shënuan rritje krahasuar me periudhën e analizuar të vitit të kaluar, ndërsa të hyrat nga akciza janë më të ulëta për 0.3% krahasuar me vitin 2021. Të hyrat nga kontributet sociale janë realizuar në vlerë prej 77.6 miliardë denarëve dhe janë më të larta për 9.9% krahasuar me vitin 2021.

Të hyrat jotatimore në vitin 2022 ishin 17.2 miliardë denarë, të hyrat kapitale 2.3 miliardë denarë, ndërsa të hyrat nga donacionet e huaja ishin 3.4 miliardë denarë.

Të gjitha shpenzimet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2022 janë realizuar në vlerë prej 278.6 miliardë denarëve ose rreth 96.6% të Buxhetit për vitin 2022, që është 8,4% më shumë se vitin e kaluar.

Në këto suaza, shpenzimet rrjedhëse arritën në 249.9 miliardë denarë. Në këtë periudhë janë paguar 32.2 miliardë denarë për paga dhe kompensime për të punësuarit në institucionet që janë shfrytëzuese buxhetore, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime janë realizuar në vlerë prej 21 miliardë denarëve.

Pjesën më të madhe në strukturën e shpenzimeve rrjedhëse e kanë transfertat, për të cilat në këtë periudhë u paguan 187.7 miliardë denarë. Për pagesën e rregullt të pensioneve janë ndarë 67.6 miliardë denarë. Për financimin e shërbimeve shëndetësore dhe kompensimeve u paguan 38.2 miliardë denarë, ndërsa për pagesën e kompensimit monetar në rast të papunësisë përmes Agjencisë së Punësimit u paguan 2.7 miliardë denarë. Si ndihmë sociale e dedikuar për kategoritë e ndjeshme të qytetarëve u realizuan 12.5 miliardë denarë. Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për komunat janë transferuar 20.5 miliardë denarë si bllok dotacione për financimin e kompetencave të deleguara, si dhe grante të dedikuara për financimin e kostove materiale në institucionet publike lokale. Gjithashtu, nga të hyrat e realizuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar janë transferuar 2.9 miliardë denarë.

Për servisimin e rregullt të detyrimeve në bazë të interesit janë ndarë 9.1 miliardë denarë, në përputhje me planet e amortizimit për huamarrje të brendshme dhe të jashtme. Nga kjo vlerë, 5.7 miliardë denarë janë dedikuar për pagesën e interesit për huamarrje të jashtme. Për servisimin e rregullt të detyrimeve në bazë të pagesës së principalit (kryegjësë) u paguan 11.4 miliardë denarë.

Në SHA EMV u transferuar mjete në vlerë prej 14 miliardë denarëve si ndihmë dhe përkrahje për krizën energjetike.

Shpenzimet kapitale në vitin 2022 u realizuan në vlerë prej 28.6 miliardë denarëve ose 5.2 miliardë denarë, respektivisht 22.3% më shumë se gjatë vitit të kaluar. Ligji i Realizimit të Buxhetit për vitin 2022 parasheh mekanizëm që ka për qëllim përmirësimin e realizimit të shpenzimeve kapitale, me vendosjen e detyrimit për shfrytëzuesit buxhetorë duke përfshirë tremujorin e parë duhet të realizojnë 15% të shpenzimeve kapitale, 40% të shpenzimeve kapitale duke përfshirë tremujorin e dytë dhe 65% të shpenzimeve kapitale në tremujorin e tretë. Me këtë mekanizëm, bazuar në realizimin e shpenzimeve kapitale për tremujorin e tretë të vitit 2022, janë rishpërndarë 1.8 miliardë denarë në zërin 414 - Rezervat për shpenzime kapitale. Nëse në tremujorin e ardhshëm shfrytëzuesit buxhetorë realizojnë mjete deri në limitin e përcaktuar, respektivisht duke përfshirë 15 nëntorin realizojnë 70% të shpenzimeve kapitale, Ministria e Financave sipas detyrës zyrtare i kthen mjetet e reduktuara në nënprogramin dhe zërin përkatës nga ku janë rishpërndarë. Nëse shfrytëzuesit buxhetorë nuk i realizojnë mjetet deri në limitin e përcaktuar edhe në tremujorin e ardhshëm, Kuvendi vendos për shfrytëzimin e mjeteve të rishpërndara në zërin 414 - Rezervat për shpenzime kapitale, me propozimin e Qeverisë. Në këtë mënyrë, shfrytëzuesit buxhetorë do të inkurajoheshin që shpenzimet kapitale t'i realizojnë në vëllimin e planifikuar dhe në llogari të shfrytëzuesve buxhetorë që kanë dështuar në realizim, do të përfitojnë më shumë mjete ata shfrytëzues buxhetorë që i kryejnë shpenzimet kapitale në përputhje me buxhetin e miratuar.

Në këtë periudhë, deficiti i arritur i Buxhetit të RMV-së është 35.5 miliardë denarë ose 4.5% në raport me PBB-së për vitin 2022, deficiti primar është 3.3% nga PBB-ja. (Tabela 2)

Tabela 2. Realizimi i Buxhetit të RMV-së për vitin 2022

	Realizimi vlerë II 2022	2022	2021	2022 / Realizimi II 2022 (%)	2022 / 2021 (%)
					SD (%)
Ekonomia e riut	246,758	243,885	218,821	99.5 %	11.5%
Daljet e riutit	221,278	228,186	166,317	99.3 %	12.2%
Daljet e riutit	143,173	142,567	125,590	99.6 %	13.4%
Daljet e riutit	22,627	23,852	28,552	100.4 %	16.1%
Daljet e riutit	13,358	15,776	18,871	117.8 %	46.1%
Daljet (neto)	68,442	64,764	58,154	94.6 %	11.3%
Asnjë	26,918	25,483	25,548	94.7 %	-0.3%
Udhëzimet	8,517	9,573	8,488	111.8 %	12.6%
Drejtues	2,877	2,719	2,845	94.5 %	23.8%
Praktikë	78,587	77,615	78,627	99.8 %	0.9%
Ne-drejtues	17,843	17,185	13,882	100.9 %	23.8%
Kontributimi riutit	2,188	2,273	1,528	104.3 %	17.5%
Drejtues	4,785	3,487	5,854	72.1 %	-41.7%
Ekonomia e riutit	288,483	278,586	256,386	99.6 %	8.4%
Teorësi riutit	255,386	249,586	233,486	99.7 %	7.8%
Pajisje e riutit	32,815	32,155	31,818	99.8 %	3.7%
Stafet e riutit	23,476	21,881	28,118	89.5 %	4.4%
Transferimi e riutit	23,441	23,365	21,218	99.7 %	10.1%
Suportimi e riutit	38,938	38,581	28,252	99.5 %	8.1%
Suportimi e riutit	135,867	133,713	123,782	99.4 %	8.8%
Kontributimi	9,373	9,148	9,886	97.5 %	0.6%
Kontributimi riutit	32,587	28,637	23,488	87.5 %	23.3%
Deficit	-4,276	-35,511	-38,885	83.1 %	-8.7%
Deficit (% e riutit)	-1.4%	-14.5 %	-17.4%		
Praktikë def. (% e riutit)	-1.2	-1.3	-1.1		
Shkalla e riutit e riutit	42,736	35,511	38,885		
Praktikë	54,513	46,886	81,488		
Drejtues	26,628	14,681	23,145		
Stafet e riutit	66,824	25,881	61,758		
Drejtues (1 - 1% e riutit)	-3,141	6,387	-3,467		
Optimizimi	11,777	11,388	42,585		
Optimizimi e riutit	5,542	5,571	6,123		
Optimizimi e riutit	6,235	5,787	36,462		

Shënim: Mënyë të riutit e riutit

2.2 Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023

Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 është përgatitur në gjysmën e dytë të vitit 2022, në kushtet e krizës lidhur me furnizimin me energji elektrike.

Buxheti i vitit 2023 ka katër qëllime kryesore:

- ballafaqimi me pasojat e krizës energjetike dhe të rritjes së inflacionit;
- vazhdimi i konsolidimit fiskal dhe përforsimi i qëndrueshmërisë fiskale;
- sigurimi i kushteve për rimëkëmbjen ekonomike dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe
- financimi i vazhdueshëm i funksioneve bazë të shtetit dhe përkrahja e reformave në gjyqësor dhe integrimet euroatlantike (BE dhe NATO).

Buxheti për vitin 2023 u bazua në përcaktimin e vendosur për ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe konsolidimin e mëtejshëm fiskal, në drejtim të krijimit të kushteve më të favorshme për zhvillimin e përsheptuar dhe të qëndrueshëm ekonomik.

Gjithashtu edhe në kushtet e krizës energjetike në Evropë, përkrahja e ekonomisë vijon me investime në projekte infrastrukturore, përmes riprojektimit të strukturës së financave publike nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale, përforsimit të rrjetit të sigurimeve sociale (përfshirë pagën minimale dhe pensionet) për kategoritë më të ndjeshme të qytetarëve dhe kompanive, si dhe përforsimit të procesit të planifikimit, realizimit dhe llogaridhënies lidhur me financat publike.

Të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 u planifikun në nivel prej 282,1 miliardë denarëve dhe janë më të larta për 14.8% krahasuar me vitin 2022, ndërsa shpenzimet u planifikuan në nivel prej 324,8 miliardë denarëve ose për 12.6 % më të larta se në vitin 2022.

Kështu, të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara rezultojnë me deficit buxhetor në nivel prej 4.6% nga PBB-ja e planifikuar ose në vlerë absolute prej 42.7 milionë denarë.

2.3 Realizimet në periudhën janar - nëntor 2023

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2023, të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut u realizuan në vlerë prej 248,6 miliardë denarëve, ose rreth 88.14% nga projeksioni me Buxhetin për vitin 2023. Nga kjo vlerë, 141,2 miliardë denarë janë të hyra tatimore, nga të cilat në bazë të TVSH-së u realizuan mjete në vlerë prej 62.8 miliardë denarëve dhe dominojnë në strukturën e të hyrave tatimore me 44,4%. Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale u realizuan në vlerë prej 23.6 miliardë denarëve, të hyrat nga tatimi mbi fitimin u realizuan në vlerë prej 15.6 miliardë denarëve, ndërsa akcizat 24.3 miliardë denarë. Tatimi mbi të ardhurat personale, tatimi mbi fitimin, TVSH-në, detyrimet e importit, të hyrat e tjera tatimore dhe akcizat shënuan rritje krahasuar me periudhën e analizuar të vitit të kaluar. Të hyrat nga kontributet sociale u realizuan në vlerë prej 82.9 miliardë denarëve dhe janë 20.1% më të larta se periudha përkatëse në vitin 2022.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2023, të hyrat jotatimore arrijnë në 15.1 miliardë denarë. Të hyrat kapitale arrijnë në 2 miliardë denarë, ndërsa të hyrat nga donacionet e huaja u realizuan në vlerë prej 74 miliardë denarëve.

Të gjitha shpenzimet e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar - nëntor të vitit 2023 u realizuan në vlerë prej 277 miliardë denarëve ose rreth 85.3% nga Buxheti i projektuar për vitin 2023.

Shpenzimet rrjedhëse arritën në 245 miliardë denarë. Në këtë periudhë u paguan 33.2 miliardë denarë për paga dhe kompensime për të punësuarit në institucionet shfrytëzuese buxhetore, ndërsa shpenzimet për mallra dhe shërbime u realizuan në vlerë prej 17.7 miliardë denarëve.

Pjesën më të madhe në strukturën e shpenzimeve rrjedhëse e kanë transfertat, për të cilat në këtë periudhë u paguan 181.6 miliardë denarë. Për pagesën e rregullt të pensioneve u parashikuan 70.4 miliardë denarë. Për financimin e shërbimeve dhe kompensimeve shëndetësore u paguan 37.3 miliardë denarë, ndërsa për pagesën e kompensimit monetar në rast papunësie u realizuan 2.2 miliardë denarë përmes Agjencisë së Punësimit. Mjetet për ndihmë sociale të dedikuara për kategoritë e ndjeshme u realizuan në vlerë prej 12.7 miliardë denarë. Nga Buxheti i komunave u transferuan 21.7 miliardë denarë si bllok dotacione për financimin e kompetencave të deleguara, si dhe dotacione të dedikuara për financimin e kostove materiale

në institucionet publike lokale. Gjithashtu, nga të hyrat e realizuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar u transferuan 3.3 miliardë denarë.

Për servisimin e rregullt të detyrimeve në bazë të interesit në përputhje me planet e amortizimit, për huamarrjet e brendshme dhe të jashtme u paguan 12.4 miliardë denarë. Nga kjo vlerë, 8.7 miliardë denarë u destinuan për pagesën e interesit për huamarrjet e jashtme. Mjetet në vlerë prej 42.6 miliardë denarëve u paguan për servisim të rregullt të detyrimeve në bazë të pagesës së kryegjësë.

Shpenzimet kapitale në periudhën janar - nëntor të vitit 2023 janë realizuar në vlerë prej 32 miliardë denarëve

Duke përdshirë muajin nëntor të vitit 2023, deficitin arrin në 28.4 miliardë denarë ose 3.20% në raport me PBB-në e projektuar për vitin 2023.

Tabela 3. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023 dhe realizimi për periudhën janar – mars të vitit 2023

	Buxheti 2023	Jan. janar - Nëntor 2023	Jan. janar - Nëntor 2022	Jan. janar - Nëntor 2023 Buxheti 2023 (%)	Jan. janar - Nëntor 2023 (%)
					izo%
Buxheti primordi	282,262	248,584	218,716	88.1%	13.3%
Danocni iu rriti sferi primordiale	253,285	224,881	198,782	88.5%	12.8%
Danocni iu rriti	182,255	141,287	129,712	87.8%	8.9%
Danocni iu rriti - danoci	27,626	23,578	20,562	85.3%	14.7%
Danocni iu rriti - danoci	17,484	15,612	14,571	89.7%	7.1%
ADZ (i.e. i.e.)	72,477	62,758	59,570	86.6%	5.2%
Radikala	27,736	24,284	23,238	87.6%	4.2%
Me kriteriale	11,348	10,166	9,881	89.6%	11.9%
Druge danoci	5,635	4,748	2,588	84.3%	88.3%
Priridoci	88,578	82,854	68,888	91.1%	28.1%
Neprimordialni primordi	17,962	15,125	15,578	84.2%	-2.9%
Me kriteriale iu rriti sferi	2,888	2,882	2,214	71.5%	-8.6%
Druge sferi	8,85	7,486	2,821	81.6%	162.5%
Buxheti re sferi	324,818	277,812	243,141	85.3%	13.8%
Te kriteriale sferi	278,803	245,888	223,563	87.6%	8.6%
Placirite na domestici	37,387	33,234	29,165	89.1%	14.8%
Stavirite iu rriti	22,586	17,723	17,132	78.4%	3.4%
Transferirite na EDC	27,685	25,886	21,137	93.3%	18.4%
Suficirite iu rriti iu rriti	28,523	20,528	26,814	72.0%	-23.7%
Suficirite iu rriti iu rriti	158,687	136,821	128,417	86.3%	13.8%
Kriteriale	13,115	12,467	8,888	95.1%	41.5%
Me kriteriale iu rriti sferi	44,877	32,812	18,578	71.2%	63.5%
Deficit	-42,758	-28,418	-27,825	66.5%	18.3%
Deficit (i.e. i.e.)	-4.8%	-3.2%	-3.8%		
Primordialni def. (% na EDC)	-3.3	-1.8	-1.3		
Oni sferi iu rriti na deficit	42,758	28,418	27,825		
Primordialni	84,573	71,858	31,416		
Druge sferi	51,123	33,881	12,855		
Suficirite iu rriti	65,578	33,845	25,513		
Druge sferi (i.e. i.e. iu rriti iu rriti iu rriti)	-22,128	5,813	-6,952		
Optimizirite	52,215	42,541	7,591		
Optimizirite na domestici	15,884	6,885	2,822		
Optimizirite na sferi iu rriti	36,551	35,656	4,769		

Izvor: Ministarstvo na finansirite

2.4 Korniza afatmesme e Buxhetit

Strategjia fiskale afatmesme është në përputhje me qëllimet afatmesme fiskale dhe prioritetet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe mundëson monitorimin e dinamikës së të hyrave dhe shpenzimeve në raport me qëllimet fiskale.

Elementët kryesorë të politikës fiskale afatmesme paraqesin riprojektimin e politikave buxhetore dhe konsolidimin fiskal, të cilat janë në drejtim të përkrahjes së stabilitetit makroekonomik, rritjes ekonomike dhe në këtë mënyrë edhe përforcimit të potencialit të rritjes së ekonomisë vendase.

Krahas angazhimit për konsolidimin fiskal dhe kursimeve buxhetore, vazhdon përkrahja e ekonomisë me investime në projekte infrastrukturore, me uljen e strukturës së financave publike nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale dhe përforcimit të transparencës dhe llogaridhënies.

Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe forcimi i buxhetimit afatmesëm për 5 vitet e ardhshme është një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pjesë e procesit për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Strategjia fiskale është përgatitur në përputhje me kornizën kohore të përcaktuar me dispozitat e ligjit të ri, respektivisht Ligjit të Buxheteve. Sa i përket përmbajtjes, Strategjia përfshin disa informacione me të dhëna cilësore dhe sasiore të siguruara përmes analizës sektoriale të shpenzimeve.

Strategjia fiskale përfshin indikacionet dhe qëllimet afatmesme të politikës fiskale, projeksionet bazë makroekonomike, vlerat për kategoritë kryesore të të hyrave dhe shpenzimeve të vlerësuara, si dhe projeksionet për deficitin buxhetor dhe borxhin.

Në periudhën afatmesme, me uljen e efekteve negative të goditjeve të njëpasnjëshme, pritet normalizimi i zhvillimeve globale, ulja e presioneve inflacioniste dhe përforcimi i aktivitetit ekonomik midis partnerëve tanë kryesorë tregtarë, fakt ky që do të kontribuojë në rritjen dhe përmirësimin e kërkesës së jashtme të mjedisit të investimit. Në periudhën e kaluar, ekonomia e brendshme ka reguar rezistencë ndaj goditjeve të njëpasnjëshme të shkaktuara nga faktorët globalë. Responsiviteti në kohë i politikës fiskale kufizoi në masë të madhe ndikimin e këtyre goditjeve. Që në fillim të krizës, si vazhdimësi e masave përkrahëse dhe rimëkëmbëse në periudhën e pandemisë dhe pas saj, Qeveria reagoi me shpejtësi, me pikësynimin për ngadalësimin e efektit transferues të inflacionit të importuar dhe për sigurimin e furnizimit të plotë dhe stabil me energji elektrike, por edhe për shmangien e goditjeve të çmimeve. Masat u targetuan në drejtim të kategorive më të ndjeshme të qytetarëve të prekur nga kriza për mbrojtjen e standardit të jetesës, por edhe për ruajtjen e likuiditetit të kompanive dhe për përkrahjen e investimeve në efikasitetin energjetik dhe burimet e ripërtëritshme të energjisë për sigurimin e stabilitetit energjetik në periudhë afatgjate.

Konsolidimi fiskal vazhdon nëpërmjet përkrahjes së ekonomisë me anë të investimeve në projektet infrastrukturore, projektimit të strukturës së financave publike nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale, si dhe përforcimit të procesit të planifikimit, realizimit dhe raportimit të financave publike.

Esenciale është edhe pjesëmarrja e shpenzimeve kapitale me një mesatare prej rreth 5% në PBB në nivel vjetor, përmes të cilave do të gjenerohej rritja dhe zhvillimi ekonomik.

Për qëndrueshmërinë e politikës fiskale në periudhën afatmesme, projeksionet fiskale ofrojnë kornizë për arritjen e rregullave fiskale numerike, të cilat janë të projektuara që të jenë të harmonizuara dhe konsistente edhe me rregullat fiskale të BE-së.

Rregullat fiskale numerike vendosen për herë të parë me ligjin e ri, respektivisht me Ligjin e Buxheteve.

Buxheti dhe Strategjia fiskale duhet të jenë në përputhje me rregullat fiskale lidhur me deficitin dhe borxhin e përgjithshëm të pushtetit të përgjithshëm.

1. Deficiti i pushtetit të përgjithshëm të vitit përkatës nuk duhet të kalojë nivelin 3% të produktit të brendshëm bruto nominal (PBB).

2. Borxhi i përgjithshëm i pushtetit të përgjithshëm nuk mund të kalojë nivelin prej 60% të PBB-së nominale, ndërsa borxhi publik i garantuar nuk mund të kalojë 15% të PBB-së nominale.

3. Qeveria mund të heq dorë nga rregullat e vendosura fiskale kur rezulton ndonjë nga rrethanat lehtësuese të mëposhtme:

1. fatkeqësitë natyrore dhe goditjet e jashtme që çënojnë sigurinë nacionale ose jetën dhe shëndetin e njerëzve;

2. gjendja e jashtëzakonshme dhe/ose kriza;

3. goditjet e fuqishme financiare ose ekonomike që do të rezultojnë në rritje negative ose rritje shumë të ulët të PBB-së reale vjetore, afër zeros, tejkalimi i të cilave kërkon përkrahje të konsiderueshme nga politika fiskale.

4. Lejohen shmangie nga rregullat fiskale për realizimin e projekteve investuese me ndikim pozitiv në PBB. Ato nuk duhet të kalojnë 0.5% të PBB-së në nivel vjetor dhe në mënyrë kumulative për një periudhë pesëvjeçare.


5. Për çdo devijim (shmangie) të tillë, Qeveria është e detyruar t'i japë shpjegim të qartë Kuvendit, në Buxhetin e ardhshëm ose në ndryshimet e tij ose në strategjinë e ardhshme fiskale, si në vijim:

1. arsyet e shmangies nga rregullat fiskale;

2. masat korrigjuese që i ndërmerret dhe planifikon t'i ndërmarrë për rivendosjen e harmonizimit me rregullat fiskale në periudhë maksimale prej pesë viteve nga shmangia e tillë.

Në periudhën afatmesme, politika fiskale parasheh konsolidim fiskal në etapa, me ç'rast sipas projeksioneve të reja fiskale, niveli vjetor i deficitit buxhetor është konsistent me projeksionet e Strategjisë fiskale paraprake. Njëkohësisht, deficiti buxhetor si pjesëmarrje në përqindje të PBB-së zvogëlohet në 4.8% në 2023, 3.4% në vitin 2024, 3.0% në vitin 2025, 3.0% në vitin 2026, 2.8% në vitin 2027 dhe 2.5% në vitin 2028.

Grafik 10. Ecuria e bilancit buxhetor të përgjithshëm dhe primar (në % të PBB-së)



2.4.1 Të hyrat

Të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të RMV-së (buxheti qendror dhe fondet) për periudhën 2024 - 2028 janë planifikuar në nivel prej rreth 31.6% të PBB-së. Projeksionet e të hyrave në periudhën e ardhshme afatmesme janë projektuar në bazë të të hyrave të realizuara të viteve paraprake dhe efekteve të reformave të planifikuara në sferën tatimore.

Gjegjësisht, pas dy debateve publike me të gjitha palët e tanguara, gjatë muajit dhjetor të vitit 2020, Qeveria e miratoi Strategjinë e reformës së sistemit tatimor 2021-2025, e cila u harmonizua me të gjitha dokumentet e tjera strategjike të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave. Në përputhje me të, qëllimi kryesor i politikës tatimore është sigurimi i rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik duke mundësuar siguri ligjore për obliguesit tatimorë dhe duke mundësuar arkëtim të rregullt të të hyrave publike. Prioritetet kryesore të strategjisë janë:

- drejtësi më e madhe në tatimim, në mënyrë që të sigurohet që të gjithë t'i përmbushin detyrimet e tyre shoqërore dhe ta paguajnë pjesëmarrjen e tyre të drejtë të tatimit;
- efikasitet dhe efektivitet më të madh të sistemit tatimor për arkëtim më të mirë të të hyrave, përmes luftës më efektive kundër veprimtarive të paregjistruara dhe evazionit tatimor, përforsimit të kapaciteteve institucionale, si dhe uljes së detyrimeve tatimore të prapambetura;
- rritje të transparencës tatimore, që përfshin përmirësimin e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet organeve tatimore dhe subjekteve të tjera, që do të bazohet kryesisht në shërbimet elektronike, fakt ky që do të rezultojë në rritjen e edukimit fiskal dhe hamonizimin më të madh vullnetar,
- cilësi më e mirë e shërbimeve të ofruara nga institucionet e sistemit tatimor, në mënyrë që thjeshton dhe përshpejton procedurat, si dhe redukton barrën administrative, nëpërmjet disa shërbimeve dixhitale, menaxhimit më të mirë të dhënies së lejeve të importit-eksportit, eliminimit të barrierave jotarifore dhe kontrollit tatimor më të mirë dhe të brendshëm.
- vendosje e tatimit ekologjik (të gjelbër), me qëllim të stimulimit të obliguesve tatimorë nëpërmjet detyrimeve publike që të kontribuojnë në ndotje më të ulët, përkatësisht që t'i dekurajojnë ato nga ndotja e mjedisit jetësor. Efekti i këtij prioriteti pritet të reflektohet si në të hyrat e buxhetit, poashtu edhe në mjedisin jetësor.

Të udhëhequr nga pikësynimet dhe prioritetet e identifikuara të Strategjisë së reformës së sistemit tatimor (2021 - 2025), gjatë viteve 2022 dhe 2023, Ministria e Financave filloi reformat ambicioze të politikave tatimore që destinohen në përmirësimin e cilësisë së sistemit tatimor dhe rritjen e mobilizimit të të hyrave tatimore, për të cilat reforma janë mbajtur konsultime të gjera publike me sektorin e biznesit, komunitetin akademik dhe organizatat civile.

Njëkohësisht, në hartimin dhe zbatimin e reformave në kuadër të instrumenteve të ndryshme tatimore u zbatua qasja me faza, duke filluar me reformat e politikës tatimore në segmentet e tatimit mbi fitimin, tatimit mbi të ardhurat personale dhe tatimit mbi vlerën e shtuar, e më pas, reformat në fushën e akcizave dhe tatimit të automjeteve motorike.

Pakoja reformuese në këto fusha tatimore bazohet në analiza gjithëpërfshirëse të legjislacionit vendas dhe indikatorëve të të hyrave tatimore, si dhe në analiza krahasuese të praktikave tatimore në vendet anëtare të BE-së dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, në të integrohen konstatimet dhe rekomandimet e organizatave ndërkombëtare si FMN-ja, Banka Botërore, OECD-ja dhe BE-ja, të cilat theksojnë nevojën e sigurimit të drejtësisë më të

madhe vertikale dhe horizontale në sistemin tatimor dhe zgjerimit të bazës tatimore nëpërmjet eliminimit të shpenzimeve tatimore. Në veçanti, me reformat e politikës tatimore në rastin e tatimeve direkte janë hequr lehtësimet dhe lirimet tatimore joproductive (të ashtuquajturat shpenzime tatimore) që çrregullojnë neutralitetin e sistemit tatimor me favorizimin e kategorive ose aktiviteteve të njëjta ose të ngjashme të obliguesve tatimorë, që ndikojnë negativisht në shpërndarjen e drejtë të barrës tatimore dhe kontribuojnë për rritjen e pabarazisë në shoqëri, me ç'rast e çrregullojnë qëndrueshmërinë, gjë që krijon hapësirë të konsiderueshme për arbitrazhin e tatimit dhe/ose shmangies së tatimit dhe mund të shkaktojë joefikasitet në ekonominë reale.

Përkatësisht, me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Tatimit mbi të Ardhurat Personale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.274/22, më datë 20.12.2022) eliminohen lirimet tatimore për premitë lidhur me sigurimin e jetës dhe për sigurimin shëndetësor privat, si dhe për kontributet në Fondin Pensional Vullnetar që paguhet nga punëdhënësit në emër dhe në llogari të të punësuarve, ndërsa baza tatimore rregullohet për përfitimet e caktuara që paraqesin të hyra për të punësuarit (të ashtuquajturat përfitime menaxheriale). Gjithashtu, me ndryshimet në Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat Personale parashihet tatimimi mbi fitimet kapitale të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjeve nga fondet e investimeve të përvetësuara pas 1 janarit të vitit 2023 dhe specifikohet baza tatimore për fitimet kapitale të letrave me vlerë dhe pjesëmarrjeve të fondeve të investimeve në rastin e trashëgimisë ose nëse çmimi i blerjes së tyre nuk mund të përcaktohet. Ligji rregullon mënyrën e përlllogaritjes dhe tatimit mbi fitimet kapitale me tatimin mbi të ardhurat personale dhe specifikon se cilat fitime kapitale nga shitja e pronës së patundshme dhe letrave me vlerë janë të liruar nga tatimi mbi të ardhurat personale. Njëkohësisht, me ndryshimet në Ligjin e Tatimit mbi të Ardhurat Personale rregullohet lirimi nga tatimi i interesit nga depozitat e afatizuara, që do të zbatohet deri në ditën e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Tatimit mbi Fitimin ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" numër 199/23 më datë 25.09.2023) eliminon lirimet tatimore për premitë e sigurimit të jetës që paguhet nga punëdhënësit në emër dhe në llogari të të punësuarit), përkatësisht ato parashihen që të trajtohen si shpenzime të panjohura për qëllime tatimore. Gjithashtu, parashihen ndryshime edhe në pjesën që i referohet raportit të detyrueshëm për çmimet transferuese, përkatësisht parashihet që ai të dorëzohet me kërkesë të organit tatimor. Me qëllim të disiplinës më të madhe tatimore, ligji parasheh rritje të dënimit për subjektet që nuk i shfrytëzojnë mjetet e përcaktuara të investuara nga fitimet e realizuara paraprake për të cilat është shfrytëzuar lirimi tatimor për fitimin e riinvestuar dhe mbi këtë bazë është ulur baza tatimore. Gjithashtu, me këtë ligj hiqet lirimi tatimor për donacionet në sport përmes sistemit të vauçerëve, përkatësisht trajtimi tatimor i këtyre donacioneve barazohet me donacionet në veprimtaritë e tjera me interes publik, si shëndetësia, arsimi, kultura etj..

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.199/23, më datë 25.09.2023) bëhet harmonizimi me direktivat e BE-së për përcaktimin e qarkullimit përmes sistemit të vauçerave, rregullimi i vendit të qarkullimit të shërbimeve dhe vendosja e termit përfaqësues tatimor. Gjithashtu, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit mbi TVSH-në parasheh rritjen e normës së tatimit mbi TVSH-në (nga 5% në 10%) për produktet e caktuara për konsum njerëzor që nuk paraqesin

produkte ushqimore bazë, si dhe është paraparë që të rregullohen më tej dispozitat që i referohen dhënies së numrit të TVSH-së dhe regjistrimit, rregullimin e llojit të veçantë të bazës tatimore dhe mënyrën më të thjeshtë të lëshimit të faturave në mënyrë elektronike.

Me ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin e Akcizave ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr.209/23, më datë 05.10.2023) është bërë harmonizimi me legjislacionin evropian në fushën e akcizave. Gjegjësisht, ky ligj parasheh harmonizimin e akcizës së përgjithshme minimale për cigaret me vlerën minimale të akcizës në BE, në përputhje me Direktivën (BE) 2011/64 të Këshillit, më 21 qershor të vitit 2011 për strukturën dhe vlerën e akcizës për produktet e duhanit. Njëkohësisht, harmonizimi i vlerave minimale të akcizës për produktet e duhanit është parashikuar të bëhet gradualisht me vendosjen e kalendarit të ri të akcizës, me të cilin do të rritet vlera e akcizës për cigaret dhe produktet e tjera të duhanit, si dhe lëngu i cigares elektronike, do të harmonizohet me Direktivën e sipërpërmendur deri në vitin 2030. Njëkohësisht, ligji në fjalë rregullon akcizën për produktet bimore për pirjen e duhanit me ngrohje, pavarësisht nëse ato përmbajnë ose jo nikotinë. Gjithashtu, me këtë ligj kryhet harmonizimi i mëtejshëm i dispozitave ligjore në pjesën e procedurës së denatyrimit të alkoolit etilik dhe shfrytëzimit të tij, me ç'rast lehtësohet procedura për lëshimin e lejes për shfrytëzuesin preferencial, në përputhje me Direktivën e Këshillit (BE) 2020/1151, më 29 korrik të vitit 2020 për ndryshimin dhe plotësimin e Direktivës 92/83/KEE për harmonizimin e strukturave të akcizës për alkoolin dhe pijet alkoolike. Në pjesën lidhur me zhvillimin e procedurës kundërvajtëse, janë rishikuar procedurat kundërvajtëse që kanë të bëjnë me akcizën dhe janë ndarë sipas rëndësisë së kundërvajtjes.

Në fushën e tatimit të mjeteve motorike, më 17 tetor të vitit 2023, Qeveria miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përllogaritjen e tatimit të automjeteve motorike dhe për vlerat e nevojshme për përllogaritjen e tatimit të automjeteve motorike ("Zyrtare Gazeta e RMV-së" nr.220/23) e cila parasheh rritjen e koeficienteve të komponentit ekologjik për tatimin e automjeteve motorike që bëjnë pjesë në kategoritë e ndotësve më të mëdhenj me gazrat e shkarkimit CO₂. Njëkohësisht, për përllogaritjen e komponentit ekologjik të tatimit mbi automjetet motorike, krahas metodës aktuale NEDC (New European Driving Cycle), mundësohet zbatimi i metodës së re WLTP (Worldwide Harmonised Light Vehicle Test Procedure), me ç'rast bëhet harmonizimi me Rregullativën 631/2019 BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, më datë 17 prill të vitit 2019. Ndryshimet e rregullores kanë për qëllim plotësimin e pjesës së masave për mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe përpjekjet për vendosjen e "tatimit të gjelbër", si pjesë e Strategjisë tatimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me zgjidhjet ligjore të miratuara në fushën e tatimeve direkte, tatimit mbi vlerën e shtuar, akcizës dhe tatimit të automjeteve motorike, pritet që në nivel vjetor të arkëtohen të hyra tatimore shtesë në vlerë prej rreth 0.7% të PBB-së.

Raporti i shpenzimeve tatimore

Shpenzimet tatimore janë shpenzime indirekte që kryhen nëpërmjet sistemit tatimor dhe doganor, bazuar në dispozitat e ligjeve tatimore materiale dhe ligjeve të tjera në fushën e ndihmës shtetërore, ligjeve të veçanta për punësimin e personave me aftësi të kufizuara etj., dhe që sjellin uljen e të hyrave tatimore ose arkëtimin e tyre të prolonguar. Shpenzimet tatimore mund të jenë në formë të përjashtimeve, lirimeve, zbritjeve, normave tatimore preferenciale etj., të cilat vendosen për arritjen e qëllimit të caktuar ekonomik ose social.

Me miratimin e Ligjit të ri të Buxheteve në vitin 2022, Ministrisë së Financave i caktohet që ta

përgatisë dhe dorëzojë Raportin lidhur me ndikimin e shpenzimeve tatimore mbi fuksin hyrës të mjeteve në buxhet, duke filluar nga viti 2025. Ky raport do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në nivel vjetore, si pjesë integrale e Llogarisë përfundimtare të Buxhetit të shtetit për vitin buxhetor paraparak.

Tabela e mëposhtme jep pasqyrë të shpenzimeve tatimore të përgjithshme bazuar në tatimin mbi të ardhurat personale, tatimin mbi fitimin, tatimin mbi vlerën e shtuar, akcizën dhe detyrimet doganore, për të cilat Ministria e Financave ka të dhëna për vitin 2022. Njëkohësisht, tabela përfshin edhe projeksionet e shpenzimeve tatimore të shënuara për periudhën 2023 - 2028.

Tabela 4: Shpenzimet tatimore sipas llojit të tatimit (në miliona denarë)

Вид на данок	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Данок на личен доход	27.635	31.116	32.983	35.291	38.291	41.546
Данок на добивка	17.404	19.483	20.652	22.098	23.976	26.014
Данок на додадена вредност	72.477	80.698	85.540	91.528	99.308	107.749
Царини и моторни возила	11.348	12.124	12.852	13.752	14.920	16.189
Акцизи (Основен буџет и ПИОМ)	27.736	30.969	32.827	35.125	38.111	41.350
Други даночни приходи	6.000	3.676	3.897	4.169	4.524	4.908
Вкупно	162.600	178.066	188.750	201.963	219.130	237.756

Burimi: Ministria e Financave dhe projeksionet e Ministrisë së Financave (*)

Tatimi mbi fitimin

a) Fitimi i riinvestuar

Baza tatimore zvogëlohet me vlerën e investimeve të realizuara për qëllime zhvillimore nga fitimi i vitit paraparak, respektivisht investimet në mjete materiale dhe jomateriale (fitimi i riinvestuar). Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim i vitit 2021 ishte 1.720 milionë denarë.

b) Zonat zhvillimore teknologjike industriale Sipas Ligjit të Tatimit mbi Fitimin ("Gazeta Zyrtare" nr. 112/14...151/21), obliguesit tatimor që është shfrytëzues i zonës zhvillimore teknologjike industriale i aprovohet përjashtimi tatimor nga tatimi mbi fitimin si ndihmë shtetërore sipas kushteve dhe procedurës së përcaktuar në Ligjin e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale ("Gazeta Zyrtare" nr. 14/07...13/23). Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 525,5 milionë denarë.

v) Tatimet mbi sportin

Sipas Ligjit të Tatimit mbi Fitimin ("Gazeta Zyrtare" nr. 14/07...13/23), obliguesit tatimor që ka donuar mjete për subjektet sportive do t'i reduktohet tatimi mbi fitimin e përlllogaritur në vlerën e mjeteve të donuara, por jo më shumë se 50% e tatimit të përlllogaritur. Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 353,1 milionë denarë.

g) Tatimi vjetor mbi të hyrat e përgjithshme

Sipas Ligjit të Tatimit mbi fitimin, kompanitë e vogla dhe mikro janë të liruara nga detyrimi për pagesën e tatimit vjetor mbi të hyrat e përgjithshme, nëse të hyrat e përgjithshme nga të gjitha

burimet në vitin për të cilin është përcaktuar tatimi nuk e tejkalojnë vlerën prej 3 milionë denarëve në nivel vjetor. Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 354 milionë denarë.

d) Shoqëritë mbrojtëse

Në bazë të Ligjit të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara ("Gazeta Zyrtare" nr.44/00...103/21), shoqëritë mbrojtëse janë të liruar nga pagesa e tatimit mbi fitimin. Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 284 milionë denarë.

gj) Sistemet fiskale të pajisjeve

Ulja e tatimit mbi fitimin e përllogaritur për vendosjen në shfrytëzim të sistemit fiskal të pajisjeve për më së shumti dhjetë sisteme të furnizuara, për obliguesit tatimorë që janë të detyruar të vendosin dhe shfrytëzojnë sisteme të tilla në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pagesave me Para të Gatshme ("Gazeta Zyrtare" nr.31/01...247/22). Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 5.2 milionë denarë.

Tatimi mbi të ardhurat personale

a) Shoqëritë mbrojtëse

Sipas Ligjit të Punësimit të Personave me Aftësi të Kufizuara, të punësuarit e shoqërisë mbrojtëse të cilët nuk janë persona me invaliditet dhe persona me invaliditet në punë janë të liruar nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale, si dhe personat me invaliditet. Vlera e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 85.3 milionë denarë.

b) Zonat zhvillimore teknologjike industriale

Lirimi nga tatimi mbi të ardhurat personale për pagën e të punësuarve në zonën zhvillimore teknologjike industriale për periudhë dhjetëvjeçare nga fillimi i veprimtarisë afariste si ndihmë shtetërore në përputhje me Ligjin e Zonave Zhvillimore Teknologjike Industriale. Vlera e vlerësuar e shpenzimeve tatimore që rezultojnë nga lirimet e mësipërme nga tatimi mbi të ardhurat personale arrin në 260,8 milionë denarë.

v) Fitimet kapitale

Lirimi nga tatimi mbi fitimet kapitale të realizuara nga shitja e letrave me vlerë dhe pjesëmarrjeve Fondin investues. Ky lirim është hequr me ndryshimet e fundit në Ligjin për Tatimin mbi të Ardhurat Personale ("Gazeta Zyrtare" nr. 241/18... 274/22) të cilat janë në fuqi nga 1 janari i vitit 2023. Vlera e vlerësuar e shpenzimeve tatimore nga ky lirim për vitin 2021 ishte 155 milionë denarë.

TVSH-ja

a) Lirimet tatimore nga tatimi mbi vlerën e shtuar në vend, me ose pa të drejtë zbritjeje, rregullohen me nenet 23, 24, 24-a dhe 24-b;

b) lirimet nga importi rregullohen nga nenet 27, 27-a, 27-b dhe 27-v;

v) zbatimi i normës tatimore preferenciale prej 5% përcaktohet me nenin 30.

Këto lirime përfshijnë transaksionet bankare dhe financiare; shërbimet e sigurimit dhe risigurimit; shërbimet shëndetësore; shërbimet arsimore; qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve të destinuara për realizimin e projektit të financuar nga mjetet e fituara në bazë të Marrëveshjes së donacionit të lidhur ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe donatorëve të huaj; lirimet tatimore gjatë importit, etj., si dhe zbatimin e normës preferenciale tatimore për mallra dhe shërbime të caktuara, si: produktet për konsum; uji i pijshëm dhe ujitja e tokës bujqësore; publikimet; materiali faror dhe materiali mbjellës; plehrat; mekanizmi bujqësor; barnat; kompjuterët; sistemet diellore termike dhe komponentët; pajisjet mjekësore, transporti i personave dhe bagazhet shoqëruese të tyre; softueri kompjuterik etj.

Vlera e vlerësuar e shpenzimeve tatimore të lirimeve nga TVSH-ja në të gjitha këto baza është përcaktuar me ndihmën e modelit për vlerësimin e shpenzimeve tatimore të TVSH-së, të zhvilluar nga ekspertët e Bankës Botërore, me ç'rast janë shfrytëzuar të dhënat më të fundit të disponueshme për vitin 2019. Vlera e vlerësuar për shpenzimet tatimore të mësipërme për vitin 2019 ishte 24,407 milionë denarë.

Tabela 5. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021 - 2028 (në milionë denarë)

	Завршна сметка 2021	Завршна сметка 2022	2023*	Одлука декември 2023	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*
Вкупни приходи	218.021	243.085	282.052	282.052	310.128	330.280	352.319	378.987	406.256
Даночни приходи и придонеси	196.317	220.186	250.689	253.205	279.045	296.775	317.536	342.780	370.049
Даночни приходи	125.690	142.567	162.600	162.235	178.067	188.751	201.963	219.130	237.756
Придонеси	70.627	77.619	88.089	90.970	100.978	108.024	115.573	123.650	132.293
Неданочни приходи	13.882	17.189	19.894	17.962	20.394	22.175	22.427	22.977	22.977
Капитални приходи	1.928	2.273	2.800	2.800	3.210	3.530	3.530	3.730	3.730
Донации	5.894	3.437	8.669	8.085	7.479	7.800	8.826	9.500	9.500
Вкупни расходи	256.906	278.597	324.811	324.811	343.638	361.906	386.329	412.929	438.970
Тековни расходи	233.498	249.960	276.060	279.834	298.459	314.137	331.141	352.212	371.253
Плати и надоместоци	31.010	32.159	34.880	37.307	41.178	42.794	45.647	48.847	52.596
Стоки и услуги	20.110	21.001	23.631	22.596	25.113	23.990	24.990	25.650	26.850
Трансфери до ЕПС	21.218	23.365	26.687	27.685	29.834	31.342	32.632	34.992	37.458
Субвенции и трансфери	30.635	32.536	32.987	28.523	23.682	27.077	29.137	33.473	34.473
Социјални трансфери	121.439	131.758	144.951	150.607	161.842	168.373	176.299	184.303	193.330
Каматни плаќања	9.086	9.140	12.923	13.115	16.810	20.560	22.436	24.946	26.546
Домашни	3.026	3.413	4.416	4.282	6.583	8.194	9.250	10.186	11.524
Странски	6.060	5.727	8.507	8.833	10.227	12.366	13.186	14.760	15.022
Капитални расходи	23.408	28.637	48.751	44.977	45.179	47.769	55.188	60.717	67.717
Буџетско салдо	-38.885	-35.512	-42.759	-42.759	-33.510	-31.626	-34.010	-33.942	-32.714
Примарно буџетско салдо	-29.799	-26.372	-29.836	-29.644	-16.700	-11.066	-11.574	-8.996	-6.168
Вкупни приходи, % од БДП**	30,3	30,6	30,6	31,5	31,6	31,5	31,2	31,1	30,8
Вкупни расходи, % од БДП**	35,7	35,1	35,3	36,3	35,0	34,5	34,2	33,9	33,3
Буџетско салдо, % од БДП**	-5,4	-4,5	-4,6	-4,8	-3,4	-3,0	-3,0	-2,8	-2,5
Примарно буџетско салдо, % од БДП**	-4,1	-3,3	-3,2	-3,3	-1,7	-1,1	-1,0	-0,7	-0,5

Извор: Министерство за финансии и проекции на Министерство за финансии (*)

2.4.2 Shpenzimet

Ana e shpenzimeve të Buxhetit të RMV-së për periudhën e ardhshme është krijuar tërësisht në funksion të realizimit të prioriteteve strategjike, përshpejtimit të rritjes ekonomike, integritetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE dhe detyrimeve që rezultojnë nga anëtarësimi në NATO.

Me rastin e krijimit të kornizës fiskale afatmesme, rëndësi të madhe ka ekzistenca e planifikimit cilësor buxhetor afatmesëm. Në këtë drejtim, duhet pasur parasysh se në periudhën e ardhshme projeksionet afatmesme fiskale bazohen në skenarin bazë afatmesëm, që do të thotë se përcaktimi i projeksioneve fiskale rezulton nga ushtrimi i kompetencave të shfrytëzuesve buxhetorë të përcaktuar në legjislacionin ekzistues, detyrimet dhe detyrat ekzistuese, të cilat janë rezultat i detyrimeve shumëvjeçare tashmë të miratuara, marrëveshjeve dhe projekteve rrjedhëse. Gjithçka që nuk përfshihet nga skenari bazë dhe kërkon sigurimin e mjeteve shtesë, pasqyrohet përmes iniciativave të reja.


Pjesëmarrja mesatare e shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën 2024 - 2028 është rreth 34.2% e PBB-së. Projektionet e shpenzimeve buxhetore për periudhën e ardhshme afatmesme përgatiten mbi bazën e tre bazave kryesore:

- harmonizimi i projekcionit të të hyrave me aktivitetet e planifikuara ekonomike;
- projekcioni i shpenzimeve të përgjithshme të Buxhetit siguron konsolidim të vazhdueshëm fiskal dhe
- vlerat e planifikuara të shpenzimeve sigurojnë realizim të rregullt dhe pa probleme të të gjitha detyrimeve ligjore.

Gjatë projektimit të vlerës dhe strukturës së shpenzimeve rrjedhëse për periudhën e ardhshme (grafiku 11), të destinuara për pagesën e pagave të rregullta të të punësuarve në sektorin publik, pagesën me kohë dhe të rregullt të pensioneve dhe të drejtave të tjera sociale, pagesën e subvencioneve në bujqësi, përkrahjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, si dhe subvencionimin e aktiviteteve inovative, janë marrë parasysh supozimet e mëposhtme:

- rritja e efikasitetit të funksionimit të administratës publike nëpërmjet optimizimit dhe racionalizimit të vendeve të punës dhe harmonizimit të pagave të të punësuarve të shfrytëzuesit buxhetorë me pagë minimale;
- pagesa e të ardhurave nga pensionet sipas metodologjisë së përlllogaritjes së pensioneve, sipas së cilës harmonizimi i pensioneve kryhet sipas lëvizjes së indeksit të kostos së jetesës në vlerë prej 50% dhe rritjes së pagës mesatare që u paguhet të gjithë të punësuarve në vlerë prej 50%;
- shfrytëzimi më efikas i burimeve të punës përmes planifikimit dhe zbatimit të përmirësuar të shpenzimeve operative, reduktimit të shpenzimeve jothelbësore dhe vendosjes së kostove të shpenzimeve;
- shërbimet më cilësore në kompetencat e decentralizuara të komunave përmes ripërcaktimit të kriterëve për ndarjen e mjeteve dhe shfrytëzimit më efikas dhe të qëllimshëm të mjeteve për dotacione;
- siguri i impaktit pozitiv më të madh në aktivitetin ekonomik përmes shfrytëzimit më efikas dhe të targetuar të mjeteve për subvencione dhe transferta;
- racionalizimi i shpenzimeve për subvencionet bujqësore përmes ripërcaktimit të politikave bujqësore për subvencionimin e bujqësisë me kriterë të reja për dhënien e subvencioneve (subvencionimi bazë dhe përkrahja shtesë), në drejtim të rritjes së prodhimit të produkteve ushqimore, që do të bazohet në rendimentin e arritur, rritjen e produktivitetit, konkurrencës më të madhe dhe amortizimit të presioneve të çmimeve të produkteve ushqimore bazë nëpërmjet Fondit Intervenues. Me modelin e ri, prioritet u jepet kulturave dhe produkteve me rëndësi strategjike për vendin dhe krijimit të sistemit të ri të prodhimit bujqësor të qëndrueshëm dhe konkurrues, si dhe nxitjes së punësimit nëpërmjet bizneseve bujqësore dhe përmes përkrahjes së produkteve bimë dhe shtazore dhe
- zvogëlimi i varfërisë nëpërmjet targetimit të duhur të shfrytëzimit të ndihmës sociale dhe pjesëmarrjes më të madhe në tregun e punës.

Grafiku 11. Struktura mesatare e shpenzimeve rrjedhëse 2024 - 2028 (në %)



Projeksionet fiskale afatmesme kanë komponent të fuqishëm zhvillimor, me pjesëmarrje të konsiderueshme të shpenzimeve kapitale me mesatare prej rreth 5% në PBB në nivel vjetor dhe paraqesin elementin kryesor të financave publike. Njëkohësisht, në planin afatmesëm respektohet rregulli i artë në financat publike: shpenzimet kapitale do të jenë më të larta se deficitin buxhetor, përkatësisht do të merret hua vetëm për financimin e projekteve investuese. Realizimi i Buxhetit do të udhëhiqet sipas parimit të vlerës së parave të investuara (“value for money”), me ç’rast do të bëhet kujdes që paratë e qytetarëve të shfrytëzohen aty ku jepen efektet më të mëdha në arritjen e qëllimeve për cilësi më të lartë të jetesës.

Në periudhën afatmesme, fokusi i politikës fiskale mbetet në sigurimin e nivelit të konsiderueshëm të investimeve publike, të cilat janë parakusht për përmirësimin e perspektivës ekonomike, si dhe për jetsë më të mirë për qytetarët. Në këtë drejtim janë planifikuar investime të konsiderueshme kapitale (Grafiku 12) përmes shfrytëzimit të mjeteve nga Buxheti, por edhe mjete të siguruar me hua nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe kreditorët bilateralë. Vlerat e planifikuara tregojnë për intensifikimin e projekteve infrastrukturore, përkatësisht investime në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, infrastrukturën energjetike dhe komunale, si dhe investime kapitale për përmirësimin e kushteve në sistemin shëndetësor, arsimor dhe social, bujqësor, kulturor, sport, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe gjyqësor.

Grafiku 12. Shpenzimet kapitale të Buxhetit të RMV-së



Në drejtim të rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, në përputhje me prioritetet e Programit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria do të fokusohet në implementimin e projekteve infrastrukturore kapitale në infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore, energjetike dhe infrastrukturën komunale, si dhe në investimet kapitale për përmirësimin e kushteve në sistemin shëndetësor, arsimor dhe atë social, bujqësor dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Më konkretisht, janë planifikuar projekte kapitale në vlerë të përgjithshme prej rreth 4 miliardë eurove, të financuara nga mjetet buxhetore, nga donacionet (nëpërmjet fondeve IPA) dhe me mjete nga institucionet financiare kreditore ndërkombëtare/bilaterale.

Me mjetet buxhetore janë planifikuar investime të konsiderueshme në fushën e infrastrukturës rrugore, për projektimin dhe ndërtimin e një pjese të Korridorit 8, planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe shfrytëzimin e Korridorit 8, zgjerimin e autostradës Tetovë - Gostivar, ndërtimin e autostradës së re Trebenishtë - Strugë - Qafë Thanë, ndërtimin e akseve (pjesëve) Gostivar - Bukojçan dhe Bukojçan - Kërçovë, si dhe ndërtimit të Korridorit 10d, aksi Prilep - Manastir. Po ashtu, përmes NPRRSH-së do të përgatitet edhe studimi i fizibilitetit për ndërtimin e rrugës Tetovë - Prizren.

Në sferën e infrastrukturës rrugore vazhdon ndërtimi i pjesës lindore të Korridorit 8 nëpërmjet aksit Rankovcë - Kriva Pallankë dhe aksit Kriva Pallankë deri në kufirin me Bullgarinë, si dhe pjesa perëndimore e Korridorit rrugor 8 nëpërmjet ndërtimit të aksit të autostradës Kërçovë - Bukojçan dhe aksit Kërçovë - Ohër, me mjete kreditore. Gjithashtu, me mjete kreditore financohet edhe ndërtimi i pjesës së autostradës Shkup - Bllacë (kufiri me Kosovën), përmirësimi i infrastrukturës rrugore të komunave në Republikën e Maqedonisë së Veriut nëpërmjet Projektit për lidhjen e rrugëve lokale, Programit për rrugët nacionale dhe Projektit për lehtësimin e tregtisë dhe transportit në Ballkanin Perëndimor.

Në pjesën e infrastrukturës rrugore, projektet më të rëndësishme kapitale që do të financohen nëpërmjet programeve IPA 2 në periudhën 2020 - 2025 janë: ndërtimi i aksit rrugor Gradsko - nyja rrugore - Drenovë, si pjesë e Korridorit rrugor 10-d, rehabilitimi i rrugës rajonale A2, aksi Kumanovë - Stracinë (faza 1), ndërtimi i rrugës së re eksprese Prilep - ura e lumit Lenishkë dhe ndërtimi i korsisë së tretë në aksin rrugor nga fshati Bellovodicë deri në guroren e Mavrovës, pastaj ndërrimi i rrethojave mbrojtëse, sipas standardeve evropiane (EN) të autostradave, në gjatësi prej 100 km të Korridorit 10, prokurimi dhe instalimi i sinjalizimit të ri në vendkalimet hekurudhore dhe zbatimi i masave për përmirësimin e sigurisë rrugore përgjatë akseve të përzgjedhura rrugore.

Në pjesën e infrastrukturës hekurudhore është planifikuar financimi i tre fazave të ndërtimit dhe rehabilitimit të pjesës lindore të linjës hekurudhore të Korridorit 8, pjesa drejt Bullgarisë, me ç'rast për fazën e dytë dhe të tretë tashmë janë siguruar 280 milionë euro mjete grant nga BE-ja, pastaj fillimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e linjës hekurudhore Kërçovë - kufiri me Shqipërinë, si dhe rehabilitimi i aksit Kumanovë - Deljadrovçë. Njëkohësisht është planifikuar ndërtimi i vendkalimit kufitar hekurudhor me objektet shoqëruese "Tabanovcë", ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Serbisë, financiar me hua dhe mjete grant nga WBIF-ja (Korniza e Investimeve për Ballkanin Perëndimor).

Në fushën e gazifikimit është paraparë ndërtimi i akseve magjistrale të tubacioneve të gazit Shkup - Tetovë, Gostivar - Kërçovë dhe Shën Nikollë - Veles, ndërtimi i gazsjellësit ndërlidhës ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Kosovës, pastaj ndërtimi i gazsjellësit ndërlidhës ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Serbisë,

si dhe ndërtimi i gazsjellësit ndërlidhës ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Greqisë.

Projektet më domethënëse që zbatohen në sferën e infrastrukturës komunale janë Projekti për përmirësimin e infrastrukturës ujore të komunave në Maqedoninë e Veriut dhe Projekti për efikasitet energjetik në sektorin publik, ndërsa në periudhën e ardhshme planifikohet edhe realizimi i Projektit për zhvillimin e qëndrueshëm të komunave.

Projektet e mëdha kapitale në fushën e bujqësisë janë Programi i ujitjes në Maqedoninë e Veriut dhe Projekti për modernizimin e bujqësisë.

Në fushën e mjedisit jetësor, krahas projektit të madh kapital të përmendur më sipër, për ndërtimin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Shkup, rëndësi të madhe ka edhe Projekti rajonal për mbetjet e ngurta, i cili parasheh krijimin e sistemeve të menaxhimit, përkatësisht të stacioneve të mbetjeve të ngurta në Rajonin Jugperëndimor, Rajonin e Vardarit, Rajonin e Pellagonisë, Rajonin Juglindor dhe në Rajonin e Pollogut si dhe aktivitetet për krijimin e stacionit të mbetjeve të ngurta në Rajonin e Shkupit.

Në fushën e krijimit të infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe krijimin e sistemit të integruar dhe të vetëqëndrueshëm financiar të menaxhimit të mbetjeve që plotëson kërkesat e BE-së, projektet kapitale më të rëndësishme që do të financohen nëpërmjet programeve IPA 2 në periudhën 2020 – 2025, janë: Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Qytetin e Shkupit, Projekti për ndërtimin e stacionit të trajtimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimi, zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës, rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës, ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Manastir, Projekti për mbylljen e deponive në Rajonin Lindor dhe Verilindor, ndërtimi i objektit qendror për menaxhimin e mbetjeve, ndërtimi i impiantit të seleksionimit, Impiantit TMB, deponisë, impiantit të kompostimit, pika e gjelbër për Rajonin Lindor dhe Verilindor në Shën Nikollë, ndërtimi i gjashtë objekteve lokale për menaxhimin e mbetjeve, stacioneve të transferimit, impianteve të kompostimit dhe pikave të gjelbra për Rajonin Lindor dhe Verilindor, përkrahja lidhur me themelimin e sistemit rajonal për menaxhimin e mbetjeve, prokurimi i pajisjeve për Rajonin Lindor, përkrahja dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për prokurimin me pajisje uji për komunat Radovish, Kërçovë, Strumicë, Manastir, Tetovë, Berovë, Kumanovë dhe Prilep, përgatitja e dokumentacionit të Projektit për përmirësimin e infrastrukturës për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza dhe rrjetin e ujësjellësit në Komunën e Haraçinës.

Në pjesën e arsimit është paraparë vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e sallave të edukatës fizike në shkollat e mesme dhe rehabilitimin e shkollave fillore dhe të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, të financuara me hua nga BQE-ja, me mjete grant nga WBIF-ja dhe me bashkëfinancim nacional, me qëllim të përmirësimit të arsimit fizik dhe përmirësimit të kushteve të përgjithshme mësimore për nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme. Për përmirësimin e kushteve të mësimin në arsimin fillor në vend, me hua nga Banka Botërore do të vazhdojë realizimi i Projektit për përmirësimin e arsimit fillor. Në pjesën e arsimit të lartë është duke u zbatuar rikonstruksioni i konvikteve studentore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me qëllim të përmirësimit të kushteve jetësore dhe mësimore të studentëve.

Në fushën e mbrojtjes sociale do të vazhdojë zbatimi i Projektit për përmirësimin e shërbimeve sociale, ndërsa më pas do të fillojë realizimi i Projektit të dytë për përmirësimin e shërbimeve sociale si dhe realizimi i Projektit për administrimin e sigurimit social, ndërsa në pjesën e

gjyqësorit do të zbatohen aktivitetet për ndërtimin dhe rikonstruimin e Institucionit Ndëshkues Korrektues “Idrizovë”, me qëllim të përmbushjes së rregullave ndërkombëtare dhe evropiane të burgjeve dhe në drejtim të përmirësimit të kushteve të qëndrimit dhe përforcimit të mbrojtjes së të burgosurve.

Në fushën e qasjes së duhur në arsimin gjithëpërfshirës cilësor në të gjitha nivelet, si projekt kapital më domethënës që do të financohet nëpërmjet programit IPA 2, në periudhën 2020 - 2025 është rikonstruimi i institucioneve publike parashkollore.

Në infrastrukturën energjetike parashihet financimi i projekteve që implementohen nga SHA “EMV” dhe SHA “MEPSO”, përkatësisht: Parku i turbinave me erë” - Bogdancë - faza 2, Ngrohtorja e Manastirit, Interkoneksioni 400 kV i Maqedonisë (Manastir) – Shqipëri (Elbasan), “Termocentrali Fotovoltaik” - Oslomej, “Parku i turbinave me erë” - Miravc, Projekti i pastrimit të lindanit (OHIS), Projekti i “EMV-së për transit drejt fotovoltaikeve solarë” (Elektranat fotovoltaike Oslomej 2 dhe Elektranat fotovoltaike – Manastir), si dhe rivitalizimi i hidrocentraleve.

Në drejtim të reformave në financat publike, përmirësimit të kornizës fiskale, përforcimit të procesit të planifikimit dhe realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përmirësimit të arkëtimit të të hyrave, përforcimit të Sistemit të prokurimeve publike, kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm si dhe raportimit transparent, do të realizohet Projekti për ndërtimin e institucioneve efektive, transparente dhe llogaridhënese për menaxhimin e financave publike.

Në periudhën e kaluar, në drejtim të përkrahjes së sektorit privat dhe sigurimit të kapitalit të ri për nevojat e tij, nëpërmjet Bankës Zhvillimore të Maqedonisë së Veriut, me sukses janë siguruar dhe realizuar gjashtë linja kreditore nga BEI-ja në vlerë të përgjithshme prej 550 milionë eurove. Në këtë fushë, fillon edhe realizimi i linjës së shtatë kreditore, në vlerë prej 100 milionë eurove, e destinuar për financimin e Projektit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërmarrjet me kapital të mesëm të tregut dhe tranzicionin e gjelbër, në përputhje me masat ekonomike të Qeverisë për mbrojtjen e konsumatorëve dhe kompanive nga kriza energjetike.

Tabela 6. Pasqyra e projekteve të financuara me anë të huave

Проект	Финансиер	Износ на заем во ЕУР
Проект за олеснување на трговијата и транспортот во земјите од Западен Балкан	МБОР - СБ	26.200.000
Проект за поврзување на локалните патишта	МБОР - СБ	33.000.000
Проект за поврзување на локалните патишта – дополнително финансирање	МБОР - СБ	37.000.000
Проект за Пречистителна станица за отпадни води Скопје	ЕИБ	68.000.000
	ЕБОР	58.000.000
	Грант од ВБИФ	69.784.283
Проект за енергетска ефикасност во јавниот сектор	Светска банка	25.000.000

Проект за унапредување на социјалните услуги	Светска банка	28.700.000
Втор проект за унапредување на социјалните услуги	Светска банка	27.500.000
Проект за администрирање на социјалното осигурување	Светска банка	13.800.000
Проект за модернизација на земјоделството	Светска банка	46.000.000
Реконструкција на казнено-поправните установи	Банка за развој при Совет на Европа	46.000.000
Проект за унапредување на основното образование	Светска банка	21.500.000
Проект за реконструкција на студентските домови во Република Северна Македонија	КфВ	20.000.000
Рехабилитација на источниот дел од железничката пруга на Коридор 8 – прва делница (Куманово – Бељаковце)	ЕБОР	46.400.000
Проект „Изградба на нова и реконструкција на постојната делница Бељаковце - Крива Паланка - источен дел од железничката пруга на Коридор 8“, фаза 2	ЕБОР	145.000.000
Проект за заеднички железнички граничен премин - Табановце	ЕБОР Грант од ВБИФ	5.000.000 2.765.226,87

2.4.3 Deficiti dhe financimi i Buxhetit të RMV-së

Financimi i deficitit të planifikuar, si dhe shlyerja e borxhit, do të sigurohen nëpërmjet huamarrjes nga burime të huaja dhe të brendshme (Tabela 7). Në periudhën 2024-2028, shteti pritet të marrë hua jashtë vendit për deficitin buxhetor, respektivisht huamarrja mund të realizohet me mjete të siguruara në tregun ndërkombëtar të kapitalit nëpërmjet emetimit të letrave me vlerë të borxhit dhe nëpërmjet tërheqjes së mjeteve nga kreditë e favorshme nga institucionet e huaja financiare dhe linjat kreditre të destinuara për financimin e projekteve të caktuara. Duke vepruar kështu, zgjedhja e burimit specifik për financimin e jashtëm do të bazohet në kushtet aktuale dhe të pritshme të tregjeve ndërkombëtare të kapitalit. Gjithashtu, huamarrja në tregun vendas do të realizohet nëpërmjet emetimit të letrave shtetërore me vlerë ose huave të brendshme, të cilat do të ofrojnë financim shtesë në kushte të favorshme. Për optimizimin e pagesave dhe për reduktimin e riskut të refinancimit, Ministria e Financave do të vazhdojë të emetojë fletobligacione shtetërore me afatizim më të gjatë dhe lloje të ndryshme fletobligacionesh (për shembull, fletobligacione të qytetarëve, fletobligacione projektuese, etj.), duke ulur kështu riskun e refinancimit të borxhit. Për ta menaxhuar në mënyrë efikase borxhin publik, në periudhë afatmesme, Ministria e Financave do ta monitorojë mundësinë e shlyerjes së parakohshme të një pjese të borxhit, respektivisht për arritjen e strukturës më të favorshme të afatizimit, asaj valutor dhe interesi mbi borxhin.

Tabela 7: Financimi i deficitit

	Реализација 2021	Реализација 2022	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*
Буџетско салдо	-38.885	-35.511	-42.759	-33.510	-31.625	-34.010	-33.940	-32.714
Финансирање на дефицит	38.885	35.511	42.759	33.510	31.625	34.010	33.940	32.714
Приливи	81.480	46.869	94.974	78.564	99.085	109.655	98.778	110.278
Домашни извори	23.692	15.587	51.124	40.263	35.624	39.503	38.930	38.298
Странски извори	61.258	24.895	65.978	43.164	46.350	67.751	62.601	57.451
Депозити ("-" е кумулирање на сметка)	-3.470	6.387	-22.128	-4.863	17.111	2.401	-2.753	14.529
Одливи	42.595	11.358	52.215	45.054	67.460	75.645	64.838	77.564
Отплата по домашно задолжување	6.123	5.571	15.664	18.625	18.167	15.699	15.022	22.634
Отплата по странско задолжување	36.472	5.787	36.551	26.429	49.293	59.946	49.816	54.930
Меморандум:								
Нето домашно задолжување	17.569	10.016	35.460	21.638	17.457	23.804	23.908	15.664
Нето странско задолжување	24.786	19.108	29.427	16.735	-2.943	7.805	12.785	2.521

Извор: Министерство за финансии и проекции на Министерство за финансии (*)

2.4.4 Buxheti i pushtetit të përgjithshëm (buxheti i konsoliduar i RMV-së dhe buxheti i komunave)

Buxheti i pushtetit të përgjithshëm përfshin të dhënat e konsoliduara të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe buxheteve të komunave. Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut përbëhet nga buxheti qendror (buxheti bazë, buxheti i aktiviteteve vetëfinancuese, mjetet nga donacionet dhe mjetet nga huatë) dhe buxhetet e fondeve të sigurimeve pensionale dhe shëndetësore dhe Agjencisë së Punësimit.

Në përputhje me konsolidimin gradual fiskal, deficitin Buxhetor i pushtetit të përgjithshëm do të ulet nga 3.4% e PBB-së në vitin 2024 në 2.6% të PBB-së në vitin 2028.

Tabela 8. Buxheti i pushtetit të përgjithshëm

	милиони денари								% од БДП							
	2021	2022	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	
Централен буџет																
Приходи	105.443	124.185	148.688	162.354	176.675	192.157	211.394	231.354	15,6	16,6	16,6	16,8	17,0	18,7	20,5	
Расходи	146.005	157.700	186.378	193.861	206.242	224.025	243.005	261.521	19,8	20,8	19,8	19,7	19,8	21,5	23,2	
Буџетско салдо	-40.562	-33.515	-37.690	-31.507	-29.567	-31.868	-31.611	-30.167	-4,2	-4,2	-3,2	-2,8	-2,8	-2,8	-2,7	
Буџетски фондови																
Приходи	89.492	101.636	102.846	112.101	118.424	123.592	128.663	133.506	12,8	11,5	11,4	11,3	10,9	11,4	11,8	
Расходи	87.815	110.662	107.915	114.106	120.484	125.735	130.994	136.054	13,9	12,1	11,6	11,5	11,1	11,6	12,1	
Буџетско салдо	1.677	-9.026	-5.069	-2.005	-2.060	-2.143	-2.331	-2.548	-1,1	-0,6	-0,2	-0,2	-0,2	-0,2	-0,2	
Буџет на РСМ (Централен буџет и фондови)																
Приходи	194.935	225.821	251.534	274.455	295.099	315.749	340.057	364.860	28,4	28,1	28,0	28,1	28,0	30,1	32,3	
Расходи	233.820	268.362	294.293	307.967	326.726	349.760	373.999	397.575	33,8	32,9	31,4	31,2	31,0	33,1	35,2	
Буџетско салдо	-38.885	-42.541	-42.759	-33.512	-31.627	-34.011	-33.942	-32.715	-5,4	-4,8	-3,4	-3,0	-3,0	-3,0	-2,9	
Буџет на локална власт																
Приходи	38.366	38.716	49.902	56.003	55.963	57.878	60.788	63.784	4,9	5,6	5,7	5,3	5,1	5,4	5,7	
Расходи	38.527	38.911	49.902	56.003	55.963	57.878	60.788	63.784	4,9	5,6	5,7	5,3	5,1	5,4	5,7	
Буџетско салдо	-161	-195	0	0	0	0	0	0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	
Буџет на општа влада (Консолидиран Буџет на РСМ и Буџет на општини)																
Приходи	233.301	264.537	301.436	330.459	351.063	373.627	400.845	428.644	33,3	33,7	33,7	33,5	33,1	35,5	38,0	
Расходи	272.347	307.272	344.195	363.969	382.688	407.637	434.786	461.358	38,7	38,5	37,1	36,5	36,1	38,5	40,9	
Буџетско салдо	-39.046	-42.736	-42.759	-33.510	-31.625	-34.010	-33.941	-32.714	-5,4	-4,8	-3,4	-3,0	-3,0	-3,0	-2,9	
Извор: Минист ерство за финансии и проекции на Минист ерство за финансии (*)																

Извор: Министерство за финансии и проекции на Министерство за финансии (*)

2.4.5 Qasja sektoriale ndaj shpenzimeve

Procesi i krijimit të politikave është operacionalizuar me procesin e miratimit të prioriteteve strategjike të Qeverisë për vitin përkatës dhe përgatitjes së programit vjetor. Konkretizimi i politikave në çdo fushë realizohet me përgatitjen e planeve strategjike trevjeçare dhe programeve vjetore të ministrive, të shoqëruara me plane aksionale përkatëse. Procesi i planifikimit zhvillohet paralelisht dhe i koordinuar me planifikimin e burimeve financiare për zbatimin e politikave në periudhën afatmesme.

Qasja programuese nënkupton shfaqjen e të gjitha aktiviteteve të shfrytëzuesve buxhetorë përmes programeve dhe nënprogrameve përkatëse të cilat përkufizohen si grup aktivitetsesh të ndërlidhura që destinohen në arritjen e qëllimit të njëjtë të përbashkët.

Qasja sektoriale është proces në të cilin Qeveria, përmes planifikimit horizontal dhe koordinimit institucional, me shfrytëzimin optimal të burimeve, vepron në drejtim të përmirësimit të situatës ekzistuese

Në kuadër të fushës së caktuar dhe në të njëjtën kohë, nëpërmjet koherencës mes kostove dhe rezultateve, realizon prioritetet e saj strategjike dhe krijon kushte për funksionim më efikas të vetë institucioneve.

Qasja sektoriale në këtë dokument bazohet në Klasifikimin e funksioneve të Qeverisë, që është krijuar nga Organizata për bashkëpunim dhe zhvillimin ekonomik dhe publikohet nga Sektori i Statistikave të Kombeve të Bashkuara.

SHËRBIMET E PËRGJITHSHME PUBLIKE

Në kuadër të kësaj fushe përfshihen aktivitetet dhe politikat që realizohen në drejtim të administrimit, punës apo përkrahjes së organeve ekzekutive dhe legjislativë, menaxhimit të financave publike, funksionimit të përfaqësive diplomatike dhe konsullore, ndihmës ekonomike etj.

Ndërmjet rekomandimeve të qarta dhe efektive të institucionit të pavarur të revizionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, sigurohet përkrahje shtetërore dhe institucioneve të tjera në përmirësimin e menaxhimit të mjeteve publike dhe kontribuon në llogaridhënie më të madhe të shpenzimit të mjeteve publike/mjeteve të obliguesve tatimorë, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmjet ofrimit të shërbimeve duke respektuar parimet e sigurisë në ofrimin e shërbimeve, vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, si dhe mbrojtjes së shfrytëzuesve dhe qytetarët.

Ruajtja e stabilitetit financiar dhe makroekonomik dhe rritja e konkurrencës së ekonomisë, qëndrueshmëria fiskale dhe konsolidimi i financave publike, përkrahja e ekonomisë dhe investimi në projekte infrastrukturore, ruajtja e rritjes solide ekonomike, shpërndarja efikase, transparenca dhe llogaridhënia e burimeve publike, parashikueshmëria, sistemi tatimor efikas dhe i drejt dhe rritja e arkëtimit të të hyrave publike, reformat në financat publike, përmirësimi i kornizës makroekonomike dhe fiskale, analizat ekonomike, përforcimi i procesit të planifikimit, realizimi dhe raportimi i financave publike, përforcimi i kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm, rritja e transparencës dhe llogaridhënies gjatë punës në nivel qendror dhe lokal, avancimi i decentralizimit fiskal, kapaciteti fiskal dhe disiplina financiare, transparenca dhe llogaridhënia e komunave, reduktimi i ekonomisë gri dhe nxitja e iniciativave dhe investimeve private, vendosja e financimit buxhetor në institucionet pilot sipas parimit të përmbushjes së treguesve të zhvillimit (SMART - treguesit kryesorë të performancës), menaxhimi dhe koordinimi i cilësisë

me strukturat në procesin e aderimit në Bashkimin Evropian, duke shfrytëzuar efektivisht ndihmën aderuese nga Bashkimi Evropian dhe përforcimi i sistemit të menaxhimit financiar nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit cilësor tenderues në kuadër të IPA 3, mbrojtja e interesit financiar të Bashkimit Evropian, interesi nacional financiar, lufta kundër parregullsive dhe mashtrimeve, ruajtja e strukturës profesionale, të motivuar dhe efikase për implementimin e fondeve evropiane, harmonizimi i legjislacionit vendas me legjislacionin e Bashkimit Evropian janë prioritetet kryesore për periudhën e ardhshme afatmesme, me qëllim të menaxhimit të suksesshëm të financave publike, arritjes së rritjes më të lartë ekonomike dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pjesë e përcaktimeve strategjike janë krijimi i politikës efektive doganore që përkrah pikësynimet ekonomike qeveritare, ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të komunitetit të biznesit dhe përgjegjësi të kontrollit doganor për sigurimin e përkrahjes së tregtisë së ligjshme dhe arkëtimit të përmirësuar të detyrimeve, më tej zbatimi i politikës tatimore nëpërmjet arkëtimit dhe kthimit të tatimeve, kontributeve sociale nga pagat dhe detyrimeve të tjera publike, inspektimeve, si dhe monitorimit dhe analizimit të funksionimit të sistemit tatimor.

MBROJTJA

Qëllimi i politikës së mbrojtjes është realizimi dhe mbrojtja e interesave nacionale që rezultojnë nga Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dokumentet konceptuale dhe strategjike për siguri dhe mbrojtje. Nëpërmjet interesave nacionale ndahen edhe vlerat e përbashkëta të Aleancës së Mbrojtjes Kolektive, Menaxhimit të Krizave dhe Sigurisë Kooperative. Politika mbrojtëse e Republikës së Maqedonisë së Veriut ka për qëllim realizimin e tërësishëm të interesave themelore të mbrojtjes nacionale: mbrojtjen e pavarësisë, integritetit territorial dhe paprekshmërinë e kufijve të njohur ndërnacionalisht të shtetit, kontributin në vendosjen e paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon, në Evropë dhe në botë, si dhe përkrahjen e institucioneve civile në situata dhe kushte të ndryshme krizash, emergjente dhe luftarake.

Me anëtarësimin e plotë në NATO, Republika e Maqedonisë së Veriut realizoi një nga qëllimet më të rëndësishme strategjike, si në aspektin e mbrojtjes ashtu edhe në atë të politikës së jashtme. Njëkohësisht është bërë përogres i madh në rrugën drejt anëtarësimit në BE dhe në pritje të fillimit të bisedimeve aderuese. Zhvillimi dhe avancimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal mbesin gjithashtu qëllime strategjike dhe afatgjata të politikës mbrojtëse të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me qëllim të përkrahjes së sigurisë nacionale, sistemi mbrojtës i Republikës së Maqedonisë së Veriut duhet të jetë vazhdimisht i gatshëm për të kryer këto misione mbrojtëse:

- mbrojtjen e pavarësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe aleatëve të NATO-s;
- përforcimin e sigurisë dhe stabilitetit rajonal dhe global duke marrë pjesë në operacionet dhe misionet ndërkombëtare dhe
- përkrahjen e pushtetit civil dhe qytetarëve.

Sipas angazhimeve politike të aprovuara për investime në mbrojtje, si dhe qëllimeve të përcaktuara në dokumentet strategjike nacionale, përqindja e PBB-së e alokuar në buxhetin e mbrojtjes do të rritet për 0.2 pikë përqindje në nivel vjetor, derisa të arrijë në 2% të PBB-së deri në vitin 2024. Pikësynimi nacional është të ruajë buxhetin e mbrojtjes në nivel stabil në

minimum prej 2% të PBB-së pas vitit 2024.

Financimi i mbrojtjes është një nga elementët më të rëndësishëm që kontribuon në krijimin e parakushteve për përforcimin dhe mirëmbajtjen e suksesshme të të gjithë sistemit të mbrojtjes. Njëkohësisht, në vitet e kaluara, vëmendje e madhe i është kushtuar veçanërisht detyrimit të ndërmarrë që rezulton nga angazhimet e NATO-s për të investuar në mbrojtje, duke siguruar mjete në vlerë prej 2% të PBB-së dhe investime në minimum prej 20% në furnizimin me pajisje dhe modernizimin, nga ku do të financohen qëllimet, detyrat, aktivitetet dhe projektet e përcaktuara, struktura e projektuar e organizimit-formacionit, detyrimet e ndërmarra ndërkombëtare për të marrë pjesë në operacione dhe misione ndërkombëtare, detyrimet e ndërmarra për përmbushjen e pakove-qëllimeve të pranuar të aftësive të ndëmarra nga NATO-ja dhe nevojat për furnizimin me pajisje dhe modernizimin.

Qëllimet afatgjata plotësuese për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve mbrojtëse për periudhën e ardhshme afatmesme ndahen në tre grupe:

Riorganizimi dhe harmonizimi:

- harmonizimi i prioriteteve të planifikimit të mbrojtjes nacionale me prioritetet e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s, për të përmbushur qëllimet e kërkuara të kapaciteteve të NATO-s;
- avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit dhe menaxhimit të talentit që do të mundësojë tërheqjen, përzgjedhjen, rekrutimin, mbajtjen dhe angazhimin e personelit të cilësisë së lartë, të kualifikuar dhe të motivuar me kompetenca të përshtatshme profesionale dhe të punës në mbrojtje dhe Armatë dhe
- ndërtimi i sistemit modern arsimor dhe trajnimi i personelit të mbrojtjes dhe Armatës, bazuar në kompetencat, nevojat e identifikuara dhe integritetin e përforcuar.

Modernizimi:

- modernizimi dhe furnizimi me pajisje për Armatën;
- rivitalizimi dhe konsolidimi funksional i lokacioneve optimale të komplekseve, objekteve, instalimeve dhe infrastrukturës mbrojtëse dhe transformimi drejt mbrojtjes së gjelbër;
- avancimi i planifikimit dhe zbatimi logjistik në të gjitha nivelet dhe
- përmirësimi i sistemit të komunikimit dhe informacionit për përkrahjen e menaxhimit, udhëheqësisë dhe kontrollit në mbrojtje dhe zhvillimi i aftësive për mbrojtjen kibernetike.

Kontributi:

- integrimi në strukturën politike dhe ushtarake të NATO-s dhe interoperabiliteti, sipas standardeve të NATO-s, si dhe pjesëmarrja në mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë kooperative;
- siguri i elementit nacional për përkrahjen e Armatës në operacionet jashtë vendit;
- siguri dhe përkrahja e forcave të NATO-s në rolin e vendit nikoqir dhe
- integrimi i mbrojtjes ajrore nacionale në sistemin e mbrojtjes ajrore të Aleancës.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Број на лица на служба во странство како претставници на МО	30	58	31	33	35	38	40	42
Број на лица на кои учествуваат во меѓународни мисии и операции	210	117	226	250	300	280	300	310
Број на проекти за изградба, реконструкција, адаптација и модернизација на објекти и инфраструктура	12	20	15	17	22	23	25	25
Број на мажи и жени кои се упатуваат на стручно оспособување и усовршување во странство	\	жени	жени	жени	жени	жени	жени	жени
		32	35	38	42	50	55	58
	\	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи
		130	135	145	150	155	160	165
Број на мажи и жени кои се упатуваат на стручно оспособување и усовршување во земјата	\	жени	жени	жени	жени	жени	жени	жени
		172	176	181	185	190	195	202
	\	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи	мажи
		310	313	315	318	322	325	328

RENDI PUBLIK DHE PAQJA

Shërbimet policore

Aktivitetet e përfshira në këtë politikë orientohen në shkallën më të lartë të sigurisë, mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimin e cilësisë së jetës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ato destinohen në realizimin e qëllimeve të mëposhtme:

- zbatimin e sistemit të sigurisë publike;
- parandalimin e rrënimit të dhunshëm të institucioneve demokratike të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- mbrojtjen e jetës dhe sigurisë personale dhe pronës së qytetarëve;
- parandalimin e nxitjes së urrejtjes ose jotolerancës nacionale, racore, fetare;
- parandalimin e kryerjes së krimeve dhe kundërvajtjeve, zbulimin dhe kapjen e autorëve të tyre dhe ndërmarrjen e masave të tjera të përcaktuara me ligj për ndjekjen penale të autorëve të këtyre krimeve;
- mbrojtjen dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut dhe qytetarit të garantuara me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe
- ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike në vend.

Në periudhën e ardhshme afatmesme parashien një sërë aktiviteteve që do të kontribuojnë në:

- implementimin e aktiviteteve të përcaktuara në Strategjinë e zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve të teknologjisë kriminale në nivel rajonal dhe lokal 2020 - 2025;
- luftën joselektive kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, reformës në drejtim të sundimit të ligjit dhe krijimin e institucioneve të pavarura;
- parandalimin e krimit ndërkufitar dhe migrimin ilegal si dhe kontrollin e ripranimit dhe ushtrimit të së drejtës për azil;
- rritjen e nivelit të sigurisë publike, duke përfshirë sigurinë në komunikacionin rrugor;
- bashkëpunimin dhe vendosjen e standardeve të përbashkëta për sigurinë kibernetike dhe

- përkrahjen në drejtim të përpjekjeve ndërkombëtare për ruajtjen e paqes nëpërmjet zbatimit të aktiviteteve për përgatitjen e qëllimeve të ardhshme të NATO-s.

Gjykatat dhe institucionet ndëshkuese - korrektuese

Kjo fushë funksionale përfshin detyrat programore dhe aktivitetet operative që kanë të bëjnë me: gjyqësorin, prokurorinë publike, avokaturën e shtetit, noterin, përmbaruesit, ndërmjetësimin, avokatinë, ndihmën juridike falas, trashëgiminë, pronësinë, të drejtat reale dhe marrëdhëniet e detyrimeve, ndihmën juridike ndërkombëtare, ekzekutimin e sanksioneve për veprat penale dhe kundërvajtjet, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve ndëshkuese dhe korrektuese, si dhe edukuese dhe korrektuese, ekspertizat e gjykatave dhe ekspertizat e superekspertizës; procedurat penale, kundërvajtëse, kontestimore, jokontestimore dhe administrative, si dhe çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.

Prioritetet dhe aktivitetet e planifikuara:

- sistemi i gjyqësorit efikas, i pavarur dhe profesional;
- lufta kundër korrupsionit;
- realizimi i të drejtave të njeriut;
- plotësimi i kriterëve për anëtarësim në BE në fushën e “Drejtësisë”;
- avancimi i teknologjive informatike dhe të komunikimit në sistemin e gjyqësorit dhe
- institucionet ndëshkuese dhe korrektuese të organizuara dhe të menaxhuara në mënyrë profesionale.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Вкупен број на корисници на примарна и секундарна бесплатна правна помош	820	970	3,500	3,800	4,000	4,500	5,000	6,000
Регистрирани прекршоци против јавниот ред и мир	7,973	6,708	6,500	6,300	6,100	6,000	5,800	5,400
Регистрирани прекршоци од областа на сообраќајот	204,246	205,674	195,000	160,000	145,000	140,200	130,500	120,000
Зголемен процент на баратели, мажи и жени на бесплатна правна помош	/	жени 166, мажи 88	жени 125, мажи 100	жени 130, мажи 110	жени 137, мажи 115	жени 145, мажи 120	жени 155, мажи 130	жени 163, мажи 135

ÇËSHTJET EKONOMIKE

Bujqësia, pylltaria, gjuetia dhe peshkimi

Për sigurimin e bujqësisë moderne, zbatohen një sërë aktivitetesh për shfrytëzimin ekonomik të burimeve natyrore në mënyrë të qëndrueshme nëpërmjet masave për përkrahjen e zhvillimit të prodhimit primar bujqësor dhe blegtoral duke respektuar parimet e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit jetësor; përpunimin dhe marketingun e produkteve bujqësore me origjinë shtazore dhe bimore; sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të zonave rurale; avancimin e gjuetisë dhe peshkimit, sigurimin e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve dhe bimëve për të mundësuar

sigurinë, stabilitetin dhe bazën e zhvillimit të bujqësisë, duke ndikuar kështu në rritjen e përgjithshme ekonomike.

Me Programin nacional për zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimit rural për periudhën 2023 - 2027 janë planifikuar këto aktivitete:

- prodhimi stabil i ushqimit cilësor;
- rritja e konkurrencës së bujqësisë;
- të hyra të qëndrueshme të ekonomive bujqësore;
- zhvillimi i qëndrueshëm i zonave rurale dhe
- shfrytëzimi optimal i burimeve natyrore duke respektuar parimet e mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit jetësor.

Qëllimi strategjik është përmirësimi i konkurrencës së sektorit bujqësor në tregun e hapur dhe të ndryshuar dhe ruajtja e zhvillimit të zonave rurale me shfrytëzimin optimal të burimeve natyrore të angazhuara, që do të arrihet përmes realizimit të qëllimeve specifike të politikës bujqësore në periudhën e mëposhtme në fushat e mëposhtme:

- ristrukturimi dhe modernizimi i sektorit bujqësor dhe ushqimor;
- rregullimi i tregjeve, organizimi i zinxhirit ushqimor dhe përmirësimi i cilësisë së produkteve bujqësore;
- përmirësimi i kushteve të jetesës dhe aktiviteteve ekonomike në zonat rurale;
- qasja e vazhdueshme në njohuri dhe investime në kapitalin njerëzor në bujqësi;
- plotësimi i funksionalitetit të sistemit të sigurisë ushqimore dhe
- menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, si dhe lehtësimi i ndikimit të ndryshimit klimatik në bujqësi.

Me qëllim të tejkalimit të qasjes tradicionale në bujqësi dhe avancimit të saj, reforma bujqësore filloi ta ndryshojë modelin e subvencionimit, që do të mundësojë siguri, stabilitet dhe bazë për zhvillimin e bujqësisë.

Për sigurimin e mbrojtjes më të madhe të shëndetit të njerëzve, sigurisë ushqimore, mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, mirëqenies së tyre, shëndetit publik veterinar, mbrojtjes së mjedisit jetësor nga mbetjet me origjinë shtazore përmes kontrollit të dispozitave në përputhje me standardet e larta të BE-së, do të përforcohet sistemi për kontrollin e sigurisë dhe cilësisë së ushqimit të destinuar për konsum njerëzor dhe ushqimit të kafshëve, si dhe shëndetit publik veterinar dhe do të punohet në harmonizimin e mëtejshëm të politikave të BE-së në fushën e sigurisë ushqimore dhe shëndetit publik veterinar.

Qëllimi është arritja e nivelit më të lartë në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të kafshëve nga sëmundjet infektive dhe sëmundjet e tjera, që përfshin monitorimin dhe parandalimin e shfaqjes së sëmundjeve të reja të kafshëve dhe zoonozave të njerëzve në vend, kontrollin dhe mbikëqyrjen përkatëse të sëmundjeve që janë të pranishme në vend me reduktimin gradual të tyre, duke ruajtur sistemin e kontrollit, mbikëqyrjes dhe gatishmërisë për luftimin dhe eliminimin e sëmundjeve infektive veçanërisht atyre të rrezikshme.

Energjetika

Prioritetet dhe pikësynimet strategjike në fushën e energjetikës destinohen në zhvillimin e qëndrueshëm energjetik të vendit, shfrytëzimin efikas të energjisë dhe burimeve energjetike, plotësimin e nevojave të shoqërisë për energji elektrike dhe termike, gaz natyror dhe lëndë djegëse, krijimin e prodhimit të energjisë më të pastër dhe më efikase nëpërmjet shfrytëzimit racional të burimeve të energjisë konvencionale dhe të ripërtëritshme dhe përmirësimin e

menaxhimit të burimeve natyrore. Tendenca është të sigurohet furnizim i besueshëm, i sigurt dhe i qëndrueshëm me energji.

Qëllimet nacionale në fushën e energjetikës, mekanizmat dhe afatet për zbatimin e tyre janë përcaktuar në Strategjinë e zhvillimit të energjetikës në Republikën e Maqedonisë së Veriut deri në vitin 2040.

Qëllimi për arritjen e sigurisë energjetike të vendit në periudhën e ardhshme afatmesme do të realizohet përmes:

- rritjes së pjesëmarrjes së llojeve të ripërtëritshme të energjisë në konsumin final të energjisë;
- mbrojtjes së mjedisit jetësor dhe inkurajimit të efikasitetit energjetik;
- sigurimit të sigurisë dhe stabilitetit energjetik;
- liberalizimit të tregut të energjisë elektrike dhe rritjes së investimeve në sektorin energjetik;
- rritjes së shfrytëzimit të gazit natyror dhe shfrytëzimit të energjisë diellore në amvisëri dhe
- integritetit të tregjeve të energjisë elektrike me vendet e rajonit dhe shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Në drejtim të përballimit të efekteve të krizës energjetike dhe të çmimeve, në periudhën e ardhshme pritet të miratohen një sërë masash: përkrahja direkte financiare për kategoritë më të ndjeshme, si shtesë financiare për mbulimin e një pjese të energjisë elektrike të konsumuar në amvisëritë dhe promovimi i burimeve të ripërtëritshme energjetike, inkurajimi i efikasitetit energjetik në amvisëri dhe kufizimet administrative të çmimeve.

Sektori energjetik vazhdon të përballet me varësinë nga importet e burimeve dhe energjisë, rritjen e çmimeve të burimeve të importuara energjetike dhe ndryshimet klimatike. Me këtë, fushat prioritare ku do të duhet të punohen janë: kufizimi i varësisë së jashtme nga importet duke diversifikuar furnizimin me energji, kursimi i energjisë dhe promovimi i shfrytëzimit të burimeve vendore dhe burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Diversifikimi i furnizimit me gaz dhe shmangia e pasojave nga kriza e gazit do të sigurohet përmes krijimit të Sistemit nacional të gazsjellësit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Krijimi, zhvillimi dhe avancimi i ZZHTI-së është mjet i rëndësishëm në strategjitë e rritjes ekonomike të Qeverisë së RMV-së, për shkak të mundësisë së zhvillimit ekonomik duke tërhequr kapitalin e huaj dhe vendas, zhvillimin e teknologjive të reja, zbatimin e tyre në ekonominë nacionale, rritjen e konkurrencës dhe punësimit.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Planit të rritjes së përshpejtuar ekonomike krijon masa për përkrahjen e ekonomisë, duke ofruar kushte të barabarta investimi për kompanitë e huaja dhe vendase dhe duke vendosur instrumente dhe mekanizma të rinj të financimit (Fondi Strategjik i Investimeve të Gjëlbra).

Qëllimi i këtij fondi është promovimi i investimeve të gjëlbra në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë infrastrukturën e gjëlbrë për investitorët në zonat, në energjetikë, në fushën e shërbimeve dhe përmirësimin e gatishmërisë teknologjike të kompanive vendore, si dhe përfshirjen e tyre në zinxhirët globalë të furnizimit.

Prioritetet në periudhën afatmesme të ardhshme përfshijnë:

- avancimin e aktiviteteve për qasje më të lehtë të investitorëve të huaj jashtë zonave në ZZHTI;
- avancimin e sistemit për perkujdesje të investitorëve “after care”;
- hapjen dhe zhvillimin e zonave të reja ZZHTI dhe zonave industriale, të cilat do të realizohen edhe me mekanizmat e Fondit Strategjik të Investimeve të Gjëlbra, për tërheqjen e investimeve me vlerë më të madhe të shtuar, kompanive që investojnë në inovacione, kërkime dhe zhvillim,

zgjerimin e investimeve në sektorët e shëndetësisë, farmacisë, TI-së etj.

Transporti

Në fushën e transportit kryhen projekte dhe aktivitete në drejtim të zhvillimit të politikave për sigurimin e sistemit transportues nacional dhe ndërkombëtar të disponueshëm, të besueshëm dhe të qëndrueshëm, infrastrukturës cilësore urbane dhe ndërtimore, si dhe ushtrimin e mbikëqyrjes mbi zbatimin e ligjeve në kompetencën e tij. Zhvillimi i infrastrukturës ndërtimore dhe transportuese është shtytësi i rritjes ekonomike të çdo vendi, prandaj vijon edhe përkushtimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për financimin e zhvillimit, përmirësimit dhe modernizimit të tyre. Si rezultat i kësaj, prioritetet në fushën e transportit janë: përmirësimi i gjithë rrjetit infrastrukturor në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmirësimi i gjitha segmenteve që kanë të bëjnë me transportin - rrugor, hekurudhor, ajror dhe në transportit të brendshëm ujor, si dhe përmirësimi i infrastrukturës banesore dhe komunale. Për arritjen e këtyre prioritetëve janë planifikuar këto aktivitete: ndërtimi i akseve të reja rrugore dhe rehabilitimi i një pjese të atyre ekzistuese, përfundimi i akseve rrugore dhe hekurudhore të korridoreve 8 dhe 10, krijimi i kushteve për transport efikas të udhëtarëve dhe mallrave; sigurimi i cilësisë së shërbimeve të transportit me cilësi të lartë dhe në nivel më të lartë sigurie, ndërtimi ose rikonstruimi i sistemeve të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të zeza që do të rezultojë në përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht në zonat rurale, ku do të përmirësohet cilësia e jetës dhe mbrojtja e mjedisit jetësor. Në realizimin e këtyre projekteve marrin pjesë edhe njësitet e administratës lokale.

Shoqëria e informatikës dhe administratës

Në fushën e shoqërisë së informatikës dhe administratës realizohen aktivitete në drejtim të politikëbërjes efektive, efikase dhe inkluzive me administratën eksperte, profesionale të departamentalizuar përmes funksionimit të përgjegjshëm, llogaridhënës dhe transparent të institucioneve; transformimit dixhital në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset; zhvillimit të mekanizmave për vendosjen e teknologjive moderne “5G” dhe zhvillimit të infrastrukturës “NGA”; krijimit dhe zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve të komunikimit elektronik.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Бројот на поддржани апликации за ранливи категории	/	4.388	5.500	6.000	6.200	6.200	6.500	6.500
Бројот на нови договори за странски и домашни инвестиции	6	10	10	14	18	22	26	30
Извоз на земјоделски производи (во милиони евра)	628	713	748	783	818	853	888	923
Жени носители на земјоделски стопанства (согласно Единствен регистер на земјоделски стопанства)	28.686	28.686	28.700	28.720	28.735	28.750	28.760	28.770

Zbatimi i politikave të mjedisit jetësor, veprimet klimatike, planifikimi hapësinor dhe sigurimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm, menaxhimi i mbeturinave, mbrojtja e ajrit, ujit, tokës, florës dhe faunës dhe monitorimi i gjendjes së mjedisit jetësor janë aktivitete që janë pjesë e politikës së mbrojtjes së mjedisit jetësor. Procesi i përcaktimit të qëllimeve strategjike dhe afatmesme, si dhe përshtatja e praktikave ekzistuese ose vendosja e praktikave të reja kontribuojnë në angazhimin për përmirësimin e mjedisit jetësor.

Këto politika zbatohen në nivel nacional dhe lokal, nëpërmjet masave dhe aktiviteteve të duhura të zbatuara nga subjekte të ndryshme nga sektori publik dhe privat për arritjen e pikësnyimeve të përcaktuara të cilat janë në funksion të: përmirësimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore dhe sigurimit të cilësisë, ujit të pijshëm, mbrojtjes dhe monitorimit të cilësisë së ajrit, monitorimit dhe reduktimit të zhurmës, menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së tokave dhe parandalimit të erozionit, parandalimit dhe zvogëlimit të emetimeve nga industria, mbrojtjes dhe shfrytëzimit të qëndrueshëm të diversitetit biologjik dhe rajonal dhe menaxhimit adekuat me zonat e mbrojtura, planifikimit hapësinor me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës dhe burimeve të tjera natyrore të krijuara, forcimit institucional dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e mjedisit jetësor për cilësinë e jetës dhe shëndetin e njerëzve.

Përmes zbatimit të këtyre masave dëshmohet përkushtimi për zhvillimin dhe zbatimin e politikave efektive të mjedisit jetësor, të udhëhequra nga faktorë ekologjikë, ekonomikë dhe politikë në nivel nacional dhe ndërnacional dhe duke zbatuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Ndër projektet më domethënëse që do të realizohen në periudhën e ardhshme afatmesme janë: rindërtimi i stacionit të filtrimit të ujit të pijshëm në Berovë, Komuna e Berovës, rindërtimi i ujësjellësit në Bogdancë, Komuna e Bogdancës, ndërtimi i kanalizimit fekal në vendbanimin Straçincë, Komuna e Gazi Babës, rindërtimi i tubacionit të ujësjellësit në Kriva Pallankë, rikonstrukcioni i burimeve, aktiviteteve të ujëmbledhësve dhe sanimi i tyre në Krushevë, rregullimi i një pjese të kanalit të Obodenit në v.b. Haraçinë, Komuna e Haraçinës, ndërtimi i ujësjellësit në Komunën e Dellçevës, projekti i financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe bashkëfinancuar nga Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për Qytetin e Shkupit, projekt me vlerë mbi 197.2 milionë euro, financuar me hua në vlerë prej 68.000.000 eurove nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI-ja), hua në vlerë prej 58.000.000 eurove nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH-i), mjete grant për asistencë teknike në vlerë prej 1.429.250 eurove, e siguruar me përkrahjen e BEI-së dhe BERZH-it, si dhe me mjete grant investimi prej 69.784.283 eurove nga WBIF-ja. Gjithashtu, një nga prioritetet më të mëdha, por edhe si prioritet nacional në kuadër të anëtarësimit në BE është realizimi i Projektit rajonal për mbetjet e ngurta, i cili do të realizohet përmes huasë prej 55 milionë eurove nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH-i), donacionit në vlerë prej 5 milionë eurove nga Sekretariati Shtetëror i Zvicrës së Çështjeve Ekonomike (SECO) dhe me mjete grant investimi prej 22.5 milionë eurove nga WBIF-ja. Ky projekt pritet të krijojë sisteme rajonale për menaxhimin e mbetjeve në pesë rajone në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që paraqet hap të rëndësishëm drejt zgjidhjes së qëndrueshme për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta.

Gjithashtu, u siguria huaja në vlerë prej 50.000.000.00 eurove nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI-ja) për financimin e ndërtimit të ujësjellësve, rrjeteve të ujësjellësit etj., në të gjitha komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në kuadër të Programit IPA, realizimi i projekteve për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës, ndërtimin e stabilimentit për trajtimin e ujërave të zeza, rehabilitimin dhe avancimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit, ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza, rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës etj.

Treguesit për përmbushjen e objektivave

Аутпут индикатор:	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Изградба на водоводни мрежи (во метри должина)	5.285	27.544	35.675	40.152	45.896	47.352	48.484	49.258
Изградба на канализациони мрежи (во метри должина)	581	19.750	34.200	38.553	40.689	41.254	41.568	42.567
Број на изработени елаборати за заштита на животната средина	432	500	450	490	510	530	540	550

SHËNDETËSIA

Zbatimi i politikës së shëndetësisë ka si qëllim përmirësimin e efektivitetit dhe kënaqësisë së qytetarëve nga funksionimi i sektorit dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore.

Prioritetet e kësaj politike për periudhën 2024 - 2028 janë:

- kujdesi për shëndetin e qytetarëve;
- ruajtja e sistemit shëndetësor stabil dhe
- rritja e sasisë dhe disponueshmërisë së shërbimeve shëndetësore.

Baza e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Maqedonisë së Veriut është mbrojtja parësore shëndetësore e orientuar ndaj individit, familjes dhe komunitetit, me theks në kujdesin shëndetësor parandalues dhe plotësimin e shumicës së nevojave shëndetësore të popullatës.

Në kuadër të kësaj politike realizohen aktivitetet që destinohen në përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore dhe kushteve për kujdes më të mirë shëndetësor të popullatës. Aktivitetet investive kanë si qëllim blerjen e pajisjeve mjekësore për nevojat e ISHP-ve në RMV, ndërtimin, rikonstruksionin dhe zgjerimin e objekteve në ISHP, si dhe realizimin e projektit “Ndërtimi i qendrës klinike në Shtip”.

Në kuadër të programeve shëndetësore parandaluese dhe kuruese ndërmerren aktivitete me qëllim të arritjes së komunikimit më të mirë dhe ofrimit të shërbimeve shëndetësore cilësore. Njëkohësisht, aktivitetet e programeve parandaluese destinohen drejt:

- parandalimit të sëmundjeve kardiovaskulare;
- ekzaminimeve sistimore të nxënësve dhe studentëve për parandalimin e plotë të deformimeve, zbulimin e zakoneve të këqija dhe sëmundjeve individuale në të gjithë popullatën shkollare dhe studentore;
- aktiviteteve për organizimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut;
- imunizimit të popullatës përmes blerjes së vaksinave;
- aktivitete që lidhen me zbulimin e hershëm të personave që mund të jenë të sëmurë me brucelozë;
- prokurimit të vazhdueshëm të barnave për personat e sëmurë nga tuberkulozi dhe për

mbrojtjen e popullatës nga SIDA;

- mbrojtjes aktive shëndetësore të nënave dhe fëmijëve dhe
- zbulimit të hershëm të sëmundjeve malinje duke bërë thirrje për ekzaminime dhe duke bërë Pap teste dhe skringing (depistim) për kancerin e qafës së mitrës tek gratë, aktivitetet e skringingut të kancerit të zorrës së trashë dhe aktivitetet e skringingut të kancerit të gjirit.

Aktivitetet e kryera në kuadër të programeve kuruese destinohen drejt:

- organizimit të vendeve për ekzaminime falas në sheshe dhe zona rurale, ekzaminime falas për parandalimin e valëve të të nxehtit në kuadër të programit - Shëndeti për të gjithë;
- mbrojtjes shëndetësore për personat me çrregullime mendore;
- prokurimit me metadon dhe buprenorfinë dhe shërbimit të plotë në trajtimin e personave me sëmundje të varësisë, sigurimit të shpenzimeve për pacientët e trajtuar me dializë dhe aktivitetet për pacientët me hemofili;
- prokurimit me barna për trajtimin e sëmundjeve të rralla dhe
- prokurimit me insulinë, gjilpëra të insulinës, glukagon, shirita matës të sheqerit dhe pompa për furnizimin e vazhdueshëm me insulinë për pacientët e varur nga insulina.

Sigurimi shëndetësor

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore i RMV-së është themeluar me qëllim të zbatimit të sigurimit të detyrueshëm shëndetësor, si institucion që kryen veprimtari me interes publik dhe autorizime publike të përcaktuara me ligj.

Fondi i Sigurimeve Shëndetësore siguron mjete për mbrojtjen shëndetësore bazë, për rrjetin e organizatave shëndetësore dhe financimin e veprimtarisë së organizatave shëndetësore, në bazë të çmimeve të shërbimeve shëndetësore, respektivisht programeve dhe marrëveshjeve për realizimin e kujdesit shëndetësor të personave të siguruar.

Fondi i Sigurimit Shëndetësor financon veprimtarinë e tij nga të hyrat vetanake (kontributet nga pagat) dhe nëpërmjet transfertave nga buxheti qendror.

në milionë denarë

	2021	2022	Буџет 2023	2024	2025	2026	2027	2028
Вкупен приход	35,986	38,711	41,636	43,791	46,020	48,392	50,905	53,573
Приход од придонеси	19,890	21,896	24,312	26,427	28,145	29,975	31,923	33,998
Трансфер од буџет	7,383	7,570	6,846	6,391	6,391	6,391	6,391	6,391
Други приходи	8,713	9,245	10,478	10,973	11,484	12,026	12,591	13,184
Процент на учество на трансфери од буџет во вкупен приход	21	20	16	15	14	13	13	12
Вкупни расходи	35,595	38,719	42,636	43,991	46,220	48,592	51,105	53,773
Здравствена заштита	31,146	33,913	37,564	38,641	40,650	42,812	45,315	47,973
Надоместоци за боледувања	3,905	4,244	4,500	4,700	4,900	5,100	5,100	5,100
Други расходи	544	562	572	650	670	680	690	700

Nga pasqyra tabelare shihet se me kalimin e vitevetë hyrat rriten dhe arrijnë deri në 35.9

miliardë denarë në vitin 2021, gjegjësisht janë parashikuar 41.6 miliardë denarë në vitin 2023. Transferta nga buxheti qendror ka tendencë të ulet, respektivisht në vitin 2021 arrin në 21% të të hyrave të përgjithshme, respektivisht janë projektuar 12% në vitin 2028.

Kontributet në paga nga sigurimet shëndetësore, transfertat nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale për pushimin e lehonisë dhe të hyrat tjera jotatimore kanë pesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave të Fondit.

Në pjesën e të hyrave nga kontributet në pagë përfshihen edhe kontributet për personat e papunësuar, të cilat i paguan Agjencia e Punësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pastaj kontributet për shfrytëzuesit e të drejtave sociale të paguara nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, kontributet për pensionistët që i paguan Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kontributet për personat e pasiguruar të paguara nga Ministria e Shëndetësisë.

Njëkohësisht, shpenzimet rriten me kalimin e viteve dhe arrijnë në 38.7 miliardë denarë në vitin 2022, gjegjësisht në vitin 2023 janë parashikuar 42.6 miliardë denarë.

Kapitacionet

Rritja e pikës së kapitacionit për mjekët amë, gjinekologët dhe stomatologët u realizua më 1 korrik të vitit 2016 dhe në muajin tetor të vitit 2019. Nga muaji janar i vitit 2023, vlera e tij u rrit sërish për mjekët e përzgjedhur në mjekësinë e përgjithshme dhe gjinekologji nga 63 denarë në 75 denarë. Për stomatologët e përzgjedhur, kapitacioni është rritur nga 48 në 61 denarë, për çdo person të siguruar.

Institucionet e shëndetit publik

Pakoja bazë e shërbimeve shëndetësore ndahet në: mbrojtjen shëndetësore parësore, mbrojtjen shëndetësore specialistike dhe konsultative dhe mbrojtjen shëndetësore spitalore. Si blerës i shërbimeve shëndetësore, Fondi lidh marrëveshje me institucionet shëndetësore për llojin dhe shtrirjen e shërbimeve shëndetësore.

Të hyrat e ISHP-së përfshijnë të hyra të arkëtuara nga Fondi, mjete nga programet e mbrojtjes shëndetësore, të hyrat vetanake dhe donacionet.

Buxheti i përgjithshëm i përcaktuar i mjeteve nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor për vitin 2021 për të gjitha ISHP-të është 24.8 miliardë denarë, ndërsa realizimi është 24.1 miliardë denarë, përkatësisht përqindja e shfrytëzimit të këtyre mjeteve është 97.2%.

Структура во 2021 год			во (000) денари		
Расходи	остварени расходи 2020 година	% на учество (2020)	остварени расходи 2021 година	% на учество (2021)	% 2021/2020
Основни плати и надоместоци	12.230.514	53,73%	12.492.652	51,70%	102,14%
Материјали и ситен инвентар	6.142.697	26,98%	6.664.619	27,58%	108,50%
Комунални услуги, греење, комуникација и транспорт	1.115.152	4,90%	1.066.383	4,41%	95,63%
Останати расходи	3.275.084	14,39%	3.941.567	16,31%	120,35%
Вкупно:	22.763.447	100%	24.165.222	100%	106,16%

Buxheti i përgjithshëm i përcaktuar i mjeteve nga Fondi i Sigurimit Shëndetësor për vitin 2022 për të gjitha ISHP-të është 23.3 miliardë denarë. Mjetet e përgjithshme të realizuara për shpenzimet e ISHP-së për periudhën janar - shtator të vitit 2022 arrijnë në 18.366.040 mijë denarë. Në periudhën janar-shtator të vitit 2022, shpenzimet e realizuara për paga dhe kompensime të ISHP-ve arrijnë në 9.800.636 mijë denarë.

Në strukturën e mjeteve të përgjithshme të paguara për shpenzime, mjetet e pagave përfshijnë 53.36% dhe në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2021 shënojnë rritje prej 4.7%. Shpenzimet e

realizuara për materiale dhe inventar të imët për periudhën janar - shtator të vitit 2022 janë në vlerë prej 4.690.516 mijë denarëve. Në strukturën e mjeteve të përgjithshme të paguara për shpenzime, mjetet për barna dhe materiale harxhuese mjekësore përfshijnë 25.54%. Mjetet e shpenzuara për shërbime komunale dhe shpenzime të tjera në periudhën janar - shtator të vitit 2022 përfshijnë 5.83%, respektivisht 15.27% të shpenzimeve të përgjithshme.

Структура на расходи јануари-септември 2022 год					во (000) денари
Расходи	остварени расходи јануари- септември 2021 година	% на учество (2021)	остварени расходи јануари- септември 2022 година	% на учество (2022)	% 2022/2021
Основни плати и надоместоци	9.360.585	55,04%	9.800.636	53,36%	104,70%
Комунални услуги, греење, комуникација и транспорт	752.422	4,42%	1.070.681	5,83%	142,30%
Материјали и ситен инвентар	4.423.114	26,01%	4.690.516	25,54%	106,05%
Останати расходи	2.470.497	14,53%	2.804.206	15,27%	113,51%
Вкупно:	17.006.618	100%	18.366.040	100%	107,99%

Buxheti i përgjithshëm i përcaktuar i mjeteve të Fondit të Sigurimit Shëndetësor për vitin 2023 për të gjitha ISHP-të është 23.2 miliardë denarë.

Rritja e pagave në shëndetësinë publike kryhej në disa vite: në muajin shtator të vitit 2018, të punësuarit e shëndetit publik kishin rritje për 5% në pagën bazë; në muajin janar të vitit 2019 kishte rritje shtesë të pagave për të punësuarit e shëndetësisë, mjekët, sanitarët teknikët, rritje për 5% për infermieret, 8% për infermieret e klinikave, 10% për mjekët specialistë dhe 5% për administratën shëndetësore. Në vitin 2020, pagat e mjekëve specialistë u rritën për 25% dhe pagat e infermiereve u rritën për 10%. Gjithashtu, në vitin 2022, pagat e të punësuarve të shëndetësisë u rritën për 5%.

Në vitin 2023, pagat e të punësuarve të shëndetësisë do të harmonizohen me pagën minimale.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Број на извршени контроли (контрола на придонеси, партиципација и плати, боледувања, лекувања во странство, контрола во јзу, специјални болници, аптеки и приватни ординации)	5.000	7.000	6.000	6.200	6.500	6.700	7.000	7.500
Број на склучени договори со пзу, јзу и аптеки	3.900	4.000	3.800	3.900	4.000	4.100	4.200	4.300
Процент на учество на приватните трошоци за здравство во вкупните здравствени трошоци на земјата	45	45	под 45%	под 45%	под 45%	под 45%	под 45%	под 45%

REKREACIONI, KULTURA DHE RELIGIONI

Shërbimet sportive dhe rekreative

Në fushën e sportit kryhen aktivitete që lidhen me zhvillimin dhe masivizmin e sportit, duke rritur përqindjen e qytetarëve që merren me sport, duke përmirësuar cilësinë e sportit nacional dhe ndërkombëtar, duke krijuar sistem në të cilin do të përparojë sporti profesional dhe rezultatet sportive, duke forcuar cilësinë e jetesës, ndërveprimi social, zhvillimi real i personalitetit dhe mënyra e jetesës së shëndetshme për shumicën e qytetarëve, siguri i infrastrukturës sportive cilësore, rritja e numrit të sportistëve dhe përmirësimi i rezultateve sportive, avancimi i barazisë gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore dhe përfshirja e

perspektivës gjinore në krijimin e politikave dhe buxheteve, si dhe përfshirjen gjithëpërfshirëse të personave me aftësi të kufizuara në të gjitha segmentet e sportit.

Shërbimet e kulturës

Sipas Ligjit të Kulturës, kultura përfshin tre segmente: krijimtarinë, si proces i krijimit të veprave artistike, aktivitetet për botimin e veprave artistike dhe aktivitetet për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e krijimtarisë. Prandaj, detyrat dhe obligimet që rezultojnë nga kompetencat specifike të përcaktuara detektohen në fushat e mëposhtme:

- veprimtaria në fushën e kulturës dhe artit;
- promovimi i kulturës, zhvillimit kulturor dhe politikave kulturore;
- bashkëpunimi ndërnacional dhe bashkëpunimi me UNESCO-n;
- bashkëpunimi me institucionet e BE-së dhe integrimi i vlerave evropiane;
- organizimi, zhvillimi dhe financimi i kulturës;
- monitorimi, analizimi dhe propozimi i akteve dhe masave për zhvillimin dhe avancimin e kulturës;
- mbrojtja, menaxhimi dhe rivitalizimi i trashëgimisë kulturore;
- realizimi dhe mbrojtja e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta;
- mbikëqyrja nga kompetenca në kulturë dhe
- përgatitja e rregulloreve dhe akteve të tjera në fushën e kulturës.

Financimi i interesit nacional në kulturë bëhet sipas Ligjit të Kulturës, me të cilin financohet puna e institucioneve nacionale në kulturë dhe merr pjesë në financimin e projekteve me interes nacional në kulturë sa i përket personave të tjerë juridikë dhe fizikë në veprimtaritë e mëposhtme: veprimtaria botuese, veprimtaria muzikore dhe skenike, veprimtaria dramatike, veprimtaria folklorike, manifestimet kulturore-artistike dhe artet pamore, arkitektura dhe dizajni, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, bashkëpunimi ndërnacional dhe integrimet evropiane.

Investimet në kulturë

Vëmendje e veçantë i kushtohet përmirësimit të kushteve të punës së artistëve duke ndërtuar godina të reja dhe duke investuar në godinat ku sistemohen institucionet nacionale në fushën e kulturës. Ndërtimi i Teatrit Turk në Shkup, Teatri dhe Biblioteka në Tetovë, Teatri në Strumicë, rindërtimi i Qendrës së Kulturës në Kumanovë, rindërtimi i Qendrës së Kulturës “ASNOM” në Gostivar, rindërtimi i Qendrës së Kulturës “Agimet e bardha” në Koçan, rikonstruksioni i kulmit të pjesës së vjetër të objektit të BNU-së “Shën Klimenti i Ohrit” në Shkup.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdojnë investimet me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës në kulturë dhe për rindërtimit të objekteve vijuese: Muzeu i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Galeria Nacionale e Maqedonisë, Qendra e Kulturës “Anton Panov” në Strumicë, Qendra e Kulturës “Marko Cepenkov” në Prilep, Qendra e Kulturës në Manastir dhe Teatri Nacional në Manastir.

Shërbime religjioze dhe shërbimet e tjera të bashkësive

Në fushën e religjionit kryhen punë në lidhje me statusin juridik të kishave, bashkësive religjioze dhe grupeve fetare, si dhe punë lidhur me marrëdhëniet e shtetit me kishat, bashkësitë religjioze dhe grupet fetare. Trajtohen çështje të ndryshme të rëndësishme për

shtetin, bashkësitë fetare, liritë dhe të drejtat fetare të qytetarëve, duke kontribuar aktivisht në përmirësimin e marrëdhënieve ndërkonfesionale dhe duke nxitur standarde të larta të dialogut dhe respektit.

Aktivitetet prioritare kanë për qëllim promovimin aktiv të vlerave kulturore dhe fetare të Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të bashkëpunimit të përhershëm dhe konstruktiv me kishat e regjistruara, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, institucionet shtetërore, promovimit të vlerave kulturore dhe fetare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe promovimit të bashkëpunimit ndërkonfesional, mbrojtjes së parimit të sekularizmit, promovimit të lirive, të drejtave fetare, bashkëpunimit ndërnacional dhe përforsimit të orientimit shërbyes ndaj nevojave të bashkësive fetare.

Qëllimet dhe aktivitetet prioritare për realizimin e prioritetit strategjik për periudhën e ardhshme afatmesme janë:

- promovimi i vlerave kulturore dhe fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe promovimi i bashkëpunimit ndërkonfesional;
- sigurimi i mbrojtjes së parimit të sekularizmit, promovimi i lirive dhe të drejtave fetare, si dhe bashkëpunimi ndërnacional;
- përforsimi i orientimit të shërbimit ndaj nevojave të komuniteteve fetare dhe arritja e bashkëpunimit të ngushtë me to.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Број на реализирани манифестации и фестивали од областа на драмската, издавачката, музичко сценската дејност, фолклорната дејност и манифестации по посебни конкурси	44	44	25	37	40	42	43	44
Опфат на граѓани со активности во дејноста спорт	15%	16%	16%	16%	17%	17%	17%	18%
Број на реализирани интрeдисциплинарни проекти со родова компонента во функција на подобрување на статусот на жената во општеството и број на жени носители на проекти			30	32	35	36	40	42

ARSIMI

Politikat e zbatuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në fushën e edukimit dhe arsimit të të gjitha llojeve kanë për qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, inkluziv dhe të integruar për pjesëmarrësit në procesin edukativo-arsimor, me programe moderne që u mundësojnë brezave të ardhshëm të fitojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetenca sipas nevojave të shoqërisë multikulturore demokratike, tregut të punës dhe sfidave të reja në mjedisin shkencor, teknologjik dhe global.

Baza për realizimin e aktiviteteve në fushën e arsimit për periudhën e ardhshme afatmesme rezulton nga Strategjia e arsimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2018 - 2025, e cila fillon nga gjendja ekzistuese në sistemin arsimor dhe ka si qëllim përmirësimin gradual të tyre, në përputhje me prioritetet e përcaktuara.

Në kuadër të kësaj politike, zbatohen një sërë masash dhe aktivitete në fushën e arsimit të të rriturve, organizimit, financimit, zhvillimit dhe avancimit të arsimit, edukimit dhe shkencës,

arsimit dhe edukimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe fëmijëve të të punësuarve tanë me punë të përkohshme dhe qëndrimin jashtë vendit, verifikimit të profesioneve, profileve në arsim, përmirësimit të standardeve të nxënësve dhe studentëve, zhvillimit teknologjik dhe përkrahjes së inovacioneve, kulturës informatike dhe teknike, zhvillimit të shkathtësive dixhitale dhe aktiviteteve të tjera që lidhen me arsimin. Përmes monitorimit, kontrollit të ekspertëve, hulumtimit, promovimit dhe zhvillimit të veprimtarisë edukative në fushën e arsimit parashkollor, fillor, të gjimnazit dhe artistik, arsimit të mesëm profesional dhe postsekundar, arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe arsimit të të rriturve, në veprimtarinë edukative-arsimore në konviktet e nxënësve, si dhe arsimit të fëmijëve të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut jashtë vendit me qëllim të mësimin të gjuhës amtare dhe kulturës, bëhet përmirësimi i sistemit arsimor.

Janë ndërmarrë aktivitete që destinohen në promovimin e arsimit të të rriturve, koordinimin e bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe organizatat e tjera për arsimin e të rriturve dhe sigurimin e cilësisë, veçanërisht përmes vendosjes së standardeve dhe kriterëve për arsimin formal dhe joformal të të rriturve. Organizohen lloje të ndryshme të vlerësimeve të nxënësve, duke përfshirë testet ndërkombëtare (Programi për Vlerësimin Ndërnacional të Studentëve - PISA dhe Studimi mbi Trendet në mësimin e matematikës dhe shkencave natyrore në nivel ndërnacional - TIMSS). Nëpërmjet kontrolleve, mbikëqyrjes inspektuese dhe kryerjes së vlerësimit integral përcaktohet zbatimi i rregullativës juridike lidhur me arsimin dhe cilësinë e procesit arsimor në të gjitha nivelet arsimore.

Drejt zhvillimit të komunitetit si shoqëri e bazuar në njohuri të avancuara, me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, më shumë vende pune më të mira dhe kohezion më të madh social, duke siguruar njëkohësisht mbrojtjen e mjedisit për brezat e ardhshëm dhe veçanërisht shkëmbimin, bashkëpunimin dhe mobilitetin në fushën e arsimit dhe trajnimit, bëhet promovimi dhe zbatimi i programeve evropiane në fushën e arsimit, trajnimit, rinisë dhe sportit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Aktivitetet në periudhën afatmesme destinohen në arritjen e prioriteteve të mëposhtme:

- krijimi i arsimit që është në interesin më të mirë të fëmijëve dhe që mundëson që çdo nxënës ta arrijë potencialin e tij të plotë;
- sigurimi i arsimit të lartë cilësor dhe inkluziv dhe përmirësimi i standardit të studentëve;
- rritja e investimeve dhe zhvillimit të shkencës, kërkimit dhe inovacionit dhe
- përmirësimi i sistemit të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Për arritjen e këtyre prioriteteve do të punohet në përmirësimin e përmbajtjes dhe llogaridhënies në arsimin fillor dhe të mesëm, rritjen e fushëveprimit të nxënësve dhe përmirësimin e inkluzivitetit dhe integritetit ndëretnik, përmirësimin e kushteve mësimore dhe arritjeve të nxënësve, investimin dhe zhvillimin e shkathtësive dixhitale dhe mendimit kritik, harmonizimin e arsimit dhe trajnimit profesional lidhur me nevojat e tregut të punës, zhvillimin e qendrave rajonale për arsim dhe trajnim profesional, modernizimin e sistemit të arsimit të të rriturve sipas perspektivës së të mësuarit gjatë gjithë jetës, zhvillimin e modelit të ri për financimin e arsimit fillor dhe të mesëm me formulën e re për shpërndarjen e dotacioneve bllok me kosto të përcaktuar për çdo nxënës, të llogaritur në bazë të standardeve, optimizimin e rrjetit shkollor, sigurimin e cilësisë dhe efektivitetit të arsimit të lartë në përputhje me praktikën e mira evropiane, zhvillimin e modelit të ri të financimit të arsimit të lartë, përmirësimin e sistemit të akreditimit dhe vlerësimit të arsimit të lartë, përmirësimin e jetesës

studentore dhe standardit të të rinjve, zbatimin e masave që do t'ua lehtësojnë punësimin e parë dhe mbajtjen e tyre në vend, përmirësimin e standardeve të nxënësve dhe atyre studentore, investimin në kushte më të mira në konviktet e studentëve, rindërtimi me efikasitet energjetik të konvikteve të studentëve, rritjen e mjeteve nacionale për veprimtaritë kërkimore, rritjen e bashkëpunimit ndërnacional në fushën e shkencës, kërkimit dhe inovacionit, krijimin e Strategjisë së specializimit të zgjuar, përmirësimin e sistemit të arsimit formal për të rriturit, si dhe zhvillimin e sistemit për vlefshmërinë e mësimi joformal dhe informal.

Treguesit për përmbushjen e qëllimeve

Аутпут индикатори	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Број на финансирани научноистражувачки проекти	40	80	65	100	100	100	100	100
Број на доделени стипендии на ученици средношколци Роми	870	899	950	960	960	970	980	1000
% на запишани ученички во грагежно-геодетска, земјоделско-ветеринарна и шумарско-дрвопереработувачка струка	34,53%	37,43%	39,00%	40,00%	42,00%	44,00%	46,00%	47,00%

MBROJTJA SOCIALE

Politikat në sferën e punës dhe çështjeve sociale përfshijnë shpenzimet për aktivitetet në fushën e marrëdhënieve të punës, punësimit dhe punësisë; sigurimin pensional dhe invalidor; mbrojtjen e të punësuarve në punë; sigurimin material të personave të papunësuar të përkohshëm; pagave dhe standardeve të jetesës; politikave sociale; politikës humane të popullsisë për shkak të zhvillimit të harmonizuar ekonomik dhe social; mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve; mbrojtjen e të rinjve dhe grave; mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara zhvillimore etj..

Në kuadër të kësaj politike realizohen aktivitetet që destinohen në përmirësimin e shërbimeve sociale, ndërsa aktivitetet investuese destinohen në ndërtimin, rikonstruimin dhe zgjerimin e objekteve të mbrojtjes sociale dhe azileve të të moshuarve, si dhe në realizimin e projekteve të financuara me mjete kreditore. Në kuadër të programeve, aktivitetet kanë për qëllim:

- realizmin e mbrojtjes sociale;
- zhvillimin e veprimtarisë për mbrojtjen e fëmijëve dhe
- financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale lidhur me invaliditetin, shoqatave të tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave të luftës kundër dhunës në familje, të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut etj.

Sigurimi pensional dhe invalidor

Ligji i Sigurimit Pensional dhe Invalidor rregullon sigurimin e detyrueshëm pensional të të punësuarve në marrëdhënie pune dhe personave fizikë që kryejnë veprimtari, bazat e sigurimit pensional të financuar nga kapitali, si dhe kushtet e veçanta në të cilat kategori të caktuara të personave të siguruar ushtrojnë të drejtat e tyre nga sigurimi pensional dhe invalidor. Fondi i Sigurimit Pensional dhe Invalidor financon punën e tij nga të hyrat vetanake dhe nëpërmjet transfertave të buxhetit qendror.

Sistemi pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut bazohet në tre shtylla:

- Shtylla e parë - sistemi i financimit aktual, sigurimi i bazuar në solidaritetin e brezave;

- Shtylla e dytë – sigurimi i detyrueshëm pensional i financuar nga kapitali dhe
- Shtylla e tretë – sigurimi pensional vullnetar i financuar nga kapitali.

Me rastin e planifikimit të shpenzimeve të pensioneve merren parasysh dispozitat aktuale ligjore, të cilat parashohin që i siguruari e përvetëson të drejtën e pensionit të pleqërisë kur mbush 64 vjet (burrë), respektivisht 62 vjet (grua) dhe së paku 15 vite stazh pensioni.

në milionë denarë

	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Вкупни приходи	81,495	85,128	93,354	101,134	106,039	111,011	116,217	121,667
Придонеси од плати	46,030	50,594	58,301	64,373	68,493	72,880	77,552	82,528
Трансфер од буџет	32,050	31,022	31,258	32,700	33,352	33,794	34,175	34,487
Други приходи	3,415	3,512	3,795	4,061	4,194	4,337	4,490	4,652
Процент на учество на трансфериод буџет во вкупен приход	39	36	33	32	31	30	29	28
Расходи	80,147	87,608	97,124	102,290	107,039	112,011	117,217	122,667
Пензии	6,289	67,567	75,000	78,750	82,687	86,821	91,162	95,721
Транзициони расходи до приватни фондови	9,233	10,827	11,800	12,700	13,000	13,300	13,600	13,900
Други расходи	8,623	9,214	10,324	10,840	11,352	11,890	12,455	13,046

	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028
Корисници на пензии	330,211	338,359	345,245	348,000	351,000	354,000	356,000	360,000

Nga paqyra tabelare mund të vërehet trendi i rritjes së të hyrave të Fondit, ku pjesëmarrje më të madhe në strukturën e të hyrave e kanë të hyrat nga kontributet e pagave (në vitin 2023 ato marrin pjesë me 62.4% të të hyrave të përgjithshme, ndërsa të hyrat nga buxheti qendror marrin pjesë me 33%). Gjithashtu, vërehet ulje në përqindje sa i përket transfertës së buxheti qendror, nga 38% në vitin 2021 në 29% në vitin 2028.

Në anën e shpenzimeve ka trend të rritjes, ku shpenzimet në vitin 2023 arrijnë në projeksionin prej 97.1 miliardë denarëve. Pjesëmarrje më të madhe kanë pensionet e paguara, të cilat në vitin 2022 janë 67.5 miliardë denarë, ndërsa sa i përket shtyllës së dytë, shpenzimet e tranzicionit janë 10.8 miliardë denarë.

Me ndryshimet në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor nga viti 2022 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.67/2022), bëhet ndryshimi i mënyrës së harmonizimit të pensioneve, gjegjësisht rregullohet harmonizimi i pensionit të moshës sipas lëvizjes së indeksit të kostos së jetesës në vlerë prej 50% dhe rritjes së pagës mesatare të paguar për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vlerë prej 50%. Pensioni harmonizohet më 1 mars dhe 1 shtator të çdo viti sipas përqindjes së përfutur si shumë e rritjes së indeksit të kostos së jetesës në gjysmëvjetorit paraprak dhe përqindjes së rritjes së pagës mesatare të paguar për të gjithë të punësuarit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjysmëvjetorin paraprak në raport me gjysmëvjetorin që i paraprin.

Përqindja e harmonizimit të pensioneve

година	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Прво усогласување	0,82	1,69	0,7	0	1,2	2,9	8.4
Второ усогласување	0,76	1,8	0,4	0,6	1,2	6.8	

Ligji i Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Social rregullon llojet e kontributeve për

sigurimet sociale të detyrueshme, obliguesit për pagesën e kontributeve, obliguesit për përlllogaritjen dhe pagesën e kontributeve, bazat mbi të cilat paguhen kontributet, normat e kontributeve, mënyrën e përlllogaritjes dhe kushtet e pagesës së kontributeve, kontrollin e përlllogaritjes dhe pagesën e kontributeve, si dhe çështje e tjera sinjifikative për përcaktimin dhe pagesën e kontributeve.

Sigurimi i detyrueshëm social përfshin kontributet për:

- sigurimin pensional dhe invalidor në bazë të pagesës rrjedhëse;
- sigurimin e detyrueshëm pensional të financuar nga kapitali;
- stazhin e punës së sigurimit që konsiderohet me rritjen e nivelit të kohëzgjatjes;
- sigurimin shëndetësor dhe
- sigurimin në rast papunësie.

Lidhur me përqindjen që ndahet për pagesën e kontributeve për sigurimet pensionale, vihet re ulje ndër vite, përkatësisht nga 21.2% në vitin 2008, kontributet janë ulur në 18.8% në vitin 2020 dhe janë të vlefshme në vitin 2024. Norma e kontributit për sigurimin e detyrueshëm pensional dhe invalidor, nga data 01.01.2020 shënon 18.8%, ndërsa vlera përcaktohet me Ligjin e Kontributeve të Sigurimit të Detyrueshëm Social ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 47/18).

процент на придонеси	Пензиско и инвалидско осигурување	Задолжително здравствено осигурување	Вработување	Дополнително здравствено осигурување	Вкупно
2008	21.2	9.2	1.6	0.5	32.5
2009	19	7.5	1.4	0.5	28.4
2010-2018	18	7.3	1.2	0.5	27
2019	18.4	7.4	1.2	0.5	27.5
2020	18.8	7.5	1.2	0.5	28

Tregu i punës dhe rritja e konkurrencës së fuqisë punëtore

Agjencia e Punësimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut me qendrat e saj të punësimit zhvillon dhe zbaton shërbime për rritjen e konkurrencës së fuqisë punëtore dhe plotësimin e nevojave të tregut të punës, përmes zbatimit të qasjes individuale në punën e orientuar ndaj nevojave të personave të papunësuar dhe punëdhënësve. Agjencia financon operacionet e saj nga të hyrat vetanake dhe përmes transfertës së buxhetit qendror.

në milionë denarë

	2021	2022	Буџет 2023	2024	2025	2026	2027	2028
ПРИХОДИ	3,691	3,795	3,804	3,828	4,067	4,303	4,553	4,777
Вкупно приходи од придонеси	2,918	3,214	3,392	3,668	3,927	4,163	4,413	4,677
Трансфери од Буџет	732	555	372	100	100	100	100	100
Други приходи	41	26	40	60	40	40	40	0
РАСХОДИ	3,363	3,303	3,804	4,022	4,096	4,303	4,552	4,778
Расходи за функција	3,047	2,961	3,47	3,632	3,706	3,913	4,162	4,388
Паричен надоместок за невработени	1,388	1,282	1,526	1,6	1,6	1,65	1,65	1,65
За активни политики за вработување	1,365	1,42	1,45	1,5	1,55	679	1,903	2,102
Други расходи	294	259	494	532	556	1,584	609	636
Расходи за стручна служба	316	342	334	390	390	390	390	390

Me planin operativ për programet dhe masat aktive të punësimit dhe shërbimet në tregun e

punës përcaktohen programet, masat dhe shërbimet e punësimit, të cilat do të sigurojnë hapjen e vendeve të reja të punës, përkrahjen për krijimin e vendeve të reja të punës dhe rritjen e punësimit të personave të papunësuar, veçanërisht të rinjtë, të papunësuar për një kohë më të gjatë dhe shfrytëzuesit e së drejtës së ndihmës financiare nga mbrojtja sociale, si dhe përkrahjen e personave të papunësuar, të cilëve ndërprerja e marrëdhënies së punës u është regjistruar gjatë periudhës së krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19.

Gjatë implemtimet të programeve dhe masave të punësimit respektohen parimet bazë të mëposhtme:

- ballafaqimi me efektet dhe pasojat negative në tregun e punës dhe punësimit të shkaktuara nga pandemia COVID-19;
- parimi i diversitetit dhe inkluzivitetit për të gjitha kategoritë shoqërore në sektorin privat në përputhje me parimet e përfaqësimit të drejtë dhe adekuat, etnikë, gjinorë, fetarë, racorë apo çdo kategori tjetër të ndjeshme të qytetarëve, në përputhje me standardet dhe praktikat e Kombeve të Bashkuara dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës dhe
- nxitja e zhvillimit të barabartë rajonal, në përputhje me të dhënat e Byrosë së Zhvillimit Rajonal dhe shkallën e zhvillimit të rajoneve të planifikimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Një nga qëllimet është ulja afatgjate e papunësisë dhe varësia nga të hyrat minimale të garantuara, duke përfshirë në mënyrë efektive grupet më të ndjeshme, veçanërisht shfrytëzuesit të të hyrave minimale të garantuara, në tregun e punës, përmes përfshirjes së tyre në programet dhe shërbimet e specializuara për zhvillimin e shkathtësive.

Po ashtu, definohen aktivitetet që do t'i mundësojnë çdo të riu të papunësuar që të përfshihet sërish në procesin arsimor (në arsimin jo të rregullt) ose të përfshihet në ndonjë nga masat ose shërbimet aktive të punësimit, që do t'i mundësojnë atij zgjerimin e mundësive të tyre për punësime, ose nga ana tjetër t'i ofrohet punësim adekuat që korrespondon me arsimimin dhe shkathtësitë e tij. Aktivitetet përfshijnë këshillime në grupe dhe në mënyrë individuale; sigurimin e shërbimeve për ndihmë gjatë kërkimit të punës; trajnime motivuese; përfshirje në ndonjë nga masat e integritetit të tregut të punës (masat e punësimit, arsimit dhe trajnimit).

Treguesit e përmbushjes së qëllimeve

<i>Аутпут индикатори</i>	<i>2021</i>	<i>2022</i>	<i>2023</i>	<i>2024</i>	<i>2025</i>	<i>2026</i>	<i>2027</i>	<i>2028</i>
<i>Број на подготвени решенија за остварување на право од пензиско и инвалидско осигурување</i>	30.325	33.500	31.300	31.500	31.600	31.700	31.800	31.900
<i>Број на корисници на родителски додаток за трето дете</i>	22.904	22.377	19.794	18.477	15.087	12.661	10.413	8.500
<i>Број на жени корисници на мерката Поддршка за креирање на нови работни места од Оперативниот план за вработување</i>		1.070	1.177	1.295	1.424	1.567	1.723	1.896

2.5 Buxheti i pushtetit lokal

Decentralizimi i kompetencave te pushteteve lokale dhe përmirësimi i kapaciteteve të tyre është një nga prioritetet që rezultojnë nga partneriteti për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE dhe Marrëveshja Kornizë. Që nga viti 2012, të gjitha komunat (përveç Pllasnicës) kanë financuar kompetencat e deleguara me dotacione bllok dhe menaxhimin e burimeve materiale dhe financiare për kompetencat e deleguara në arsim,

kulturë, mbrojtje sociale dhe të fëmijëve. Gjatë vitit 2023, nga Komuna e Pllasnicës është marrë njoftim se i plotëson kushtet për hyrje në fazën e dytë dhe është dërguar njoftim në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.


Kompetencat e ndërmarra në disa fusha nga komunat rritën kapacitetet administrative dhe fiskale dhe përforcuan kapacitetet për menaxhimin e vëllimit më të madh të mjeteve financiare. Me administrimin dhe arkëtimin e suksesshëm të të hyrave vetanake, vazhdon procesi i rritjes së të hyrave vetanake të komunave dhe fuqizimit të kapaciteteve për menaxhimin e mjeteve, realizimin më adekuat të kompetencave të deleguara dhe menaxhimin e mjeteve financiare dhe burimeve të tjera.

Gjithashtu, komunat administrojnë me sukses kompetencat e reja të menaxhimit të tokës ndërtimore, veprimet lidhur me objektet e ndërtuara pa leje, me ç'rast sigurohen të hyra shtesë. Zbatimi i suksesshëm i decentralizimit fiskal me kornizë ligjore dhe institucionale plotësisht të vendosur të vetëqeverisjes lokale siguron njësi të zhvilluara, të përgjegjshme dhe funksionale të vetëqeverisjes lokale dhe nivel në demokracinë lokale që i afron qytetarët me institucionet e vetëqeverisjes lokale. Progresi në arritjen e qëllimeve të decentralizimit është vlerësuar si i suksesshëm nga disa institucione ndërkombëtare me ndihmën e të cilave, në kuadër të disa projekteve, janë bërë përmirësime në sistemin e menaxhimit, kontrollit, transparencës dhe koordinimit të menaxhimit me reformat e vetëqeverisjes lokale.

Njëkohësisht, qasja në tregun e kapitalit u bë më e qasshme në bazë të kushteve më liberale dhe më transparente për huamarrje, fakt ky që rriti edhe interesin e komunave për financimin e projekteve investuese përmes huamarrjes. Në këtë drejtim, Qeveria siguroi linja kreditore nga institucionet financiare ndërkombëtare (Banka Botërore, BEI-ja, KfV-ja dhe BERZH-i) me të cilat janë realizuar investime të konsiderueshme si në: rikonstruimin dhe rehabilitimin e rrugëve lokale, rrugëve dhe urave, ndërtimin dhe rikonstruimin e rrjeteve të ujit të pijshëm dhe atij atmosferik, përmirësimin e higjienës publike dhe rritjen e efikasitetit energjetik në objektet publike komunale dhe rregullimin hapësinor lokal.

Republika e Maqedonisë së Veriut, sa i përket nivelit të decentralizimit, sipas të dhënave për realizimin e shpenzimeve në vitin 2022 (pjesëmarrje prej rreth 5% në PPB), hyn në grupin e vendeve që janë mesatarisht të decentralizuara. Po ashtu, në krahasim me vitin 2005, kur filloi procesi i delegimit të kompetencave dhe decentralizimi fiskal, të hyrat e komunave janë rritur për më shumë se gjashtë herë (në vitin 2005 realizimi ishte prej 5.9 miliardë denarëve, në vitin 2022 mbi 40 miliardë denarë). Në periudhën e njëjtë, të hyrat tatimore mbi të cilat komuna ka autonominë e arkëtimit janë rritur më shumë se tre herë (Grafiku 15).

Grafiku 13. Të hyrat vetanake dhe të hyrat e përgjithshme në periudhën 2005-2022 (në milionë denarë)



Komunat në Republikën e Maqedonisë së Veriut financohen nga burimet vetanake të të hyrave, dotacionet për kompetencat e deleguara në arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje nga zjarri, të siguruara nga Buxheti i RMV-së, të hyrat e përcaktuara me ligje të veçanta, të hyrat që u transferohen komunave nga tatimet ose kompensimet të cilat paguhen në nivel qendror, transfertat nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe institucionet e tjera të destinuara për realizimin e projekteve të caktuara kapitale, të hyrat nga donacionet dhe kreditë, si dhe të hyrat e tjera.

Të hyrat vetanake të komunave janë tatimet lokale (tatimi mbi pronën, tatimi mbi trashëgiminë dhe dhuratën, tatimi mbi qarkullimin e patundshmërive), taksat lokale të përcaktuara me ligj (taksat komunale, taksat administrative dhe taksat e tjera të përcaktuara me ligj), kompensimet lokale (kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore, kompensimet për veprimtaritë komunale, kompensimet për planet hapësinore dhe urbanistike), të hyrat nga prona dhe të hyrat e tjera të përcaktuara me ligj.

Me qëllim të avancimit të decentralizimit fiskal, në periudhën 2021-2024 janë planifikuar disa aktivitete dhe masa, të cilat janë të grupuara në tri shtylla, si në vijim: I. Përmirësimi i kapaciteteve fiskale dhe rritja e të hyrave të komunave, II. Rritja e disiplinës fiskale dhe III. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në punën e komunave. Qëllimi përfundimtar i këtij procesi është arritja e cilësisë më të lartë të shërbimeve publike, shkallës më të lartë të zhvillimit ekonomik dhe përmirësimi i standardit të jetesës.

Shtylla e parë e reformës ka për qëllim përmirësimin e kapacitetit fiskal dhe rritjen e të hyrave të komunave dhe zbatohet përmes disa aktiviteteve që parashikojnë rritjen e mjeteve të ndara për komunat nga të hyrat e inkasuara në buxhetin qendror, rritjen e të hyrave vetanake të komunave dhe shpërndarjen e mjeteve në drejtim të përkrahjes së performancës adekuate. Në këtë drejtim, në vitin 2022 është rishikuar Metodologjia për shpërndarjen e mjeteve të të hyrave nga tatimi mbi vlerën e shtuar, të cilat u shpërndahen komunave. Në vitin 2022, komunave iu ndanë 5% e tatimit mbi vlerën e shtuar të arkëtuar, i ndarë në tri pjesë: pjesa bazë - 4.5%, pjesa e performancës - 0.25% dhe pjesa e barazimit - 0.25%. Në vitin 2023, komunave iu siguruan mjete në vlerë prej 5.5% të tatimit mbi vlerën e shtuar të arkëtuar në vitin fiskal paraprak, që shpërndahen në tri pjesë: pjesa bazë - 4.5%, pjesa e performancës - 0.5% dhe pjesa e barazimit - 0.5%. Pjesa e performancës shpërblen komunat që kanë realizim më të mirë të të hyrave vetanake në krahasim me të hyrat vetanake të planifikuara dhe arkëtim më të lartë të të hyrave vetanake në vitin aktual krahasuar me mesataren e të hyrave vetanake të realizuara në tri vitet paraprake. Pjesa e barazimit ka për qëllim tejkalimin e diferencave sipas kapacitetit fiskal të komunave për shkak të kapacitetit të kufizuar të burimeve, përkatësisht komunat që kanë të hyra më të ulëta nga tatimi mbi të ardhurat personale për çdo banor marrin mjete shtesë. Është përgatitur formula dhe mjeti Eksel, ku në këtë drejtim shpërndahen mjetet e ndara, si dhe është miratuar rregullorja e re për Metodologjinë e shpërndarjes së të hyrave nga tatimi mbi vlerën e shtuar sipas komunave. Si rezultat i ndryshimeve në ligj, komunat gjatë vitit 2022 kanë marrë mjete shtesë prej 291 milionë denarëve, ndërsa në vitin 2023 subvencionin për TVSH-në është më i lartë për 652 milionë denarë krahasuar me vitin paraprak.

Me ndryshimet e fundit në Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale do të rriten gradualisht nga 3% në 6% deri në vitin 2024 nga tatimi mbi të ardhurat personale nga pagat e personave fizikë sipas vendbanimit të përhershëm në komuna, në mënyrë të tillë që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në fund të vitit 2022,

4% e të hyrave të arkëtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale iu transferuan komunave, ndërsa në vitin 2023, 5% e të hyrave të arkëtuara nga tatimi i të ardhurave personale. Komunat marrin 100% të të hyrave të arkëtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale nga personat fizikë që merren me veprimtari zejtare, të regjistruar në territorin e komunës. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale në vitin 2022 janë rritur për 131 milionë denarë krahasuar me vitin 2021, ndërsa për vitin 2023 ato parashihen të jenë më të larta për 247 milionë denarë krahasuar me vitin 2022.

Gjithashtu do të ndërmerren veprime për rritjen e të hyrave vetanake të komunave nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të administratës, si dhe sigurimit të të hyrave të reja lokale sipas praktikave më të mira nga BE-ja dhe përmirësimit të kriterëve për shpërndarjen e mjeteve të ndara për kompetencat e deleguara në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve dhe mbrojtjes së të moshuarve, si dhe mbrojtjes nga zjarri.

Njëkohësisht, komunat marrin të hyra shtesë përmes dotacioneve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, përkatësisht nga: transfertat kapitale, dotacionet bllok të destinuara për kompetencat e deleguara në arsim, kulturë, mbrojtje sociale dhe mbrojtje nga zjarri. Mjetet nga këto subvencione shpërndahen sipas kriterëve të përcaktuara me rregullore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozimin e ministrive kompetente. Gjatë vitit 2023 është ruajtur trendi i rritjes së vlerave të granteve të dedikuara dhe dotacioneve bllok për kompetencat e deleguara në fushën e arsimit, mbrojtjes sociale dhe të fëmijëve, kulturës dhe mbrojtjes nga zjarri. Vlerat për subvencione në vitin 2023 u planifikuan në 24.123 milionë denarë dhe janë më të larta për 18.5% në krahasim me vitin paraprak. Rritja është për shkak të rritjes së pagave për 15% për të punësuarit në arsimin fillor dhe të mesëm dhe rritjes së pagave për të punësuarit në institucionet e tjera lokale për 10% dhe pagesës së kompensimit për pushimin vjetor, si dhe për financimin e rritjes së shpenzimeve të transportit dhe energjisë elektrike.

Me ndryshimet e fundit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, komunave u janë shpërndarë mjete shtesë nga Buxheti, si transfertat kapitale për njësitë e vetëqeverisjes lokale për realizimin e 66 projekteve kapitale në vlerë prej 2.024 milionë denarëve. Këto mjete janë të destinuara për realizimin e investimeve kapitale si ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugicave dhe rrugëve lokale, rikonstruimi dhe ndërtimi i shkollave, kopshteve të fëmijëve dhe sallave sportive dhe këndeve të lojërave, mbrojtja e mjedisit jetësor etj.

Shtylla e dytë është në drejtim të rritjes së disiplinës financiare të komunave, punës ekonomike, me ç'rast parashihen masa për planifikimin real të të hyrave dhe shpenzimeve të komunave, racionalizimin në punën dhe reduktimin e shpenzimeve të panevojshme, servisimin e rregullt të obligimeve, disiplinën më të madhe financiare, shpalljen e jostabilitetit financiar, emetimin e fletobligacioneve komunale dhe analizat e obligimeve ekzistuese të komunave dhe ndërmarrjeve publike. Rritja e kontrollit nga ana e shtetit mund të sigurohet përmes inspektimeve të kryera nga inspektimi financiar në aspektin e respektimit të dispozitave të Ligjit të Paraqitjes dhe Evidencës së Detyrimeve, Ligjit të Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligjit të Disiplinës Financiare.

Planifikimi joreal i buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht planifikimi tejoptimist i të hyrave është një nga arsytet pse njësitë e vetëqeverisjes lokale kanë krijuar detyrime që janë rritur gjatë viteve paraprake. Për përmirësimin e kësaj situate, me ndryshimet në Ligjin e Financimit të Vetëqeverisjes Lokale, u vendosën rregulla fiskale për planifikimin dhe punësimin e buxheteve në bazë të vetëqeverisjes lokale, përkatësisht planifikimi i të hyrave

vetanake të buxhetit bazë të komunës kufizohet nga mesatarja e realizimit të të hyrave vetanake të realizuara në tri vitet paraprake, të rritura për një përqindje të caktuar. Me ndryshimet në Ligjin e Financimit të Vetëqeverisjes Lokale, i cili u miratua në muajin gusht të vitit 2022, sigurohet planifikim më real i buxheteve komunale, ku përqindja e rritjes së të hyrave vetanake mbi mesataren e përcaktuar të të hyrave vetanake të realizuara në tri vitet e fundit nga 30% reduktohet sërish në 10%. Gjithashtu, nëse komuna duke përfshirë tremujorin e tretë ka realizuar të hyra vetanake mbi 75% të të hyrave vetanake të planifikuara, në mënyrë shtesë mund të rrisë të hyrat e planifikuara në maksimum deri në 20%, duke filluar nga viti 2025. Gjithashtu, për vitin 2023, përqindja është 20% me 10% shtesë duke përfshirë tremujorin e tretë, ndërsa për vitin 2024, përqindja ishte 15% me shtesë prej 15%. Njëkohësisht, janë parashikuar përjashtime vetëm nëse komuna ka siguruar konfirmimin për transferimin e mjeteve nga institucioni përkatës ose në rastin e ndryshimeve në lidhje me vlerën dhe llojin e të hyrave vetanake të buxhetit bazë të përcaktuar me ligj.

Në pjesën e aktiviteteve që kanë të bëjnë me rritjen e disiplinës dhe efikasitetit financiar, uljen dhe riprogramimin e detyrimeve të maturuara dhe të papaguara të njësive të vetëqeverisjes lokale, Ministria e Financave u ka dhënë mundësinë komunave për shfrytëzimin e njërit nga tre instrumentet kreditore, për tejkalimin e problemeve me detyrimet e maturuara dhe të papaguara, si në vijim:

- shfrytëzimi i kredisë së kushtëzuar (standby) nga Ministria e Financave.
- emetimi i fletobligacionit komunal për blerës të njohur - Ministria e Financave.
- emetimi i fletobligacionit strukturor nga Ministria e Financave.

Kjo mënyrë e zgjidhjes së problemeve me detyrimet e papaguara lidhet me plotësimin e kushteve për shpalljen e jostabilitetit financiar. Njëkohësisht, në këtë pjesë përforcohet e gjithë procedura që nga momenti i shpalljes së jostabilitetit financiar deri në pjesën e tejkalimit të tij.

Komunave që kanë detyrime të larta të papaguara të raportuara në sistemin SEPED duke përfshirë datën 30.09.2021, u ofrohet mundësia që deri në fund të vitit 2022 të parashtrijnë kërkesë për shfrytëzimin e fletobligacionit strukturor. Nga 4 komuna janë pranuar kërkesa në Ministrinë e Financave, por gjatë procedurës një komunë ka refuzuar, kështu që komunat e Tetovës, Vinicës dhe Zhelinës janë tri pushtetet lokale që me kërkesën e tyre dhe me përkrahjen e pushtetit qendror i kanë shlyert detyrimet e maturuara. Fletobligacionet strukturore janë instrument i ri financiar i prezantuar me Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, ku komunat mund ta shfrytëzojnë për shlyerjen e detyrimeve të maturuara dhe të papaguara. Ato emetohen për 10 vjet, ndërsa me to mundësohet riprogramimi i detyrimeve, konsolidimi i buxheteve të tyre, por edhe mundësia për t'u fokusuar në zhvillimin e tyre. Vlera e fletobligacioneve të emetuara do të kthehet në këste të barabarta 10 vjeçare. Ministria e Financave emetoi fletobligacione strukturore në vlerë të përgjithshme prej 275 milionë denarëve, prej të cilave 250.2 milionë denarë për Tetovën, 21.7 milionë denarë për Zhelinën dhe 2.5 milionë denarë për Vinicën.

Gjithashtu, me përkrahjen teknike të USAID-it, u përgatit edhe Doracaku për shpalljen e jostabilitetit financiar, i cili është vendosur në ueb faqen e Ministrisë së Financave. Gjatë vitit 2023, Ministria e Financave monitoron rregullisht planifikimin aktual të të hyrave dhe shpenzimeve të komunave, monitorimin e realizimit të buxheteve dhe shpenzimeve të dedikuara, monitorimin e detyrimeve të maturuara të papaguara, monitorimin e kushteve për përmbushjen e jostabilitetit financiar dhe monitorimin e masave që do të ndërmerren nga komunat për tejkalimin e jostabilitetit financiar. Për rregullimin e çështjes së detyrimeve të

maturuara të papaguara gjatë vitit 2023, me asistencë teknike nga USAID-i, kanë filluar aktivitetet për hartimin e Ligjit të Menaxhimit të Borxheve Komunale dhe pritjet të miratohet drafti i versionit të këtij ligji deri në fund të vitit.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, në kuadër të shtyllës së tretë të avancimit të decentralizimit fiskal, janë planifikuar masa për rritjen e transparencës së komunave përmes publikimit të raporteve financiare në mënyrë transparente dhe të perceptueshme, si dhe do të ndërmerren veprime drejt rritjes së llogaridhënies për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore. Rritja e transparencës në funksionimin e komunave është një nga parakushtet për sigurimin e shfrytëzimit të mjeteve publike në mënyrë ligjore, të dedikuara dhe të përshtatshme në drejtim të arritjes së qëllimeve për rritjen dhe zhvillimin e komunave, si dhe ofrimin efikas të shërbimeve për qytetarët dhe përmirësimin e cilësinë e jetesës në komuna. Rritja e transparencës së komunave gjatë punës së tyre, para së gjithash i referohet përforsimit të përgjegjësisë fiskale të komunave, përfshirjes në kohë të publikut të gjerë në hartimin e politikave të komunës dhe informimit për punën e kryer. Në faqen e Ministrisë së Financave publikohen në bazë tremujore të dhënat për ecurinë e të hyrave dhe shpenzimeve të komunave dhe për detyrimet e prapambetura të raportuara në Sistemin elektronik të paraqitjes dhe evidencës së detyrimeve, si dhe në Raportin vjetor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshihet edhe Raporti vjetor i buxheteve të komunave. Me përkrahjen e UNDP-së, në faqen e internetit të komunave dhe në faqen e Ministrisë së Financave janë publikuar treguesit financiarë nga raportet periodike financiare të rreth 40 komunave.

Një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut është vazhdimi i procesit të decentralizimit, në drejtim të demokratizimit më të madh, shërbimeve publike më të mira (më cilësore dhe më të degëzuara) dhe zhvillimit të zgjeruar lokal në interes të qytetarëve. Njëkohësisht synohet që në periudhën vijuese të vazhdohet me politikat për zhvillimin e komunave, gjegjësisht decentralizimin fiskal dhe zhvillimin e barabartë rajonal, për përforsimin e mjeteve financiare të komunave, por edhe për rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës në punën e tyre, për komunat më afër qytetarëve.

Pas rimëkëmbjes ekonomike nga pasojat e shkaktuara nga pandemia e krizës energjetike COVID-19, parashikohen masa dhe politika për rritje të përsheptuar, inkluzive dhe të qëndrueshme ekonomike, të cilat synojnë qeverisjen e mirë, përkatësisht sundimin e ligjit, luftën kundër korrupsionit dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale. Këtu, gjithashtu bëjnë pjesë edhe masat e inkurajimit të decentralizimit fiskal, për sigurimin e zhvillimit rajonal lokal dhe të barabartë, mjedisit të qëndrueshëm të jetesës dhe dixhitalizimit të ekonomisë dhe shërbimeve publike.

2.5.1 Realizimi në periudhën janar - nëntor 2023

Realizimi i të hyrave dhe fluksit hyrës në buxhetet e njësive të vetëqeverisjes lokale për periudhën janar - nëntor të vitit 2023 është 39.854 milionë denarë dhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak shënon rritje prej 14.5%. Nga kjo vlerë, 10.565 milionë denarë janë të hyra tatimore, të cilat shënojnë rritje prej 12.4% në krahasim me vitin paraprak. Në këtë periudhë nga viti 2023, realizimi i të hyrave nga tatimi mbi pronën është 3.824 milionë denarë, me ç'rast vërehet rënie e vogël prej 2%. Te tatimi mbi të ardhurat prej 821 milionë denarëve ka rritje të konsiderueshme prej rreth 71%, kryesisht si rezultat i rritjes së pagës minimale, rritjes së pagave të të punësuarve, para së gjithash në arsim dhe mbrojtje sociale dhe rritjes së përqindjes së tatimit mbi të ardhurat personale që u shpërndahen komunave. Realizimi i të

hyrave nga tatimet për shërbime specifike janë 5.854 milionë denarë dhe shënon rritje prej rreth 18%, ndërsa te taksat e shfrytëzuesve apo lejet për kryerjen e veprimtarive shënohet rritje prej 27.3%.

Në periudhën e analizuar, të hyrat jotatimore janë 1.329 milionë denarë dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022, shënojnë rritje prej 7.7%. Në kuadër të të hyrave jotatimore, dominojnë flukset hyrëse nga taksat dhe kompensimet, në vlerë prej 965 milionë denarëve, të cilat shënojnë rritje prej 14.3% krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, ndërsa të hyrat tjera jotatimore janë 282 milionë denarë me rënie prej 6.9%. Të hyrat e tjera jotatimore janë rreth 82 milionë denarë dhe shënojnë rënie të lehtë prej 5.4% në krahasim me vitin paraprak.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2023 janë realizuar të hyra kapitale në vlerë prej 1.776 milionë denarëve ose rritje prej 7.4% krahasuar me vitin paraprak. Të hyrat kapitale kryesisht përbëhen nga të hyrat lidhur me shitjen e tokës dhe investimet jomateriale.

Në periudhën e analizuar nga viti 2023, të hyrat nga dotacionet për kompetencat e deleguara në arsimin fillor dhe të mesëm, kulturën, kopshtet e fëmijëve dhe shtëpitë e të moshuarve dhe mbrojtjen nga zjarri janë 21.674 milionë denarë, përkatësisht shënojnë rritje prej rreth 17%. Të hyrat nga transfertat nga buxheti qendror dhe nga nivelet tjera të pushtetit në periudhën janar - nëntor të vitit 2023 janë 3.864 milionë denarë dhe shënojnë rritje të konsiderueshme prej rreth 25% në krahasim me ato që janë realizuar në të periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Në periudhën janar - nëntor të vitit 2023, të hyrat nga donacionet u realizuan në vlerë prej 547 milionë denarëve, që paraqet rënie prej 13.5% në krahasim me vitin e kaluar, ndërsa flukset hyrëse nga kreditë u realizuan në vlerë prej 99 milionë denarë dhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ato shënojnë rënie të theksuar prej rreth 61%.

Shpenzimet e realizuara në periudhën janar - nëntor të vitit 2022 shënojnë 37.891 milionë denarë dhe krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar u konstatua rritje e dukshme prej 10.1%. Me këto shpenzime, rregullisht shlyhen detyrimet e ndërmarra në përputhje me kompetencat e deleguara të komunave, të nevojshme për punën e vazhdueshme, realizimin e projekteve kapitale dhe shlyerjen e principalit për kreditë e marra paraprake.

Në strukturën e shpenzimeve, pjesëmarrje më të madhe me 56.5%, gjegjësisht 21.396 milionë denarë përbëjnë shpenzimet për paga dhe kompensime dhe në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë rritje të theksuar prej 18.5%. Pjesa më e madhe e pagave, gjegjësisht 84.3% ose 18.041 milionë denarë, janë destinuar për të punësuarit në institucionet lokale të arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, kopshteve të fëmijëve dhe shtëpive të të moshuarve dhe mbrojtjes nga zjarri, të cilat rreth 98.8% financohen me dotacione bllok. Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë 7.720 milionë denarë dhe përbëjnë 20.4% në shpenzimet e përgjithshme që janë 5.3% më të ulëta në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Shpenzimet kapitale janë 14%, respektivisht 5.293 milionë denarë, të cilat në përqindje më të madhe, gjegjësisht 89.7% financohen nga mjetet vetanake të komunës, 3.5% janë mjete nga donacionet, 1.9% mjete nga kreditë, 4.1% mjete granti dhe 0.7% nga aktivitetet vetëfinancuese. Rritje e vogël prej 2.4% është vërejtur te shpenzimet kapitale, që tregon lëvizje të lehtë të investimeve kapitale dhe tejkalim të pasojave të rritjes së çmimit të naftës, derivateve të naftës dhe të energjisë elektrike. Shpenzimet për subvencione dhe transfertat janë 2.798 milionë denarë dhe marrin pjesë me 7.4%, ndërsa pagesa e principalit është 509 milionë denarë ose 1.3% të shpenzimeve të përgjithshme. Shpenzimet e realizuara nga rezervat, benefitiet sociale dhe pagesat e interesit marrin pjesë me rreth 0.5%.

2.5.2 Korniza afatmesme e buxhetit të pushtetit lokal

Një nga prioritetet e theksuara në Programin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për periudhën 2022-2024 është vazhdimi i procesit të decentralizimit. Kjo synon të sigurojë demokratizim shtesë të shoqërisë, sigurim dhe ofrim më efikas dhe ekonomik të shërbimeve, por edhe rritje të zhvillimit lokal.

Qëllimi është që kompetencat të delegohen në nivelin e menaxhimit që është më afër qytetarëve, në mënyrë që ato të realizohen në mënyrë efektive, me mjete adekuate financiare dhe përfshirje të garantuar të qytetarëve në marrjen e vendimeve. Në periudhën vijuese do të vazhdojnë politikat për zhvillimin e komunave, përkatësisht decentralizimin fiskal dhe zhvillimin e barabartë rajonal me qëllim të përforcimit të burimeve financiare të komunave, por edhe rritjen e përgjegjësisë dhe transparencës së punës së tyre. Qeveria do të sigurojë burime (organizative dhe financiare) për t'i ndihmuar veçanërisht komunat më të vogla që nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t'u ballafaquar menjëherë me zbatimin e projekteve të mëdha. Në këtë mënyrë do të stimulohet zhvillimi lokal dhe rajonal, veçanërisht përmes shfrytëzimit maksimal të fondeve paraaderuese dhe fondeve të reja strukturore dhe të kohezionit të Bashkimit Evropian.

Pritet që komunat të vazhdojnë me arkëtimin më adekuat të të hyrave vetanake, duke fuqizuar kapacitetet për zhvillimin e politikave financiare komunale dhe fuqizimin e kapaciteteve për menaxhim financiar. Për arritjen e përcaktimeve strategjike edhe në periudhën e ardhshme, do të vazhdojë angazhimi i fuqishëm për zbatimin e nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm lokal, qeverisjes së duhur lokale dhe krijimit të kushteve për rol më aktiv, efektiv dhe inovativ të pushteti lokal në realizimin e pikësynimeve nacionale për rritje dhe zhvillim.

Duke marrë parasysh aktivitetet e ndërmarra në vitin 2023 lidhur me përfundimin e fazës së dytë të decentralizimit fiskal, gjatë vitit 2024 pritet që të përfundojnë të gjitha aktivitetet për hyrjen e komunës së Pllasnicës në fazën e dytë të decentralizimit fiskal.

Në vitin 2024, Ministria e Financave do të vazhdojë aktivitetet në lidhje me reformën e filluar për avancimin e decentralizimit fiskal, që ofron zgjidhje serioze sistemore për financat e qëndrueshme komunale që do të paraqesin komunat përgjegjëse dhe ofrim të shërbimeve cilësore dhe efikase për qytetarët. Reforma përbëhet nga tre shtylla: rritja e kapaciteteve fiskale të komunave dhe rritja e të hyrave të komunave, rritja e disiplinës financiare të komunave, reduktimi i borxheve dhe punës ekonomike dhe rritja e transparencës dhe llogaridhënies.

Në vitin 2024 dhe në periudhë afatmesme, me qëllim të avancimit të decentralizimit fiskal, parashihen disa aktivitete dhe masa për përmirësimin e kapacitetit fiskal dhe rritjen e të hyrave të komunave, rritjen e disiplinës fiskale dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies në punën e tyre.

Ndryshimet në Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale sigurojnë përmirësimin e kapacitetit fiskal dhe rritjen e të hyrave të komunave, përmes rritjes graduale të shkallës së të hyrave nga tatimi mbi vlerën e shtuar që u shpërndahet komunave dhe të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Të hyrat nga tatimi mbi të ardhurat personale u rritën gradualisht nga 3% në 6% deri në vitin 2024 dhe si rezultat i këtyre ndryshimeve në vitin 2024 komunat do të marrin 6% të të hyrave të arkëtuara nga tatimi mbi të ardhurat personale.

Të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar në vitin 2024 do të sigurohen në vlerë prej 6% të arkëtimin të tatimit mbi vlerën e shtuar të realizuar në vitin fiskal paraparak. Ato janë të shpërndara në tri pjesë: pjesa bazë – 4.5% e tatimit të arkëtuarar mbi vlerën e shtuar të realizuar

në vitin fiskal paraprak, pjesa e performancës – 0.75% e tatimit të arkëtuar mbi vlerën e shtuar të realizuar në vitin fiskal paraprak dhe pjesa e barazimit – 0.75% të tatimit të arkëtuar mbi vlerën e shtuar të realizuar në vitin paraprak fiskal. Pjesa e performancës shpërblen komunat që kanë realizim më të mirë të të hyrave vetanake në krahasim me të hyrat vetanake të planifikuara dhe arkëtim më të lartë të të hyrave vetanake në vitin aktual krahasuar me mesataren e të hyrave vetanake të realizuara në tri vitet paraprake. Pjesa e barazimit ka për qëllim tejkalimin e diferencave sipas kapacitetit fiskal të komunave për shkak të kapacitetit të kufizuar të burimeve, përkatësisht komunat që kanë të hyra më të ulëta nga tatimi mbi të ardhurat personale për banor marrin mjete shtesë për vitin 2022 dhe 2023, ku përcaktohen kriteret sipas të cilave mjetet shpërndahen në pjesën bazë, pjesën e barazimit dhe pjesën e performancës. Si rezultat i ndryshimeve të ligjit për vitin 2024, të hyrat nga tatimi mbi vlerën e shtuar janë planifikuar në 4.349 milionë denarë, me tendencë të rritjes së vlerës edhe në periudhën e ardhshme afatmesme.

Në pjesën e aktiviteteve që lidhen me rritjen e disiplinës dhe efikasitetit financiar, uljen dhe riprogramimin e detyrimeve të maturuara dhe të papaguara të njësive të vetëqeverisjes lokale, Ministria e Financave do t'ua ofrojë komunave mundësinë e shfrytëzimit të njërit nga tre instrumentet kreditore për tejkalimin e problemeve me detyrimet e maturuara dhe të papaguara edhe atë:

- shfrytëzimi i kredisë së kushtëzuar (standby) nga Ministria e Financave.
- emetimi i fletobligacionit komunal për blerës të njohur - Ministria e Financave.
- emetimi i fletobligacionit strukturor nga Ministria e Financave.

Kjo mënyrë e zgjidhjes së problemeve me detyrimet e papaguara lidhet me plotësimin e kushteve për shpalljen e jostabilitetit financiar. Njëkohësisht, kjo pjesë e përforcon të gjithë procedurën që nga momenti i shpalljes së jostabilitetit financiar deri në tejkalimin e tij.

Me qëllim të rregullimit të çështjes së detyrimeve të papaguara të maturuara gjatë vitit 2024, planifikohet që me ndihmën teknike të USAID-it, Ligji i Veçantë i Përgatitur për Menaxhimin e Borxheve Komunale duhet të dorëzohet për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të miratohen akte nënligjore në lidhje me ligjin.

Në pjesën që i referohet përforcimit të përgjegjësisë fiskale të komunave me ndryshimet ligjore, pritjet rritje e transparencës së punës së komunave, me çka komunat kanë detyrimin që të dhënat financiare t'i publikojnë në mënyrë transparente në ueb faqet e tyre të internetit, si dhe rritje e llogaridhënies në shpenzimin e të gjitha mjeteve që ndahen nga shteti. Në ueb faqen e Ministrisë së Financave do të vazhdojë publikimi i të dhënave për realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve të komunave edhe për pjesën tjetër të borxheve të regjistruara në Sistemin elektronik të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve në nivel tremujor, ndërsa në Raportin vjetor të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshihet edhe Raporti vjetor i buxheteve të komunave. Me përkrahjen e PNUD-it, treguesit financiarë nga raportet periodike financiare do të vazhdojnë të publikohen në ueb faqen e internetit të komunave dhe në faqen e Ministrisë së Financave.

Me përmirësimin e efikasitetit të administratës dhe sigurimin e të hyrave të reja lokale do të ndërmerren veprime për rritjen e të hyrave vetanake.

Gjatë vitit 2024 do të intensifikohen aktivitetet për miratimin e Ligjit të Ri të Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, në pajtim me vlerësimin e ligjit ekzistues të përgatitur me ndihmën teknike të PNUD-it, gjatë vitit 2022, si dhe konkluzionet dhe rekomandimet e marra do të jenë bazë e mirë për përgatitjen e miratimit të ligjit të ri. Njëkohësisht, Ligji i Ri i Financimit

të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale do të harmonizohet me Ligjin e Ri të Buxheteve, ndërsa deri në fund të vitit do të ndërmerren aktivitete për miratimin e akteve nënligjore.

Me dotacione nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nga buxhetet e fondeve, sigurohen të hyra shtesë në Buxhetin e komunës, për financimin e kompetencave të saj të përcaktuara me ligj. Nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut rishpërndahen: bllok dotacionet për kompetencat e deleguara në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, kopshteve të fëmijëve dhe shtëpive për të moshuarit, granti i dedikuar për mbrojtjen nga zjarri, si dhe dotacionet kapitale nga Buxheti Qendror. Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2024 janë siguruar 1.362 milionë denarë shtesë për financimin e kompetencave të deleguara. Rritja shtesë i dedikohet financimit të rritjes së pagave, si dhe financimit të rritjes së shpenzimeve të transportit dhe energjisë elektrike.

Ministritë dhe fondet kompetente përgatisin Metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve, e cila bazohet në formulë duke shfrytëzuar treguesit e duhur të nevojave për secilin program. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut miraton Rregulloren mbi Metodologjinë për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e bllok dotacioneve me propozimin e ministrisë kompetente, pas pëlqimit paraprak të Ministrisë së Financave dhe Komisionit të Monitorimit të Zhvillimit të Sistemit për Financimin e komunave. Në periudhën e kaluar janë evidentuar probleme të caktuara me kompetenca të caktuara të deleguara, kriterë të paqarta të shpërndarjes, që rezultojnë me shpërndarje të pabarabartë të mjeteve sipas nevojave. Për shkak të kësaj, në disa komuna mungojnë mjetet nga bllok dotacionet që do t'i mbulonin të gjitha shpenzimet e punës së tyre. Me qëllim të shpërndarjes më të barabartë të subvencioneve sipas komunave, në bashkëpunim me ministritë kompetente që transferojnë mjete në si bllok dotacione dhe të dedikuara për kompetencat e deleguara në fushën e arsimit fillor dhe të mesëm, kulturës, mbrojtjes së fëmijëve, mbrojtjes së të moshuarve dhe për mbrojtjen nga zjarri, nevojitet të bëhet analizë gjithëpërfshirëse e kriterëve sipas të cilave ndahen mjetet për kompetencat e caktuara veçmas të deleguara dhe të përcaktohet modeli i ri i ndarjes së mjeteve sipas nevojave, i cili do të ofrojë cilësi më të lartë të shërbimeve.

Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me UNICEF-in dhe Bankën Botërore, tashmë janë duke punuar mbi përcaktimin e kriterëve të reja për rishpërndarjen e bllok dotacioneve për arsimin fillor bazuar në standardin e përcaktuar sipas nxënësve, me ç'rast rekomandohen reforma në optimizimin e rrjetit të shkollës, ulja e kuadrit arsimor dhe harmonizimi i numrit të nevojshëm të mësimdhënësve me numrin e nxënësve, si dhe përmirësimi i kushteve dhe programit arsimor në shkollat fillore. Qëllimi është të përmirësohet efikasiteti dhe efektiviteti i arsimit fillor dhe njëkohësisht të sigurohet barazi në qasjen në shkolla. Propozimet për kriteret e reja tashmë i janë prezantuar Ministrisë së Financave dhe Komisionit të Monitorimit dhe Zhvillimit të Sistemit të Financimit të Komunave. Në periudhën në vijim, gjithashtu, do të shqyrtohen edhe kriteret e rishpërndarjes së bllok dotacioneve për arsimin e mesëm. Në periudhën e ardhshme, Ministria e Financave, me ndihmën teknike të SIGMA-s, do të punojë mbi analizat e metodologjive ekzistuese për rishpërndarjen e bllok dotacioneve në fushën e kulturës, në kopshte dhe dotacionin e dedikuar për zjarrfikësit. Pritet që të merren propozime për përmirësimin e kriterëve duke shfrytëzuar eksperiencat e vendeve të tjera që japin rezultate pozitive. Do të bëhen përpjekje për vendosjen e kriterëve me të cilat në mënyrë reale do të përcaktohej vlera e nevojshme e mjeteve me të cilat do të mbuloheshin të gjitha shpenzimet për kompetencat e deleguara dhe do të përmirësohej cilësia e shërbimeve.

Nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është formuar grup ndërsektorial i punës për tejkalimin e problemeve të mbrojtjes nga zjarri dhe analizën e situatave në këtë fushë, në të cilën ndahet dotacion i dedikuar. Grupi i punës është duke punuar për ndryshimin e Ligjit të Zjarrfikësve, veçanërisht në pjesën e rregullimit të pagave dhe kompensimeve të zjarrfikësve, përcaktimit të numrit të nevojshëm të zjarrfikësve sipas kriterëve të përcaktuara në ligj, si dhe zgjidhjes së problemeve të tjera me të cilat ballafaqohet kjo kompetencë e transferuar.

Nëpërmjet ministrive kompetente dhe institucioneve të tjera shtetërore, mjetet u shpërndahen komunave në formën e dotacioneve kapitale për realizimin e projekteve kapitale infrastrukturore në komuna. Shpërndarja kryhet sipas programit që me propozimin e ministrisë kompetente e miraton Qeveria, në atë mënyrë që përgjithësisht të mos përcaktohen kriterë të shpërndarjes së dotacioneve kapitale që do të ishin miratuar paraprakisht nga Qeveria. Qeveria do të udhëheqë politikë të grupimit të të gjitha investimeve kapitale për NJQV-të në një vend. Mjetet që rezultojnë nga programet e ministrive dhe agjencive dhe që janë të destinuara për projektet komunale dhe rajonale do të bashkohen, me ç'rast sistemi i koordinimit të shpërndarjes së mjeteve sipas kriterëve të përcaktuara do ta kryejë nga Këshilli për Zhvillim të Balancuar Rajonal. Për siguri më të madhe në planifikimin dhe realizimin e këtyre investimeve kapitale do të vendoset buxheti trevjeçar. Në bashkëpunim me ministritë dhe institucionet prej të cilave dotacionet kapitale transferohen në njësitë e vetëqeverisjes lokale, është e nevojshme të hartohet Rregullore për shpërndarjen e dotacioneve kapitale, në të cilën do të përcaktohen kriterë transparente në bazë të të cilave çdo komunë do të fitonte dotacion kapital. Për zgjidhjen e kësaj çështjeje është i nevojshëm formimi i grupit ndërsektorial të punës në të cilin do të përfshihen përfaqësues nga ministritë dhe institucionet prej të cilave transferohen dotacionet kapitale në komunë dhe duhet të zbatohet analizë gjithëpërfshirëse e shpërndarjes së dotacioneve kapitale dhe përcaktimit të kriterëve për shpërndarjen e dotacioneve kapitale, përkatësisht miratimi i rregullores/ve për dotacione kapitale.

Gjatë viteve 2023 dhe 2024, PNUD-i do ta përkrahë Ministrinë e Financave në reformimin e kuadrit normativ për projektimin e sistemit të formalizuar të transfertave kapitale. Gjithashtu, do të propozohen disa modele për reformën e shpërndarjes së dotacioneve kapitale, përkatësisht nëse do të pranohet model i unifikuar për të gjithë shfrytëzuesit e buxhetit qendror apo nëse do të propozohen modele të veçanta për shpërndarjen e dotacioneve kapitale. Qëllimi është të bëhet reformimi i Sistemit të dotacioneve kapitale dhe sigurimi i zgjidhjeve praktike për dizajnimin e kriterëve transparente dhe objektive për shpërndarjen e dotacioneve kapitale. Në këtë mënyrë, është e nevojshme të përgatitet Metodologjia për shpërndarjen e dotacioneve kapitale, e cila përmban kriterë të unifikuar, transparente dhe të qarta, si dhe propozim për vendosjen e evaluimit "ex post" të projekteve të realizuara, të financuara nëpërmjet dotacioneve kapitale dhe përfshirjen e mundshme të suksesit të vlerësimit në kriteret e shpërndarjes.

Të hyrat stabile sigurohen me ndarjen e mjeteve nga qiraja e tokës bujqësore në pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut për komunat, përkatësisht në raport 50% për Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe 50% për komunat dhe komunat në qytetin e Shkup, të cilat shpërndahen nga viti 2018, varësisht nga vendndodhja e tokës bujqësore që është objekt i qiradhënies, me kusht që realizimi i të hyrave nga tatimi në pronën e patundshme në vitin paraprak të jetë mbi 80% në raport me të hyrat e planifikuara. Rritje të të hyrave vetanake ka edhe nga mjetet që u shpërndahen komunave nga kompensimi që paguhet nga koncesioni për shfrytëzimin e burimeve të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, në raport prej 50% për buxhetin qendror dhe 50% për komunat, në varësi të rajonit në të cilin kryhet veprimtaria

koncesionare.

Rritja e të hyrave vetanake të komunave, veçanërisht rritja e të hyrave nga tatimet e pronës së patundshme, sigurohet me mbulim më të mirë të bazës tatimore të personave fizikë dhe juridikë dhe me rivlerësimin e vlerës së pronës së patundshme. Në periudhën e ardhshme pritet që të arrihen të hyra më të larta me përcaktimin e vlerës reale të tregut të pronës së patundshme, veçanërisht pas përfundimit të procedurës së evidentimit dhe legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje në tokën ndërtimore dhe bujqësore. Duke marrë parasysh ndryshimet e fundit në Ligjin e Tatimit mbi Pronën, në periudhën e ardhshme parashihet që revizioni i vlerës së tregut të pronave të patundshme, që përfaqëson bazën tatimore të tatimit mbi pronën të kryhet nga komunat, komunat e qytetit të Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, çdo katër vjet, me qëllim të harmonizimit me gjendjen aktuale. Normat e tatimit mbi pronën për pronën e patundshme që nuk shfrytëzohet nga pronari ose nuk jepet me qira për më shumë se gjashtë muaj gjatë një viti, ndërsa është në pronësi të shtetit, komunave, komunave në qytetin e Shkupit, Qytetit të Shkupit, si dhe personave fizikë dhe juridikë, rritet për tre herë në raport me normat e parapara me ligj. Normat e tatimit mbi pronën e tokës bujqësore që nuk shfrytëzohet për prodhim bujqësor rriten për tri herë në raport me normat bazë. Baza tatimore për përcaktimin e tatimit mbi pronën e patundshme do të jetë vlera e vlerës së tregut, në vend të vlerës së vlerësuar, e përcaktuar në Metodologjinë e përcaktimit të vlerës së tregut të pronës së patundshme. Gjithashtu, është e nevojshme që komunat t'i lëshojnë dhe t'i dorëzojnë në kohë aktvendimet tatimore të obliguesit tatimorë. Rritja e normës së tatimit mbi pronën, për pronën me vlerë të lartë, mund të jetë burim shtesë i të hyrave, me ç'rast, pasi të rritet norma, ka rëndësi thelbësore që të sigurohen kapacitete për vlerësim dhe revizion, për shmangien e paraqitjes së pronës me vlerë më të ulët. Me ndihmën teknike të SIGMA-s, do të projektohen mundësi për rritjen e të hyrave lokale në bazë të praktikave më të mira të BE-së me fokus në rritjen e të hyrave vetanake dhe përgatitjen e analizës komparative të praktikave më të mira të BE-së, si dhe rekomandime për rritjen e të hyrave aktuale lokale dhe përfshirjen e të hyrave të reja lokale.

Më tej, komunat do të vazhdojnë kryerjen në pjesën e kompetencave të bartura për menaxhimin e tokës ndërtimore dhe trajtimin e objekteve të ndërtuara pa leje në tokën ndërtimore dhe bujqësore, për të cilat janë përcaktuar edhe burimet adekuate të të hyrave të buxhetit të komunës. Njëkohësisht, është e nevojshme të punohet në përf forcimin e kapacitetit kuadrovik të komunave.

Në periudhën e ardhshme afatmesme pritet implementimi i Ligjit të Zhvillimit të Balancuar Rajonal dhe i Strategjisë së Zhvillimit të Balancuar Rajonal për periudhën 2021-2031. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut edhe në periudhën e jashtëzakonshme do të vazhdojë me aktivitetet për zhvillim të barabartë rajonal dhe avancim të të gjitha rajoneve në vend. Zbatimi i Strategjisë së zhvillimit të balancuar rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2031 në tetë rajonet planifikuese (Rajoni i Vardarit, Lindor, Jugperëndimor, Juglindor, i Pellagonisë, i Pollogut, Verilindor dhe i Shkupit) me koordinim më të mirë vertikal dhe horizontal të politikave nacionale dhe lokale dhe projekteve të integruara zhvillimore, të përshtatura me nevojat dhe kushtet lokale, do të sigurojnë zhvillim lokal më të ekuilibruar dhe të orientuar në mënyrë territoriale. Në Programin për zbatimin e Strategjisë së zhvillimit të barabartë rajonal të Republikës së Maqedonisë së Veriut 2021-2024, është paraqitur korpus i gjerë aktivitetesh, programesh, të përcjella me instrumente financiare, të cilat do të çojnë në zhvillim më të ekuilibruar rajonal të vendit në periudhën në fjalë. Këshilli për Zhvillim të Balancuar Rajonal edhe më tej do të ketë rol të rëndësishëm si promotor i partneritetit ndërmjet

rajoneve/komunave dhe qeverisë dhe në kuadër të tyre do ta koordinojë shfrytëzimin e mjeteve nga të gjitha programet sektoriale të destinuara për rajonet planifikuese dhe komunat. Përpjekje të veçanta do të investohen për përkrahjen e komunave, duke nxitur zhvillimin lokal nëpërmjet përkrahjes së projekteve lokale dhe harmonizimit të tyre në nivel nacional. Qëllimi i barazimit fiskal në kontekstin e Strategjisë së zhvillimit rajonal është sigurimi i furnizimit të barabartë të të mirave dhe shërbimeve publike për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, duke arritur gjithashtu efekt plotësues të arritjes së ekuilibrit më të madh në zhvillimin e rajoneve të caktuara planifikuese.

Në mënyrë solidare, ndihma për komunat më të dobëta financiarisht, përkatësisht komunat me kapacitetin më të ulët të mbledhjes së të hyrave, ndikon pozitivisht në zhvillimin e tyre, por njëkohësisht edhe në zhvillimin e rajonit të planifikimit të cilit i përkasin.

Është miratuar Programi për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim për periudhën 2021-2026, në vitin 2023 realizohen aktivitetet rreth Planit aksional të Programit për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim për periudhën 2021-2026, për periudhën 2021-2023. Programi reflekton interesin e vazhdueshëm të të gjitha palëve të tanguara për zhvillimin e vazhdueshëm të vetëqeverisjes lokale, si niveli më i afërt i qeverisjes të qytetarët. Me këtë program përfshihen të gjitha aspektet e rëndësishme të procesit të decentralizimit që kontribuojnë në harmonizimin e sistemit të vetëqeverisjes lokale me kriteret dhe standardet normative, institucionale, politike dhe administrative të BE-së dhe arritjen e qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm të OKB-së. Është formuar Organi koordinues i monitorimit të zbatimit të programit dhe planeve aksionale, i përbërë nga 22 përfaqësues nga ministrinë dhe BNJVL-të. Gjatë vitit 2024 do të përgatitet raport për zbatimin e Planit aksional të Programit për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim për periudhën 2021-2026, për periudhën 2021-2023 dhe do të realizohen aktivitete për përgatitjen e Planit aksional për Programin për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe decentralizim, për periudhën 2021-2026, për periudhën 2024-2026.

Njëkohësisht, grupi sektorial i punës për zhvillimin rajonal dhe lokal detyrohet që të zbatojë detyra në nivel ekspert, në lidhje me formulimin dhe implementimin e politikave sektoriale nacionale, duke i përfshirë ato që kanë të bëjnë me integrimet në BE dhe ndihmën e donatorëve në përgjithësi dhe Programin IPA.

Komunat marrin pjesë të madhe të mjeteve të destinuara për zhvillimin lokal dhe rajonal nga Buxheti i shtetit nëpërmjet ministrive resoriale, marrin donacione nga burime të ndryshme, mjete nga fondet IPA dhe linja kreditore për financimin e projekteve infrastrukturore. Me ç'rast, komunat jo gjithmonë kanë kontroll në mundësitë e financimit të projekteve kapitale infrastrukturore dhe njëkohësisht për shkak të kapaciteteve të kufizuara kuadrovike nuk mund të sigurojnë mjete financiare për realizimin e investimeve kapitale në komunë. Është formuar grupi i punës nga përfaqësues prej Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Vetëqeverisjes Lokale, Ministrisë së Financave, Byrosë së Zhvillimit Rajonal, Kabinetit të Zëvendëskryeministrit të Çështjeve Ekonomike, Ministrisë së Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve me Bashkësitë, Ministrisë së Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe BNJVL-të me qëllim të sigurimit të zgjidhjes ligjore për formimin e Agjencisë për Zhvillim Rajonal dhe Lokal, e cila do të kishte kompetenca më të gjera se Byroja e Zhvillimit Rajonal, nëpërmjet së cilës komunave do t'u jepet mundësi për sigurimin e mjeteve financiare shtesë nga burime të ndryshme për financimin e investimeve kapitale, të cilat do ta përmirësojnë zhvillimin lokal dhe rajonal. Me ekzistimin e kësaj agjencie, mjetet që do të siguroheshin nga burime të ndryshme dhe që janë të destinuara për zhvillimin rajonal dhe lokal do të shpërndaheshin sipas kritereve të përcaktuara dhe sipas

nevojave të komunave dhe rajonit. Punën e agjencisë do ta koordinojë Ministria e Vetëqeverisjes Lokale. Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, në bazë të informacionit të dorëzuar në Qeveri për modelet e transformimit të Byrosë për Zhvillim Rajonal obligohet që t'i fillojë procedurat dhe aktivitetet ligjore gjatë vitit 2024 në Agjencinë për Zhvillimin Lokal dhe Rajonal.

Krahas përkrahjes në lidhje me transferimin e kompetencave për arkëtimin e pjesës së të hyrave publike, si dhe transfertat nga buxheti qendror, ndihma në ndërtimin e kapaciteteve komunale edhe nëpërmjet projekteve të pushtetit qendror të financuara nëpërmjet institucioneve financiare ndërkombëtare.

Në vitin 2023, do të finalizohet realizimi i Projektit për përmirësimin e shërbimeve komunale (MSIP), të cilin e zbaton Ministria e Financave me përkrahjen e Bankës Botërore dhe Komisionit Evropian, që filloi një dekadë më parë, fondi i tij i përgjithshëm është mbi 100 milionë euro dhe ka për qëllim përmirësimin e shërbimeve komunale nëpërmjet huave dhe granteve për komunat për realizimin e projekteve kapitale për furnizim me ujë, kanalizimin dhe largimin e ujërave të zeza, efikasitetin energjetik (ndriçimi i rrugëve, izolimi i objekteve komunale, etj.), infrastrukturën rrugore lokale (modernizimi dhe rikonstruimi i rrugëve dhe rrugicave), shërbimet komunale (prokurimi i automjeteve për ndërmarrjet publike), si dhe shërbimet dhe kompetencat e tjera komunale (ndërtimi i kopshteve të fëmijëve, tregjeve të gjelbra, infrastrukturës në zonat industriale, etj.).

Nëpërmjet Projektit të rrugëve lokale, që është pjesë e Kornizës aktuale të Bashkëpunimit me Bankën Botërore dhe zbatohet përmes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve, 70 milionë euro janë destinuar që të shpërndahen për 80 komunat për ndërtimin dhe sanimin e rrugëve dhe rrugicave lokale, si dhe në infrastrukturën tjetër rrugore në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Me këtë ndihmë direkte prej 500 mijë eurove deri në 2 milionë euro për çdo komunë (varësisht nga projekti me të cilin do të aplikojnë), veprohet drejt përmirësimit të infrastrukturës lokale në komuna.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdojë realizimi i Projektit të efikasitet energjetik në sektorin publik, i cili zbatohet nëpërmjet Ministrisë së Financave me përkrahjen e Bankës Botërore me Marrëveshje huaje, me fond të përgjithshëm prej 10.5 milionë eurove. Projekti i efikasitetit energjetik në sektorin publik do të zbatohet përmes Njesisë së Projektit për Përmirësimin e Shërbimeve Komunale - MSIP. Qëllimi kryesor i zbatimit të këtij projekti është ulja e konsumit të energjisë në sektorin publik dhe njëkohësisht përmirësimi i nivelit dhe cilësisë së objekteve publike dhe ndriçimit publik. Të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve nga ky komponent e kanë të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale. Vlera e huasë për një vetëqeverisje lokale mund të variojë nga 50 mijë deri në 750 mijë euro dhe kjo varet nga kapaciteti i lirë për huamarrje i komunës dhe vlera e vlerësuar e projektit të propozuar komunal. Me nënshkrimin e marrëveshjes me Ministrinë e Financave, komuna do të marrë 80% të këtyre mjeteve si nënshkruar, ndërsa pjesën tjetër prej 20% si grant. Njëkohësisht, Ministria e Financave, në kuadër të mjeteve të parapara për projektin, do të mbulohen edhe shpenzimet për përgatitjen e revizionit energjetik dhe dokumentacionit teknik për projektet.

Tjetër projekt madhor që është realizuar në dhjetë vitet e fundit, në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës komunale, është "Furnizimi me ujë dhe largimi i ujërave të zeza", financiar nga Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Banka Botërore, KfV-ja, IPA dhe mjetet buxhetore, ndërsa implementohet nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve. Me mjete në vlerë prej 100 milionë eurove, përkrahen të gjitha komunat për ndërtimin e infrastrukturës më të mirë për furnizimin

me ujë dhe për stacionet e filtrimit. Ky projekt do të vazhdojë edhe në të ardhmen nëpërmjet Ministrisë së Mjedisit Jetësor, me fond shtesë të mjeteve për përkrahjen e përmirësimit të infrastrukturës lokale.

Në periudhën e ardhshme afatmesme është paraparë përcaktimi i treguesve për monitorimin e decentralizimit fiskal, rritjen e efikasitetit në arkëtimin e tatimeve lokale, përmirësimin e efektivitetit dhe përfitimit të ndërmarrjeve publike në komuna, si dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së komunave. Në bashkëpunim me donatorët e huaj, është duke u punuar për krijimin e "indeksit të zhvillimit të qëndrueshëm" komunal, që është në harmonizim me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe do të shërbejë si instrument i politikës së zhvillimit lokal, duke ndihmuar autoritetet në të gjitha nivelet për të planifikuar dhe shpërndarë mjetet e zhvillimit për të promovuar rritjen e balancuar socioekonomike dhe lehtësimin e monitorimit të progresit të zhvillimit.

Rritja e disiplinës financiare të komunave, ulja e borxheve dhe punës ekonomike do të jenë prioritetet në periudhën e ardhshme dhe do të ndërmerren masa për planifikim real të të hyrave dhe shpenzimeve të komunave, racionalizim në punë dhe ulje e shpenzimeve të panevojshme, servisim i rregullt i detyrimeve, disiplinë më e madhe financiare, përmirësim i procedurave për shpalljen e jostabilitetit financiar dhe analizës së detyrimeve ekzistuese të komunave dhe ndërmarrjeve publike lokale.

Në drejtim të rritjes së transparencës dhe llogaridhënies dhe avancimit të decentralizimit fiskal, do të rritet kontrolli nga shteti, veçanërisht nga inspektimi financiar në sektorin publik në lidhje me Ligjin e Paraqitjes dhe Evidentimit të Detyrimeve dhe paraqitjes së raporteve për mosrespektimin e Ligjit të Disiplinës Financiare, do të ndërmerren masa për rritjen e transparencës së komunave nëpërmjet publikimit të raporteve financiare në mënyrë transparente dhe të kuptueshme, si dhe do të ndërmerren veprime edhe drejt llogaridhënies më të madhe për shfrytëzimin e mjeteve buxhetore.

Tashmë ka filluar procesi i konsultimeve dhe diskutimit publik me BNJVL-të dhe palët tjera të involvuara në lidhje me propozimet për reformën, ndërsa në koordinim me grupin e punës për vazhdimin e procesit të decentralizimit, të formuar nga Qeveria, në të cilin bëjnë pjesë Ministria e Sistemit Politik, e Financave, Vetëqeverisjes Lokale dhe BNJVL-të. Një nga prioritetet qeveritare është vazhdimi i procesit të decentralizimit në drejtim të demokratizimit më të madh, shërbimeve publike më të mira dhe zhvillimit lokal të zgjeruar në interes të qytetarëve.

Tabela 9. Projektioni afatmesëm i Buxhetit të Pushtetit Lokal (në milionë denarë)

	2021*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*
Вкупни приходи	38.366	38.716	49.902	56.003	55.963	57.878	60.788	63.784
Даночни приходи	11.280	10.716	12.454	12.873	13.190	13.520	13.870	14.230
Неданочни приходи	1.280	1.419	2.644	2.770	2.875	3.000	3.140	3.240
Капитални приходи	1.744	1.784	2.310	2.340	2.370	2.440	2.500	2.570
Трансфери	23.386	24.105	30.817	35.972	35.480	36.870	39.230	41.696
Донации	676	692	1.676	2.048	2.048	2.048	2.048	2.048
Вкупни расходи	38.527	38.911	49.902	56.003	55.963	57.878	60.788	63.784
Плати и надоместоци	18.847	19.899	22.078	25.055	26.270	27.140	28.070	29.670
Стоки и услуги	8.145	9.900	12.081	12.420	12.720	13.000	13.620	13.970
Каматни плаќања	37	37	63	80	80	90	100	100
Субвенции и трансфери	2.654	2.857	2.878	3.880	3.880	3.980	4.180	4.280
Социјални трансфери	55	67	71	90	90	90	90	90
Капитални расходи	8.789	6.151	12.731	14.478	12.922	13.578	14.728	15.674
Салдо	-161	-195	0	0	0	0	0	0

Извор: Проекции на Министерство за финансии (*)

2.6 Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore

Puna e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore rregullohet me Ligjin e Ndërmarrjeve Publike, Ligjin e Shoqërive Tregtare, si dhe me ligje të tjera në të cilat rregullohet veprimtaria e ndërmarrjes, përkatësisht e shoqërisë (Ligji i Energjetikës, Ligji i Sistemit Hekurudhor, Ligji i Rrugëve Publike dhe të ngjashme).

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut është themeluese e 15 ndërmarrjeve publike dhe aksionere/partnere e vetme në 15 shoqëri tregtare. Këto subjekte janë punëdhënës të rreth 15 mijë të punësuarve të cilët përfaqësojnë pjesë të konsiderueshme të ekonomisë së Maqedonisë.

Të hyrat e përgjithshme të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore për vitin 2022, sipas të dhënave nga raportet vjetore, arrijnë 78.8 miliardë denarë, shpenzimet e përgjithshme janë realizuar në vlerë prej 71.5 miliardë denarëve, me ç'rast si rezultat përfundimtar në vitin 2022, është realizuar fitim në vlerë prej rreth 7.3 miliardë denarëve, para së gjithash si rezultat i subvencioneve nga buxheti i shtetit, të paguara për kompanitë energjetike për zbutjen e goditjes së çmimeve, e shkaktuar nga kriza energjetike.

Treguesit financiarë të punës së ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare paraqiten në bazë përllogaritjeje, sipas metodologjisë së përcaktuar të kontabilitetit, e cila ndryshon nga metodologjia e shfrytëzuesve buxhetorë ku të dhënat financiare paraqiten në bazë të parave të gatshme, duke marrë parasysh se këto subjekte, udhëheqjen e kontabilitetit, përgatitjen dhe parashtrimin e llogarisë vjetore dhe raporteve financiare e kryejnë në pajtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare dhe sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe standardeve ndërkombëtare të njoftimit financiar dhe jo në pajtim me Ligjin e Kontabilitetit të Buxheteve dhe Shfrytëzuesve Buxhetorë. Humbja e paraqitur në disa ndërmarrje të caktuara publike dhe shoqëri tregtare në pronësi shtetërore është rezultat i amortizimit të përllogaritur të mjeteve bazë, që në esencë paraqet kosto përllogaritëse dhe paraqitet si shpenzim i ndërmarrjes publike.

Tabela 10: Treguesit kryesorë financiarë për ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi të plotë shtetërore (në miliona denarë)

Ред. бр.	Назив на Акционерското друштво/ Јавното претпријатие во државна сопственост	вкупни приходи	вкупни расходи	загуба/ добивка пред оданочување	вкупни приходи	вкупни расходи	загуба/ добивка пред оданочување	план приходи	план расходи	загуба/ добивка пред оданочување
		2022 година			План 2023 година			Трет квартал 2023 година		
1	АД „Електрани на Северна Македонија“ - Скопје	34.093,1	31.578,9	2.514,2	25.840,4	35.008,2	-9.167,8	4.481,7	4.863,0	-381,4
2	АД за пренос на електрична енергија и управување со електроенергетскиот систем во државна сопственост - Скопје	12.395,2	11.004,7	1.390,5	11.283,5	11.283,5	0,0	1.562,0	1.654,5	-92,5
3	ЈП за државни патишта - Скопје	13.065,0	9.391,5	3.673,5	11.193,0	3.082,0	8.111,0	3.286,5	2.304,3	982,2
4	АД „Железници на Република Северна Македонија Транспорт“ - Скопје	1.648,6	1.872,0	-223,4	1.351,6	1.910,3	-558,7	258,7	428,8	-170,2
5	ЈП „Национални шуми“ - Скопје	1.743,3	1.692,7	50,6	2.095,1	1.923,8	171,2	589,7	448,7	141,0
6	АД „Пошта на Северна Македонија“ - Скопје	1.199,6	1.429,4	-229,9	1.420,6	1.533,5	-112,8	267,1	325,2	-58,1
7	ЈП за железничка инфраструктура „Железници на Република Северна Македонија“ - Скопје	1.192,0	1.334,5	-142,5	1.045,1	1.624,0	-578,8	108,2	296,7	-188,5
8	ЈП за одржување и заштита на магистралните и регионалните патишта - Скопје	1.615,9	1.555,2	60,7	1.895,0	1.880,0	15,0	552,2	436,9	115,2
9	ЈРП „Македонска Радиотелевизија“ - Скопје	1.104,8	1.064,5	40,3	1.172,5	1.172,5	0,0	227,1	264,3	-37,2
10	АД за изградба и стопанисување со станбен и со деловен простор од значење за Републиката - Скопје	794,4	785,3	9,1	855,6	853,7	1,9	128,3	131,7	-3,5
11	АД за вршење на дејноста давање на услуги во воздухопловната навигација „М - НАВ“ - Скопје	1.307,3	1.170,4	137,0	1.228,5	1.221,1	7,4	496,0	268,7	227,3
12	АД „Водостопанство на Република Северна Македонија“ - Скопје	825,4	825,9	-0,5	885,3	883,2	2,1	131,1	180,4	-49,4
13	ЈП „Стрежово“ - Битола	272,5	491,3	-218,8	271,7	464,9	-193,2	73,7	114,2	-40,5
14	АД ТЕЦ „Неготино“ - Неготино	5.476,6	5.394,3	82,3	13.283,2	13.283,2	0,0	6,1	132,5	-126,4
15	АД „Државна лотарија на Северна Македонија“ - Скопје	837,1	361,7	475,4	1.676,1	1.099,7	576,4	431,8	176,7	255,1
16	ЈП „Злетовица“ - Пробиштип	42,5	164,8	-122,3	46,0	175,1	-129,2	23,4	48,6	-25,1
17	ЈП „Национална Радиодифузија“ - Скопје	196,7	313,5	-116,8	243,6	243,6	0,0	38,3	46,7	-8,5
18	АД „Аеродроми на Република Северна Македонија“ - Скопје	58,9	110,3	-51,3	14,0	109,3	-95,3	22,4	3,9	18,5
19	ДООЕЛ „Борис Трајковски“ - Скопје	222,5	211,8	10,7	166,9	233,0	-66,1	19,3	29,1	-9,8
20	ЈП за водостопанство во „Лисиче“ - Велес	47,6	85,9	-38,3	47,4	87,9	-40,5	20,2	21,7	-1,5
21	АД за стопанисување со деловен простор во државна сопственост - Скопје	92,6	85,2	7,4	62,7	79,6	-17,0	20,1	17,4	2,7
22	ЈП „Службен весник на Република Северна Македонија“ - Скопје	96,3	78,9	17,3	99,1	94,1	5,1	25,1	20,4	4,7
23	ЈП „Студенчица“ - Кичево	74,4	67,7	6,7	79,2	79,2	0,0	19,4	18,0	1,5
24	АД „Медиумска информативна агенција“ - Скопје	76,9	66,5	10,4	64,0	63,9	0,1	16,6	15,8	0,8
25	ЈП „Јасен“ - Скопје	48,9	47,9	0,9	48,9	48,7	0,2	15,8	11,7	4,1
26	ЈП за стопанисување со пасишта - Скопје	43,1	26,7	16,4	36,2	33,7	2,6	6,3	6,0	0,2
27	АД „Номагас“ - Скопје	147,6	211,1	-63,5	0,0	0,0	0,0	187,8	188,0	-0,2
28	АД „Национални енергетски ресурси“ - Скопје	0,2	16,2	-16,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
29	ЈП „Агро - Беара“ - Скопје	14,1	11,2	2,9	15,7	15,7	0,0	3,9	2,7	1,2
30	ЈП „Колеторски систем“ - Скопје	99,3	141,4	-42,1	101,4	128,5	-27,1	40,8	32,2	8,6
31	ДООЕЛ „Нафтовод“ - Скопје	0,0	6,3	-6,3	8,3	8,3	0,0	0,0	1,5	-1,5
	ВКУПНО:	78.832	71.598	7.235	76.530	78.624	-2.094	13.060	12.491	569

Të hyrat e Buxhetit në bazë të pagesës së dividendëve nga shoqëritë tregtare në të cilat shteti është aksioner i plotë ose i pjesshëm dhe pagesa e fondeve të tepërta nga puna e ndërmarrjeve publike në pronësi shtetërore në fund të vitit 2022 janë gjithsej 1. miliardë denarë, ndërsa në vitin 2023 të hyrat nga kjo bazë pritet të jenë rreth 1.1 miliardë denarë.

Nga ana tjetër, edhe pse gjatë vitit Ligji i Realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nuk mbulon drejtpërdrejt ndërmarrjet publike dhe kompanitë tregtare në pronësi shtetërore, ato marrin transferta përmes ministrive të tyre resoriale si përkrahje buxhetore për realizimin e projekteve infrastrukturore të përcaktuara, duke pasur parasysh se ato kryejnë veprimtari me interes publik, përkatësisht janë subjekte që kryejnë veprimtari me rëndësi thelbësore për ekonominë e Maqedonisë.

Me ndryshimet në Ligjin e Ndërmarrjeve Publike dhe në drejtim të avancimit të transparencës, ndërmarrjet publike kanë detyrim që në ueb faqet e tyre t'i publikojnë raportet vjetore dhe tremujore, gjë që mundëson monitorim në kohë dhe transparent të veprimtarisë financiare të këtyre subjekteve, ndërsa njëkohësisht jepet mundësi për parashikim real të riskut fiskal në këtë fushë dhe marrjen në kohë të masave adekuate. Duke filluar nga viti 2020, Ministria e Financave publikon në faqen e saj të internetit të dhënat e konsoliduara tremujore për realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve në nivel të ndërmarrjeve publike/shoqërive tregtare në pronësi shtetërore.

Ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore, në pajtim me Ligjin e Paraqitjes dhe Regjistrimit të Detyrimeve, kanë detyrim që në bazë mujore t'i raportojnë detyrimet e ndërmarrja të maturuara dhe të pamaturuara, si dhe detyrimet e papaguara në Sistemin elektronik të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve, për menaxhimin e të cilave është kompetente Ministria e Financave. Në bazë të të dhënave të evidentuara për detyrimet e paraqitura, Ministria e Financave në vazhdimësi, në bazë tremujore, publikon raporte përmbledhëse në ueb faqen e saj, gjë që kontribuon më tej në përforsimin dhe rritjen e transparencës.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si themeluese e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore, në vazhdimësi monitoron punën e tyre financiare nëpërmjet llogarive vjetore dhe raporteve vjetore, raporteve tremujore, planeve financiare dhe programeve investive, gjatë shqyrtimit dhe miratimit të të cilave u jepen indikacione dhe vërejtje organeve kompetente ndërmarrjes/shoqërisë që janë në drejtim të uljes së shpenzimeve joproduktive, ndërmarrjes së masave për arkëtimin e kërkesave të paarkëtuara dhe shlyerjes së detyrimeve në kohë.

Edhe gjatë vitit 2023, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore duhet të punojnë në kushte të kufizuara dhe të vështira, para së gjithash si rezultat i krizës energjetike dhe ekonomike, e cila në masë të madhe ka ndikuar që ato të ballafaqohen me problemet në pjesën e arkëtimit të kërkesave, mirëmbajtjes së likuiditetit rrjedhës dhe shlyerjes në kohë të detyrimeve ndaj furnizuesve, shtetit dhe të punësuarve.

Për t'u ballafaquar më mirë me pasojat negative të shkaktuara nga kriza energjetike dhe ekonomike edhe gjatë vitit 2023, këto subjekte janë përfshirë me Planin e konsolidimit fiskal, të miratuar nga Qeveria e Maqedonisë së Veriut. Sipas këtij plani, ka vazhduar detyrimi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore për revidimin e planeve financiare në drejtim të uljes në 15% të shpenzimeve të planifikuara më pak produktive. Njëkohësisht u bënë ndryshime ligjore për plotësimin racional të vendeve të lira të punës në ndërmarrjet dhe shoqëritë që punojnë me humbje, para së gjithash nga aspekti i

domosdoshmërisë së vendit të punës për kryerjen e veprimtarisë bazë të ndërmarrjes, përkatësisht shoqërisë.

Koncepti modern i menaxhimit të financave publike i dizajnuar në Ligjin e ri të Buxheteve është i drejtuar nga përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe përforsimi i buxhetimit afatmesëm, si një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Ky koncept përfshin edhe ndërmarrjet publike dhe shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore si segment i rëndësishëm në sektorin publik, kështu që në periudhën e ardhshme planifikohen aktivitete për përfshirjen e planifikimit afatmesëm edhe në këto subjekte. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2023, Ministria e Financave me shkresë qarkore ka kërkuar të dhëna nga ndërmarrjet publike shtetërore dhe shoqëritë tregtare për të hyrat dhe shpenzimet e planifikuara në periudhën afatmesme, përkatësisht në periudhën 2023-2028.

Tabela 11: Treguesit kryesorë financiarë për punën e planifikuar të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi të plotë shtetërore (në miliarda denarë) për periudhën 2023-2028

Ред. бр.	ПЛАНИРАНИ ВКУПНИ ПРИХОДИ И РАСХОДИ ВО ЈП И АД за период 2023-2028 година						во млд
		2023	2024	2025	2026	2027	2028
1	ВКУПНИ ПРИХОДИ	76,5	78,4	80,8	83,5	86,2	89,1
2	ВКУПНИ РАСХОДИ	78,6	74,3	76,5	78,8	81,1	83,5
3	ФИНАНСИСКИ РЕЗУЛТАТ	-2,1	4,1	4,3	4,7	5,1	5,6

Në tremujorin e parë të vitit 2023, nga gjithsej 30 subjekte, 13 subjekte kanë treguar fitim në vlerë prej 1.5 miliardë denarëve, ndërsa 17 subjektet e tjera kanë evidentuar humbje që arrin në 0.6 miliardë denarë, me çka rezultati financiar përfundimtar i punës së të gjitha subjekteve është pozitiv dhe në periudhën janar-mars është përcaktuar në vlerë prej 0.9 miliardë denarëve. Në tremujorin e dytë të vitit 2023, të hyrat e përgjithshme të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare arrijnë në 16.7 miliardë denarë, ndërsa shpenzimet e përgjithshme janë përcaktuar në vlerë prej 14.5 miliardë denarëve, me çka rezultati financiar përfundimtar është pozitiv dhe është 2.2 miliardë denarë. Në periudhën prill - qershor të vitit 2023, 15 subjekte kanë shënuar rezultat financiar pozitiv në vlerë prej 2.6 miliardë denarëve, ndërsa 15 subjekte kanë evidentuar humbje në vlerë prej 0.4 miliardë denarëve.

Në periudhën korrik – shtator të vitit 2023, rezultati financiar i punës së ndërmarrjeve publike dhe i shoqërive tregtare rezulton të jetë pozitiv dhe është 0.5 miliardë denarë. Përkatësisht, nga të dhënat e dorëzuara për 30 subjekte, 14 subjekte kanë treguar fitim në vlerë prej 1.7 miliardë denarëve, ndërsa 16 subjekte kanë evidentuar humbje në vlerë prej 1.2 miliardë denarëve.

3. Aspekte të tjera dhe avancimi i menaxhimit të financave publike

3.1 Programi i reformës së menaxhimit të financave publike 2022 - 2025

Programi i reformës së menaxhimit të financave publike për periudhën 2022 - 2025 dhe Plani aksional i zbatimit të programit për vitin 2022 janë miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 21 qershor të vitit 2022.

Programi i reformës së menaxhimit të financave publike 2022 - 2025 është dokument strategjik për zhvillimin e Sistemit të menaxhimit të financave publike, me të cilin vazhdoen reformat e filluara në katërvjeçarin paraprak. Bëhet fjalë për sipërmarrje ambicioze që i mbulon të gjitha aspektet e menaxhimit të financave publike: analizën ekonomike, kuadrin makroekonomik dhe fiskal, mobilizimin dhe arkëtimin e të hyrave, planifikimin e buxhetit, menaxhimin e investimeve publike, instrumentet efektive sipas Planit të rritjes së përsheptuar, prokurimet

publike duke përfshirë PPP-të, krijimin e Sistemit të integruar të informacionit të menaxhimit financiar (IFMIS), Akademinë e Financave Publike, kontabilitetin buxhetor, kontrollin e brendshëm financiar publik, kontrollin e jashtëm dhe mbikëqyrjen parlamentare dhe MFP-në në nivel lokal.

Reformat e financave publike për përmirësimin e kuadrit fiskal, përf forcimin e procesit të planifikimit, ekzekutimit dhe njoftimit për financat publike, rritjen e arkëtimit të të hyrave, përmirësimin e sistemit të prokurimeve publike dhe përf forcimin e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm nëpërmjet rritjes së transparencës dhe llogaridhënies në punë, janë identifikuar si qëllime kryesore të qeverisë, të cilat duhet të sigurojnë rritje të përsheptuar dhe të qëndrueshme ekonomike, standard më të lartë jetësor dhe cilësi në jetën e qytetarëve. Kjo përfshin mirëmbajtjen e qëndrueshme të buxhetit në perudhë afatgjatë, gjithashtu duke vazhduar me sigurimin e shërbimeve cilësore dhe të shpejta për qytetarët dhe subjektet afariste, nëpërmjet administratës publike moderne dhe efikase, e përkrahur nga dixhitalizimi intensiv.

Programi bazohet në konceptin SMART Sistem të financave publike ose në përkthimin identik “financa të zgjuara”, sistem që do të bazohet në strategji të qartë dhe do të jetë i qëndrueshëm, i përgjegjshëm, i orientuar drejt reformave dhe transparent, i cili do t’i implementojë reformat që duhet të realizohen në financat publike, në kuptim të planifikimit më afatgjatë dhe më cilësor të programeve buxheteve dhe buxheteve, do të jetë i vazhdueshëm, përkatësisht i qëndrueshëm dhe në vazhdimësi do të veprojë drejt përmirësimit të transparencës. Kjo do të nënkuptojë përpjekje drejt modelit më korrekt të financave publike, nga pikëpamja e aspektit të të hyrave, shpenzimeve dhe mënyrës së financimit, përkatësisht thënë gjerësisht si mbushet buxheti dhe si dhe ku shpenzohen paratë e qytetarëve, me ç’rast fokusi është mbi zëvendësimin e buxhetimit tradicional me buxhetimin e bazuar në rezultatet dhe përfshirjen e kuadrit buxhetor shumëvjeçar. Një nga shtyllat kryesore të Sistemit SMART duhet të jetë transparenca dhe llogaridhënia e financave publike, duke marrë parasysh se transparenca ka qenë “fjalë kyçe” në politikën e viteve të fundit. Vlera reale e këtij sistemi për financat publike është se, ajo është shkalla më e lartë e kontrollit fiskal, me ç’rast informacioni i jepet publikut në mënyrë të thjeshtë dhe përgjithësisht të kuptueshme, ndërsa publiku gjykon dhe vendos nëse ai është vendim real, i justifikuar apo ligjor.

Programi zbatohet nëpërmjet planeve aksionale vjetore, ndërsa monitorimi kryhet në bazë të raporteve gjysmëvjetore dhe vjetore. Dy Plane aksionale për zbatimin e Programit të reformës së menaxhimit të financave publike për vitin 2022 dhe 2023 janë miratuar dhe përfunduar. Zbatimi dhe monitorimi i Programit të ri 2022 - 2025 bazohet në dialogun sektorial të politikave me të gjitha palët e involvuara, që ishte krijuar me programin paraprak. Qëllimi i dialogut është të sigurojë punë të përbashkët rreth prioriteteve dhe politikave në sektorin e Menaxhimit të Financave Publike dhe të krijojë sinergji dhe harmonizim ndërmjet iniciativave të ndryshme, si dhe të sigurojë që mjetet buxhetore dhe të gjitha resurset e tjera në dispozicion, duke përfshirë edhe mjetet e donatorëve, të shfrytëzohen në mënyrë të përshtatshme dhe transparente.

Korniza legislative që përkrah Programin e reformës së menaxhimit të financave publike për periudhën 2022 - 2025 nuk ishte në fuqi në momentin e përgatitjes së programit sepse Ligji i ri i Buxheteve ende nuk ishte miratuar nga Kuvendi. Me miratimin e Ligjit të Buxheteve në shtator të vitit 2022, u përcaktua Sistemi i menaxhimit të financave publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Me këtë ligj rregullohet procedura e përgatitjes, miratimit, realizimit të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale dhe të Qytetit të Shkupit dhe njoftimi për ekzekutimin e tyre. Ligji rregullon edhe rregullat fiskale dhe parimet fiskale, krijimin e Këshillit Fiskal, planifikimin afatmesëm të buxhetit, menaxhimin e mjeteve shtetërore dhe komunale, si dhe monitorimin e rezultateve financiare të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare të themeluara nga shteti dhe komunat, si dhe përgjegjësinë fiskale dhe bazat për krijimin e sistemit të integruar të informacionit për menaxhimin financiar. Këtyre reformave u duhet përshpejtim edhe më i madh, ndërsa për arritjen e reformës gjithëpërfshirëse dhe ambicioze të inkorporuar në Ligjin e ri të Buxheteve, duhet të miratohet Plan aksional, të përshpejtohet krijimi i strukturave të reja institucionale dhe të sigurohet në kohë stafi adekuat në njësitë kryesore reformuese në Ministrinë e Financave, përkatësisht në DAP dhe Drejtorinë Doganore.

Përmirësimi i menaxhimit të financave publike dhe përforcimi i buxhetimit afatmesëm për 5 vitet e ardhshme është një nga prioritetet më të mëdha të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si pjesë e procesit për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, për hartimin e Strategjisë fiskale është planifikuar zhvendosja kohore nga ajo ekzistuese, si dhe përmirësimi i strukturës dhe përmbajtjes së strategjisë.

Buxheti do të ketë pasqyrë më të mirë nëpërmjet një numri më të madh informacionesh që do të paraqiten dhe do të strukturohen më mirë, si dhe do të ndahet në një pjesë të përgjithshme, të veçantë dhe zhvillimore.

Njëkohësisht, parashihen edhe dispozita për përfshirjen e rregullave fiskale numerike, të dizajnuara në mënyrë të tillë që të jenë të harmonizuara dhe konsistente me rregullat fiskale të BE-së dhe ta bëjnë politikën fiskale më të parashikueshme dhe të përgjegjshme. Me paraqitjen e rrethanave të jashtëzakonshme Qeveria mund t'i shmangë rregullat e vendosura fiskale.

Gjatë periudhës në vijim, Ministria e Financave, në bashkëpunim me Bankën Botërore por edhe nëpërmjet Projektit IPA Tuining “Përforcimi i funksioneve të planifikimit, realizimit dhe kontrollit të brendshëm buxhetor”, do të vazhdojë të punojë për përgatitjen e akteve nënligjore, udhëzimeve, manualeve dhe të ngjashme, qëllimi i të cilave është operacionalizimi i Ligjit të ri të Buxheteve, përmirësimet e mëtejshme të Sistemit të menaxhimit të financave publike, si dhe zhvillimi i planit të detajuar për të gjitha proceset e punës në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu, me Ligjin e ri të Buxheteve parashihet vendosja e Sistemit të integruar informativ për menaxhimin financiar - IFMIS (IFMIS - Integrated Financial Management Information System), me të cilin do të vendoset integrimi dhe lidhja me të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë dhe sistemet e Drejtorisë së të Hyrave Publike, Drejtorisë Doganore dhe institucioneve të tjera, me qëllim që të mundësohet menaxhim më efikas i financave publike. Me implementimin e IFMIS-it do të arrihet kompatibiliteti dhe interaktiviteti i plotë i sistemeve të financave publike, ndërsa zbatimi i tyre në pajtim me Programin e menaxhimit të financave publike nënkupton sigurimin e disponueshmërisë së sistemeve dhe shkëmbimit të të dhënave në mënyrë të pa ndërprerë 24 orë në ditë gjatë gjithë vitit.

Në fund të vitit 2023, me ndihmën teknike të SIGMA-s, filloi rishikimi afatmesëm i qëllimeve dhe indikatorëve të Programit të reformës së menaxhimit të financave publike 2022 - 2025 për vazhdimin e Programit për 2 vite të tjera. Programi i ri do ta mbulojë periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2027. Rishikimi afatmesëm i programit fokusohet në këto aspekte: Implementimin e programit dhe Planeve aksionale (efektiviteti); Përshtatjen e ndërhyrjeve për arritjen e rezultateve dhe qëllimeve të dëshiruara (relevanca); Përshtatjen dhe efikasitetin e strukturës

menaxhuese për MFP-në (efikasiteti).

3.2 Raport mbi detyrimet e paraqitura në pajtim me Ligjin e Paraqitjes dhe Evidentimit të Detyrimeve

Me qëllim të sigurimit dhe mirëmbajtjes së transparencës, llogaridhënies dhe forcimit të përgjegjësisë gjatë disponimit të mjeteve publike, në Ligjin e Paraqitjes dhe Evidentimit të Detyrimeve rregullohet paraqitja, evidentimi dhe publikimi i të dhënave për detyrimet e ndërmarra të raportuara të pamaturuara dhe detyrimet e maturuara të papaguara.

Me këtë zgjidhje ligjore rregullohet paraqitja e detyrimeve në bazë mujore në sistemin elektronik nga organet e pushtetit shtetëror, njësitë e vetëqeverisjes lokale, institucionet që kryejnë veprimtari në fushën e kulturës, arsimit, shëndetësisë, fëmijëve, mbrojtjes sociale, si dhe në veprimtaritë e tjera me interes publik të përcaktuara me ligj, të themeluara nga Republika e Maqedonisë së Veriut ose nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, ndërmarrjet publike, shoqëritë tregtare në pronësi shtetërore dhe personat e tjerë juridikë, themelues i të cilave është Republika e Maqedonisë së Veriut ose njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Me qëllim të informimit të publikut dhe transparencës më të madhe, si dhe në bazë të të dhënave të evidentuara për detyrimet e paraqitura, paraqitja kryhet në bazë mujore nëpërmjet Sistemit Elektronik të Paraqitjes dhe Evidencës së Detyrimeve (SEPED), më së voni deri më datën dhjetë të muajit rrjedhës, për muajin paraprak, ndërsa Ministria e Financave, në vazhdimësi, në bazë tre mujore, në ueb faqe publikon raporte përmbledhëse.


Në bazë të të dhënave të evidentuara në Sistemin elektronik të paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve, nga të dhënat e paraqitura deri në nëntor të vitit 2023, në tabelën 12 është paraqitur Raporti i detyrimeve të paraqitura sipas grupeve të subjekteve.

Tabela 12. Raporti i detyrimeve të paraqitura sipas grupeve të subjekteve për muajin mars të vitit 2023 (në milionë denarë)

Ред. бр.	ПЛАНИРАНИ ВКУПНИ ПРИХОДИ И РАСХОДИ ВО ЈП и АД за период 2023-2028 година						во млд
		2023	2024	2025	2026	2027	2028
1	ВКУПНИ ПРИХОДИ	76,5	78,4	80,8	83,5	86,2	89,1
2	ВКУПНИ РАСХОДИ	78,6	74,3	76,5	78,8	81,1	83,5
3	ФИНАНСИСКИ РЕЗУЛТАТ	-2,1	4,1	4,3	4,7	5,1	5,6

Burimi: Ministria e Financave - Sistemi elektronik i paraqitjes dhe evidentimit të detyrimeve

Grafiku 14. Raporti i detyrimeve të paraqitura sipas llojeve të klientëve për muajin nëntor të vitit 2023



4. Shfrytëzimi i ndihmës paraaderuese nga BE-ja

Republika e Maqedonisë së Veriut, si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian, ka qasje në mjetet e Instrumentit për Ndihmë Paraderuese (IPA) të Bashkimit Evropian. Mjetet IPA janë planifikuar në kuadër të perspektivave financiare të mëposhtme: Perspektiva financiare IPA 2007-2013 (IPA 1), Perspektiva financiare IPA 2014-2020 (IPA 2) dhe Perspektiva financiare IPA 2021-2027 (IPA 3).

Këtu është prezantuar pjesa e ndihmës paraderuese nga BE-ja e cila implementohet sipas metodës së menaxhimit të decentralizuar/indirekt. Metoda e menaxhimit të decentralizuar/indirekt të IPA-s është metodë e menaxhimit në kuadër të së cilës Komisioni Evropian ia beson strukturës së akredituar në Republikën e Maqedonisë së Veriut detyrat për zbatimin e programeve të caktuara të IPA-s, siç janë kryerja e procedurave tenderuese, nënshkrimi i marrëveshjeve, monitorimi i projekteve dhe kryerja e pagesave. Nga ana tjetër, në rast të menaxhimit të centralizuar, këto përgjegjësi i ka KE-ja, nëpërmjet Delegacionit të BE-së në RMV.

Mjetet për bashkëfinancimin nacional të projekteve të zbatuara sipas Metodës së menaxhimit të decentralizuar/indirekt janë planifikuar në buxhetin e Ministrisë së Financave, ndarja 09002 – Funksionet e Shtetit, me përjashtim të bashkëfinancimit nacional të kërkuar për financimin e projekteve IPARD, që janë planifikuar në Buxhetin e Agjencisë së Mbështetjes Financiare dhe Zhvillimit Rural, ndarja 14004, si dhe për bashkëfinancimin nacional për pagesën e kontributit financiar në KE për pjesëmarrje në programet e BE-së, që planifikohen në ministritë resoriale.

Në periudhën programore 2021-2027, sipas metodës së menaxhimit direkt, Ministria e Financave është përgjegjëse për pagesën ose refundimin në BE, për pjesën e bilateve hyrëse me pagesë për programet e BE-së dhe agjencitë nga ministritë përkatëse. Ministritë përgjegjëse në kuadër të buxhetit të tyre planifikojnë çdo vit vlerën e duhur të biletës hyrëse.

4.1 IPA 1 - Perspektiva financiare 2007 – 2013

Në kuadër të IPA 1 - perspektiva financiare 2007-2013, Republika e Maqedonisë së Veriut, përmes pesë komponentëve të IPA-s, kishte në dispozicion 614 milionë euro (37.8 miliardë denarë), nga të cilat rreth 467 milionë euro (28.7 miliardë denarë) ose rreth 76% e alokimeve të përgjithshme janë implementuar nëpërmjet metodës së menaxhimit të decentralizuar (nëpërmjet strukturave të akredituara nga shërbimet e Komisionit Evropian me qëllim të menaxhimit të pavarur të fondeve evropiane).

4.2 IPA 2 - Perspektiva financiare 2014 – 2020

Në kuadër të IPA 2 – perspektiva financiare 2014-2020, Republikës së Maqedonisë së Veriut i janë vënë në dispozicion 664 milionë euro. Sa i përket mënyrës së implementimit, rreth 50% e alokimeve të përgjithshme për IPA 2 implementohen nëpërmjet Sistemit të menaxhimit indirekt, përkatësisht nëpërmjet strukturave të akredituara të IPA-s.

Me ndihmën e dhënë financohen projekte në këto fusha: drejtësi dhe punët e brendshme, infrastrukturë rrugore dhe hekurudhore, mbrojtje e mjedisit jetësor, arsim, punësim, promovim i barazisë gjinore dhe zhvillim i burimeve njerëzore, bujqësi dhe zhvillim rural.

Mjetet nga programet IPA që zbatohen nëpërmjet menaxhimit indirekt janë këto programe vjetore dhe shumëvjetore:

" Programi aksional për vitin 2014 në kuadër të të cilit financohen projekte në sektorët e mëposhtëm: drejtësi, sistem i rikuperimit nga fatkeqësitë dhe sigurim i vazhdimësisë në punë, zhvillim i kapaciteteve për kryerjen e inspektimeve në terren, bileta hyrëse për programet e BE-

së, konkurrueshmëri lokale dhe rajonale me fokus në turizëm dhe përkrahje të integritetit në BE (SEP);

" Programi aksional për vitin 2015, Programi aksional për vitin 2016, Programi aksional për vitin 2018 dhe Programi aksional për vitin 2020, në kuadër të të cilave financohen biletat hyrëse për programet e BE-së;

" Programi aksional për vitin 2017 në kuadër të të cilit financohen projekte në sektorët e mëposhtëm: punë dhe arsim, bileta hyrëse për programet e BE-së;

" Programi sektorial shumëvjetor për aksionet e transportit dhe mjedisit jetësor si dhe klimës, për periudhën 2014 - 2020;

" Programi IPARD 2.

Në kuadër të Programit aksional për vitin 2014, Republikës së Maqedonisë së Veriut i janë vënë në dispozicion 20 milionë euro mjete IPA dhe me pagesat gjatë vitit 2022, ky program ka përfunduar.

Në kuadër të programit shumëvjetor për aktivitetet e mjedisit jetësor dhe klimatike si dhe të transportit, parashikohet financimi i projekteve në fushën e komunikacionit rrugor dhe hekurudhor, si dhe projekte për ndërtimin e stacioneve të filtrimit të ujërave të zeza, rrjeteve të kanalizimeve dhe menaxhimit të mbetjeve dhe ndryshimeve klimatike.

Për periudhën 2014-2020, në kuadër të Sektorit të Mjedisit Jetësor dhe për aktivitetet klimatike janë ndarë 114.95 milionë euro nga fondet IPA dhe 110.91 milionë euro në kuadër të Sektorit të Transportit. Gjithashtu, 39.9 milionë euro do të sigurohen si bashkëfinancim nacional nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërsa 339.7 milionë euro do të sigurohen nga VBIF-ja (grant prej rreth 149 milionë euro) dhe nëpërmjet huave nga institucionet financiare ndërkombëtare. Sipas Marrëveshjes financiare të nënshkruar për këtë program, afati i pagesës dhe përfundimit të marrëveshjeve është data 31.12.2026.

Në kuadër të Programit aksional për vitin 2017, financohen marrëveshjet në fushën e punës dhe arsimit, me qëllim uljen e shkallës së lartë të papunësisë, rritjen e pjesëmarrjes, veçanërisht të rinjve dhe grave, në fuqinë e tregut të punës, rritjen e qasjes në arsim dhe trajnim cilësor, duke përmirësuar rezultatet dhe aftësitë dhe duke krijuar sistem modern dhe fleksibël të mbrojtjes sociale. Për arritjen e qëllimit të përgjithshëm janë planifikuar disa projekte në fushën e: përorcimit institucional të kapaciteteve për reforma të qëndrueshme sektoriale; përforcimit të sistemit të arsimit dhe trajnimit; promovimit të zhvillimit të aftësive, punësimit dhe kushteve të punës; mbrojtjes sociale, përfshirjes sociale dhe pjesëmarrjes së barabartë në tregun e punës dhe shoqërisë. Përfundimisht deri më 20 nëntor të vitit 2021, përkatësisht afati përfundimtar për nënshkrimin e marrëveshjeve në pajtim me Marrëveshjen financiare të nënshkruar për Programin aksional për arsim, punësim dhe politikë sociale 2017, janë nënshkruar 10 (dhjetë) marrëveshje në vlerë të përgjithshme prej 12.26 milionë eurove, prej të cilave 11.67 milionë euro janë mjete nga IPA.

Në kuadër të Programit IPARD 2 janë përkrahur projekte që do të mundësojnë arritjen e standardeve të BE-së të vendosura në fushën e prodhimit bujqësor, përpunimit të ushqimit dhe zhvillimit rural. Për periudhën 2014 - 2020, në kuadër të këtij programi, në dispozicion të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë vënë në dispozicion 60 milionë euro mjete nga IPA. Zbatimi i Programit IPARD 2014 - 2020 realizohet nëpërmjet 4 masave (investimet në pajisje fizike (materiale) të ekonomive bujqësore, investimet në paisjet bazë për përpunimin e produkteve bujqësore dhe të peshkut, diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve dhe ndihmë teknike për zbatimin e programit), njëkohësisht filluan përgatitjet për akreditimin e një

mase tjetër (investimet në infrastrukturën publike rurale). Deri në fund të vitit 2023, në kuadër të këtij programi janë nëshkruar 2378 marrëveshje nga gjithsej nëntë thirrjet publike.

4.3 IPA 3 - Perspektiva financiare 2021 – 2027

Fokusi i IPA 3 është në mjetet e investimeve në formën e granteve dhe huave si dhe në rritjen e konvergjencës. Gjithashtu, me IPA 3, fokusi i Bashkimit Evropian është në bashkëpunimin me BEI-në dhe BERZH-in por edhe me institucione të tjera financiare ndërkombëtare, të cilat do t'i ofrojnë të ashtuquajturat hua “leverage”. IPA 3 do të duhet të kontribuojë në zbatimin e “Planit ekonomik dhe investues për Ballkanin Perëndimor” të miratuar në samitin e majit të vitit 2020 të mbajtur në Zagreb, me qëllim nxitjen e rimëkëmbjes dinamike afatmesme, krijimin e vendeve të punës dhe rritjen e tregtisë ndërmjet Ballkanit Perëndimor dhe BE-së, nëpërmjet financimit të projekteve të mëdha infrastrukturore në sektorët e transportit, mjedisit jetësor, dixhitalizimit dhe energjetikës, të cilat janë të rëndësishme për lidhjen rajonale, si dhe projekteve në fazë përfundimtare për zbatim në 4 vitet e ardhshme.

Shfrytëzimi i mjeteve të IPA 3 do të realizohet në nivel nacional dhe rajonal. Shfrytëzimi i mjeteve përmes Instrumentit për Ndhimë Paraaderuese IPA 3 për periudhën 2021 - 2027, parasheh 5 të ashtuquajturat dritare, si në vijim:

- Dritarja 1: Sundimi i ligjit, të drejtat themelore dhe demokracia;
- Dritarja 2: Qeverisja e mirë, harmonizimi i legjislacionit, marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe komunikimi strategjik;
- Dritarja 3: Axhenda e gjelbër dhe lidhshmëria e qëndrueshme;
- Dritarja 4: Konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse;
- Dritarja 5: Bashkëpunimi territorial dhe ndërkufitar.

Në nivel nacional, pakoja financiare e mjeteve do të lëvizë në kuadër të 80-100 milionë eurove aktuale, në nivel vjetor. Në kuadër të pakos nacionale, fokusi mbetet në fillimin e negociatave, përshtatjen e administratës me ritmin e përshpejtuar të reformave dhe mekanizmat koordinues që duhet ta drejtojnë përpara procesin e negociatave, sipas metodologjisë së re të negociatave në grupimin në klasterë dhe harmonizimin e negociatave me shfrytëzimin e mjeteve IPA për nevojat e procesit të negociatave dhe reformave strukturore në të gjithë shoqërinë.

Vlera e mjeteve financiare në nivel nacional do të varet nga gatishmëria e administratës për të përgatitur projekte relevante dhe përfundimtare që rezultojnë nga nevojat e procesit të integritetit evropian, si dhe nga angazhimi politik në zbatimin e këtyre projekteve, sepse IPA 3 është garë ndërmjet vendeve shfrytëzuese (vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia) në kuadër të të ashtuquajturës: shpërndarja e drejtë (“fair share”).

Në nivel rajonal, pjesa më e madhe e mjeteve të paraqitura të IPA 3 do të plasohen përmes programeve rajonale, të destinuara për përkrahjen e sektorëve të transportit, mjedisit jetësor, energjetikës, përkrahjes sociale dhe dixhitalizimit. Prandaj, do të jetë e rëndësishme që këta sektorë t'i zbatojnë me sukses strategjitë e tyre të zhvilluara afatgjata në të cilat përcaktohen prioritetet nacionale, por edhe tendencat që dalin nga axhenda evropiane, si dixhitalizimi, interneti gjithëpërfshirës dhe me shpejtësi të lartë, projektet energjetike dhe transformimi drejt dekarbonizimit, burimet e rinovueshme të energjisë, infrastruktura e gazit, ekonomia qarkore, mjedisi i pastër, garancitë për biznesin privat dhe lidhjen e komunikacionit etj. Mjetet e kornizës së investimeve për Ballkanin Perëndimor do të vazhdojnë të jenë në dispozicion të vendit tonë sipas parimit të të ashtuquajturës bashkim “blending” i granteve dhe huave. Prioritet për

financim do të kenë projektet e maturuara, të gatshme për zbatimin e shpejtë. Njëkohësisht, strategjia e re fiskale do të jetë më e relaksuar në drejtim të huamarrjes së kapitalit nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Në kuadër të Instrumentit të ri për Ndihmë e Paraaderuese (IPA 3), në përputhje me Marrëveshjen kornizë të partneritetit dhe Kornizën financiare 2021 - 2027, është i nevojshëm krijimi i Sistemit të ri për menaxhimin indirekt të mjeteve IPA. Lidhur me Programin aksional vjetor 2022, koordinatori nacional i autorizimit ka dorëzuar në KE Kërkesën për ndarjen e detyrave të implementimit të buxhetit. Në kuadër të këtij programi, përmes Sistemit të menaxhimit indirekt, është planifikuar të implementohen projekte në fushat në vijim:

- BE-ja për sistemet moderne të stacioneve të filtrimit të ujërave të zeza

Në kuadër të Programit IPARD 2021-2027, Republikës së Maqedonisë së Veriut i janë vënë në dispozicion gjithsej 97 milionë euro mjete IPA, ndërsa bashkëfinancimi nacional është 31.073.333 euro. Thirrja e parë publike u publikua në shtator të vitit 2023.

Lista e projekteve të planifikuara në periudhën 2024-2028

- " Programi shumëvjetor i transportit:

- " Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - ndërtimi i aksit rrugor Gradsko – Nyja rrugore Drenovë si pjesë e Korridorit rrugor 10-D; Mbikëqyrja e ndërtimit të aksit rrugor Gradsko - Nyja rrugore Drenovë, si pjesë e Korridorit rrugor 10-D. Periudha e implementimit të kësaj marrëveshjeje duhet të përfundojë në tremujorin e tretë të vitit 2025;

- " Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Rehabilitimi i rrugës shtetërore A2, pjesa Kumanovë - Stracinë (faza 1); Mbikëqyrja e rehabilitimit të rrugës shtetërore A2, aksi rrugor Kumanovë - Stracinë (faza 1). Periudha e implementimit të kësaj marrëveshjeje duhet të përfundojë në tremujorin e tretë të vitit 2024;

- " Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Ndërtimi i aksit hekurudhor Kriva Pallankë - kufiri me Republikën e Bullgarisë; Mbikëqyrja e ndërtimit të aksit hekurudhor Kriva Pallankë - Kufiri me Republikën e Bullgarisë. Planifikimi i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje është në proces të tremujorit të parë të vitit 2024 me periudhë implementimi prej 72 muajsh;

- " Marrëveshja e shërbimeve - Përgatitja e dokumentacionit të projektit për nyjen multimodale - Trubarevë. Marrëveshja është nënshkruar në tremujorin e parë të vitit 2023 dhe është me periudhë implementimi prej 18 muajsh;

- " Marrëveshja e shërbimeve - Revizioni teknik për projektin kryesor - Ndërtimi i aksit rrugor Gradsko – nyja rrugore Drenovë, si pjesë e Korridorit rrugor 10-D. Marrëveshja duhet të nënshkruhet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2023 me periudhë implementimi prej 34 muajsh;

- " Marrëveshja e shërbimeve - Revizioni teknik i projektit kryesor - Ndërtimi i aksit hekurudhor Kriva Pallankë - kufiri me Republikën e Bullgarisë. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024 me periudhë implementimi prej 48 muajsh.

- " Marrëveshja e shërbimeve - Hartimi i planit të implementimit sipas Strategjisë nacionale të transportit 2018 - 2030 me sistem, pajisje dhe kapacitet për monitorimin e tij. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 12 muajsh;

- " Marrëveshja e Shërbimeve - Plani i qëndrueshëm i transportit urban të Qytetit të Shkupit. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024 me periudhë implementimi prej 24 muajsh.

" Marrëveshja e Shërbimeve - Përgatitja e Strategjisë nacionale të aviacionit 2021 - 2030. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e katërt të vitit 2023 me periudhë implementimi prej 9 muajsh.

" Programi shumëvjetor i aksioneve për mjedisin jetësor dhe klimatik:

" Marrëveshja e Shërbimeve - Përkrahja e strukturës IPA-OP në planifikimin e projekteve dhe menaxhimin financiar në Sektorin e Mjedisit Jetësor. Projekti duhet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2024 me periudhë implementimi prej 30 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përmirësimi i kapaciteteve për "NATURA 2000" dhe "CITES". Marrëveshja është nënshkruar në vitin 2022 me periudhë implementimi prej 30 muajsh;

" Marrëveshja e Shërbimeve - Zbatimi i përmirësuar i Direktivës së BE-së për përmbytjet, duke harmonizuar legjislacionin nacional dhe duke përgatitur plane për menaxhimin e risqeve nga përmbytjet. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e tretë të vitit 2024 me periudhë implemetimi prej 30 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Hartimi dhe implemetimi i planeve të menaxhimit të shtretërve të lumenjve për të gjithë shtretërit e lumenjve (lumi Vardar, lumi Drini i Zi, lumi Strumica) në kuadër të kornizës direktive të ujit me implementimin e masave. Marrëveshja është planifikuar të nënshkruhet në tremujorin e tretë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 24 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Implemetimi i aktiviteteve prioritare të zhvilluara në kuadër të strategjisë afatgjate për kufizimin e emetimit të gazrave serrë dhe transpozimin e mëtejshëm të legjislacionit për aksionin klimatik. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 30 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përkrahja e implementimit të sistemeve rajonale të menaxhimit të mbetjeve në Rajonet lindore dhe verilindore. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 24 muajsh.

" Marrëveshja e shërbimeve - Përgatitja dhe revizioni i dokumenteve nacionale të planifikimit të mbetjeve. Marrëveshja është nënshkruar në tremujorin e tretë të vitit 2023, me periudhë implementimi prej 18 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përkrahja në zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e mbetjeve dhe skemë të zgjeruar të përgjegjësisë së prodhuesit. Duke filluar nga tremujori i katërt i vitit 2022, ky projekt është në fazë implementimi me periudhë prej 27 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përkrahja në zbatimin e direktivave për cilësinë e ajrit. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e tretë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 24 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përkrahja në zbatimin e legjislacionit horizontal. Marrëveshja është planifikuar të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 24 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Hartimi i hartave strategjike të zhurmave dhe planeve aksionale me programe masash. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementim prej 24 muajsh;

" Marrëveshja Tuining - Përforcimi i kapaciteteve të zbatimit të legjislacionit të mjedisit jetësor dhe ndryshimeve klimatike. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 27 muajsh;

" Marrëveshja e prokurimeve - Prokurimi i TI-së dhe pajisjeve të tjera specifike për monitorimin e mjedisit jetësor dhe Sistemin e informacionit. Marrëveshja është nënshkruar në tremujorin e tretë të vitit 2023, me periudhë implementimi prej 17 muajsh;

" Marrëveshja e prokurimit - Prokurimi i pajisjeve teknike dhe të zyrës dhe Softuerit –TIK, për strukturën operative të MoEPP për zbatimin e “SOPECA”. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 18 muajsh;

" Marrëveshja e prokurimeve - Prokurimi i pajisjeve specifike për sistemin informativ të monitorimit të ujit. Marrëveshja duhet të nënshkruhet me periudhë implementimi prej 24 muajsh;

" Marrëveshja e prokurimeve - Prokurimi i TI-së dhe pajisjeve të tjera specifike për Sistemin informativ të monitorimit të zhurmave. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 24 muajsh.

" Marrëveshja tuining - Përforcimi i mëtejshëm i kapaciteteve për zbatimin efektiv të legjislacionit të BE-së në fushën e ndotjes industriale. Marrëveshja është nënshkruar në tremujorin e parë të vitit 2023, me periudhë implementimi prej 23 muajsh;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Rehabilitimi dhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës dhe mbikëqyrja e Marrëveshjes së zgjerimit të rrjetit të kanalizimit në Komunën e Kërçovës. Marrëveshja është nënshkruar në tremujorin e parë të vitit 2023, me periudhë implementimi prej 36 muajsh;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Ndërtimi i stacionit të filtrimit të ujërave të zeza në Komunën e Manastirit dhe Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit, Mbikëqyrja e Marrëveshjes së ndërtimit të stacionit të filtrimit të ujërave të zeza dhe Rehabilitimi dhe përmirësimi i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Manastirit. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 39 muajsh;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Ndërtimi i stacionit të filtrimit të ujërave të zeza në Komunën e Tetovës dhe Zgjerim i rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës, Mbikëqyrja e Marrëveshjes së ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të zeza dhe rehabilitimin dhe përmirësimin e rrjetit të kanalizimit në Komunën e Tetovës. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 39 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përkrahja dhe përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për prokurimin e pajisjeve të ujësjellësit për komunat Radovish, Kërçovë, Strumicë, Manastir, Tetovë, Berovë, Kumanovë dhe Prilep. Marrëveshja është planifikuar të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 18 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimeve - Revizioni teknik i projekteve të mëdha të ujërave të zeza. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 40 muajsh;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Mbyllja e deponive dhe deponive ilegale në rajonin Lindor – Loti 1, Marrëveshja e mbikëqyrjes së punëve ndërtimore për mbylljen e deponive dhe deponive ilegale të cilat nuk janë në harmonizim, në rajonin Lindor dhe Verilindor - faza e parë. Marrëveshja është në fazën e implementimit dhe duhet të përfundojë në tremujorin e parë të vitit 2024;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore - Mbyllja e deponive dhe deponive ilegale në rajonin Verilindor - Loti 2. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024, me afat implementimi prej 24 muajsh;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Ndërtimi i objektit

qendror të menaxhimit të mbetjeve - Fabrika e klasifikimit, reparti MBT, deponia, njësia e kompostimit, pika e gjelbër në rajonin Lindor dhe Verilindor në Shën Nikollë dhe ndërtimi i gjashtë objekteve lokale të menaxhimit me mbetjet – stacionet e transferimit, njësia e kompostimit, pika e gjelbër në rajonin Lindor dhe Verilindor, Supervizioni i marrëveshjes së ndërtimit për vendosjen e sistemit të vetëqëndrueshëm të integruar rajonal të menaxhimit të mbetjeve në rajonin Lindor dhe Verilindor. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 30 muajsh;

" Marrëveshja e shërbimëve - Revizioni teknik i projekteve të mëdha të mbetjeve.

Planifikimi i nënshkrimit të marrëveshjes duhet të nënshkruhet në tremujorin e dytë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 32 muajsh;

" Granti direkt i Ministrisë së Financave për skemën e nëngranteve në kombinim me programin e huasë së BB-së, zbatuar nga MMJPH PIU. Marrëveshja duhet të nënshkruhet në tremujorin e parë të vitit 2024, me periudhë implementimi prej 40 muajsh.

" Programi aksional 2017 - Arsimi, punësimi dhe politika sociale:

" Marrëveshja e shërbimeve - Rritja e cilësisë së edukimit dhe kujdesit parashkollor. Marrëveshja është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përmirësimi i kushteve të punës. Marrëveshja është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Grant direkt i APRM-së - Aktivizimi i tregut të punës për grupet e ndjeshme. Momentalisht është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e mbikëqyrjes - Ndërtimi i çerdheve në komunën e Tetovës dhe Tearcës dhe mbikëqyrja e Marrëveshjes së ndërtimit. Momentalisht është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja Tuining - Përkrahja e mëtejshme e zbatimit të kornizës nacionale të kualifikimeve. Marrëveshja është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja e prokurimit - Prokurimi i pajisjeve - Përkrahje e mëtejshme për zbatimin e Kornizës nacionale të kualifikimeve. Momentalisht është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja e shërbimeve - Përmirësimi i cilësisë së arsimit. Momentalisht është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025;

" Marrëveshja e shërbimëve - Rritja e atraktivitetit, gjithëpërfshirjes dhe relativitetit të VET-it dhe arsimit të të rriturve. Marrëveshja është në proces implementimi, me pagesë programore deri në tremujorin e katërt të vitit 2025.

" Programi aksional vjetor 2022

" Marrëveshja e punëve ndërtimore dhe Marrëveshja e shërbimeve - BE, për sisteme moderne për stacionet e filtrimit të ujërave të zeza në Shtip dhe Vinicë.

" Programi IPARD 2014 - 2020

" Marrëveshjet e grantit në fushën e prodhimitarisë bujqësore, përpunimit të ushqimit dhe zhvillimit rural (2363 marrëveshje janë nënshkruar në gjithsej tetë thirrje publike)

" Programi IPARD 2021 - 2027

" Marrëveshjet e grantit në fushën e prodhimtarisë bujqësore, përpunimit të ushqimit dhe zhvillimit rural

Krahasimi i buxhetit paraprak dhe realizimi i tij, si dhe shpjegimi cilësor dhe sasior i shmangieve kryesore.

Области	Буџет 2022	Реализација 2022	% на реализација 2022 со Буџет 2022	Буџет 2023	Реализација 2023	% на реализација 2023 со Буџет 2023
Програма						
Транспорт, Животна средина, Образование, Вработување						
МЕ/сметка 603	129.044	119.76	92,80 %	100.92	73.059	22.02%
МЕ/сметка 785	1.100.707	782.778	71,11 %	1.597.560	528.878	33,10 %
МВ/сметка 603	/	/	/	2.000	1.562	78.12%
МВ/сметка 785	/	/	/			
МА/сметка 603	/	/	/	0.00	/	0%
МА/сметка 785	/	/	/			
Заем од ЕИБ и ЕБРД	67	63.197	94,32%	/	/	/
МВ/сметка 786						
Рурален развој						
МД/сметка 785	842.676	825.246	97.92%	805.657	553.555	68.75%

Në Buxhetin e vitit 2022, përkatësisht në pjesën - Integritet në BE, janë siguruar gjithsej 129 milionë denarë si bashkëfinancim i detyrueshëm nacional për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA, por edhe 1.100 milionë denarë shtesë si mjete donacionesh dhe 67 milionë denarë në bazë të huave. Nga gjithsej mjetet e siguruar nga Buxheti për vitin 2022, janë shfrytëzuar 93% e mjeteve të planifikuara nacionale, përkatësisht 71% e mjeteve të planifikuara për donacione. Në Programin për zhvillim rural (IPARD), përkundër pandemisë globale, ka realizim të mirë të mjeteve, sepse ka interesim të madh nga shfrytëzuesit fundorë, gjë që shihet përmes numrit të madh të aplikacioneve të pranuar dhe marrëveshjeve të nënshkruara me AMFZHR-në.

Në Buxhetin e vitit 2023, përkatësisht në pjesën - Integritet në BE, janë siguruar gjithsej 102.92 milionë denarë si bashkëfinancim i detyrueshëm nacional për zbatimin e projekteve të financuara nga IPA, por edhe 2.402 milionë denarë shtesë si mjete donacionesh. Nga gjithsej mjetet e siguruar nga Buxheti për vitin 2023, 74.6 milionë denarë janë shfrytëzuar nga mjetet e parapara nacionale, përkatësisht 1.082 milionë euro nga mjetet e parapara të donacioneve. Në Programin për zhvillim rural (IPARD), përkundër pandemisë globale, ka realizim të mirë të mjeteve, sepse ka interesim të madh nga shfrytëzuesit fundorë, gjë që shihet nëpërmjet numrit të madh të aplikimeve të pranuar dhe marrëveshjeve të nënshkruara me AMFZHR-në.

Krahasimi i projeksioneve të parametrave të dhënë me Strategjinë fiskale paraprake, si dhe

shpjegimi cilësor dhe sasior i ndryshimeve kryesore, përfshirë edhe ndryshimet në politika.

во милиони денари			
	Ревидирана фискална стратегија 2023 - 2027	Фискална стратегија 2024 - 2028	% на зголемување/ намалување на проекциите
МЕ / сметка 603	2.183.200	5.070.195	132%
МЕ / сметка 785	22.275.276	28.015.738	26
МД / сметка 785	3.516.420	981.461	-72%

Në Strategjinë fiskale 2024 - 2028, në kuadër të programeve ME, parashihet rritje e mjeteve nga Buxheti për implementimin e marrëveshjeve aktuale nga IPA 2, por edhe për procesin e nisur të programimit dhe akreditimit të IPA 3, në kuadër të të cilit implementimi i marrëveshjeve është paraparë në fushën e mjedisit jetësor dhe punësimit.

Në Strategjinë fiskale 2024 - 2028, në Programin për zhvillim rural (IPARD) mjetet janë ulur për 72% krahasuar me Strategjinë fiskale paraprake, si rezultat i përfundimit të implementimit të Programit IPARD 2 dhe pritshmëritë për fillimin e implementimit të programit të ri IPARD 3, për të cilin në këtë strategji fiskale, sipas të dhënave të deritanishme, është shpallur thirrje publike e cila në fazën e miratimit të aplikimeve që kanë arritur në Agjencinë IPARD.

4.4 Plani i ri i BE-së për rritjen e Ballkanit Perëndimor

Më 8 nëntor të vitit 2023, KE-ja i dorëzoi Parlamentit Evropian dhe Këshillit të BE-së Planin të ri të rritjes së Ballkanit Perëndimor (Plan) së bashku me Rregulloren për krijimin e instrumentit financiar për reformat dhe rritjen e Ballkanit Perëndimor. Rregullorja dhe Plani priten të miratohen në tremujorin e parë të vitit 2024.

Konvergenca ekonomike është element thelbësor për afrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor me BE-në. Momentalisht, niveli dhe përsheptimi i konvergencës ndërmjet tyre dhe BE-së nuk janë të kënaqshme – as në aspektin e proceseve të reformave dhe as të konvergencës socioekonomike, në këtë mënyrë po pengohet progresi i këtyre vendeve në rrugën drejt BE-së. Prandaj, lind nevoja për fillimin dhe inkurajimin e përsheptuar të përgatitjes së Ballkanit Perëndimor për anëtarësimin në BE, duke paraqitur disa nga përfitimet e tij, veçanërisht në mënyrë që të mund të ndjehen drejtpërdrejt nga qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi është t'u mundësohet vendeve të Ballkanit Perëndimor përforcimi i reformave dhe investimeve për përsheptimin sinjifikativ të procesit të zgjerimit dhe rritjes së këtyre ekonomive.

Ndihma aktuale financiare për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në kuadër të Instrumentit për Ndhimë Paraaderuese (IPA III) do të vazhdojë në formën e saj aktuale. Prandaj, mekanizmi i ri do të plotësojë qasjen e IPA III duke u fokusuar në përcaktuesit determinues të rritjes ekonomike dhe sociale.

Pritet që Maqedonisë së Veriut t'i destinohen 859 milionë euro, nga të cilat dy të tretat do të jenë hua dhe një e treta grante investimi. Njëkohësisht, gjysma e mjeteve do të ndahen për përkrahjen buxhetore, ndërsa gjysma e dytë për projektet investuese nëpërmjet Kornizës investuese për Ballkanin Perëndimor - WBIF.

Për shfrytëzimin e këtyre mjeteve, Ministria e Financave, në bashkëpunim me SEP-in dhe të gjitha institucionet e përfshira, duhet të përgatisë dokument të ashtuquajtur Axhenda reformuese, i cili i referohet periudhës 2024-2027, ndërsa duhet t'i dorëzohet BE-së deri në fund të marsit të vitit 2024. Pas miratimit të Axhendës reformuese nga KE-ja, çdo 6 muaj MF-ja duhet t'i parashtrojë kërkesë BE-së për tërheqjen e mjeteve. BE-ja duhet të kontrollojë nëse janë plotësuar kushtet për transhenë dhe pastaj t'i lëshojë plotësisht ose pjesërisht mjetet sipas shkallës së përmbushjes së kushteve.


5. Borxhi publik

Menaxhimi efikas i borxhit publik ka rëndësi thelbësore dhe nënkupton zvogëlimin e risqeve gjatë konceptimit të strukturës dhe politikës për menaxhimin e borxhit, në mënyrë që të shmangët pamundësia eventuale e shërbimit të rregullt dhe në kohë të borxhit. Qëllimi kryesor është të sigurohen mjetet e nevojshme për financimin e deficitit buxhetor, shlyerjen e borxheve të maturuara si rezultat i huamarrjeve nga vitet e kaluara, si dhe mjetet për financimin e projekteve, pa shkaktuar rritje të pajustificuar të borxhit në nivel që mund ta cenojë stabilitetin e ekonomisë dhe rritjen ekonomike të shtetit. Cilësia e menaxhimit të borxhit, ndër të tjera, është determinuar nga kuadri institucional dhe kapaciteti për vendosjen dhe zbatimin e politikës së menaxhimit të borxhit publik. Kjo nënkupton përcaktim të qartë të qëllimeve dhe masave për menaxhimin e borxhit publik.

5.1. Vlera e borxhit publik dhe shtetëror

Borxhi shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut më datë 30.09.2023 është 6.936.4 milionë euro, përkatësisht 47.8% e PBB-së. Në kuadër të borxhit nacional, peshë dominuese e borxhit të Qeverisë qendrore është 6.921.9 milionë euro, ndërsa borxhi i komunave është 14.4 milionë euro. Borxhi i përgjithshëm publik përfshin borxhin shtetëror dhe borxhin e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi dominuese ose të plotë shtetërore (borxhi i garantuar dhe i paguarantuar) dhe rezulton të jetë 8.032.6 milionë euro më datë 30.09.2023, që paraqet 55.3% të PBB-së.

Grafiku 15: Situata e borxhit shtetëror dhe publik



Borxhi i qeverisë qendrore paraqet 99.8% të borxhit të përgjithshëm të Qeverisë në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023 dhe ky borxh menaxhohet drejtpërdrejt nga Ministria e Financave. Për nivelet e tjera të borxhit, si borxhi i komunave dhe borxhi i ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi dominuese të shtetit apo komunave, Ministria e Financave merr pjesë në procesin e huamarrjes, por nuk mund të ndikojë në intensitetin e tërheqjes së

mjeteve nga huatë e nënshkuara.

Projeksione më të detajuara për lëvizjen e borxhit shtetëror dhe publik do të prezantohen në Strategjinë e menaxhimit të borxhit publik për periudhën 2024 - 2026 (me perspektivë deri në vitin 2028).

5.2. Borxhi i garantuar dhe rreziku i aktivizimit të garancive shtetërore

Pas analizave të kryera të huamarrësit dhe aftësisë së tij për t'i servisuar në mënyrë të pavarur detyrimet e ardhshme për sigurimin e kushteve më të mira për financimin nga kreditorët, shteti jep garanci shtetërore. Gjatë realizimit të huamarrjeve të reja, udhëhiqet llogaria për qëndrueshmëri afatgjate të financave publike, me ç'rast procesi i dhënies së garancive të reja është i rregulluar në mënyrë rigoroze dhe i nënshtrohet procedurës së huamarrjes të përcaktuar në Ligjin e Borxhit Publik, sipas të cilit aplikuesit e garancisë duhet t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në mënyrë që shteti të mund të japë garanci. Në përputhje me ndryshimet ligjore në Ligjin e Borxhit Publik të vitit 2019, menaxhimi i detyrimeve potenciale është përmirësuar duke përforcuar kapacitetet në pjesën e dhënies së pëlqimeve për huamarrje. Njëkohësisht, gjatë dhënies së garancisë shtetërore Ministria e Financave kryen analizë kreditore dhe vlerësim të aftësisë kreditore të poseduesve të borxhit publik, në harmonizim me metodologjinë e vlerësimit që është përcaktuar në mënyrë të posaçme. Me këtë lloj qasje harmonizohen praktikat ndërkombëtare në dhënien e garancive shtetërore.

Duke përfshirë datën 09.10.2023, garancitë e dhëna arrijnë në vlerë prej 1.025.3 milionë eurove, që paraqet 7.1% të PBB-së.

Megjithëse borxhi i garantuar është pjesë përbërëse e borxhit publik dhe publikohet në mënyrë transparente, Ministria e Financave merr parasysh rrezikun që lidhet me detyrimet e mundshme, përkatësisht të cilat do të ishin efektet në buxhet në rast të aktivizimit të garancive shtetërore. Ky segment shpjegohet më hollësisht në pjesën mbi risqeve fiskale, si pjesë përbërëse e Strategjisë fiskale.

6. Analiza komparative e projeksioneve makroekonomike dhe fiskale për periudhën 2024 - 2028

6.1 Krahassimi me Strategjinë fiskale 2024 – 2028

Strategjia fiskale e reviduar e RMV-së 2024 – 2028, krahasuar me Strategjinë fiskale të RMV-së 2024 – 2028, tregon shamngje të caktuara që i referohen projeksioneve makroekonomike, si rezultat i rigorozitetit të marrëdhënieve ekonomike dhe politike ndërkombëtare të shkaktuara nga lufta në Ukrainë dhe konflikti në Lindjen e Mesme, të ndjekura nga presionet inflacioniste të intensifikuara dhe afatgjate, pritshmëritë për reduktimin e tregtisë globale dhe kërkesës së jashtme, rigoroziteti i kushteve të financimit global, që rritën më tej pasigurinë për perspektivën ekonomike, sidomos ndërmjet partnerëve tanë kryesorë tregtarë.

Në vitin 2024 pritet rritje e mëtejshme e ekonomisë, ndonëse me nivel më të moderuar në raport me projeksionin paraprak, pjesërisht si rezultat i pritshmërive për rritje më të moderuar të konsumit privat, por edhe kontribut negativ më të madh të eksporteve neto si rezultat i pritshmërive për dinamizimin e tregtisë së jashtme, veçanërisht të importeve në kushtet e rikuperimit të kërkesës dhe rritjes së investimeve. Në periudhën e ardhshme pritet zgjatje e caktuar e dinamikës së arritjes së normave më të larta të rritjes ekonomike, por edhe përsheptim i rritjes në fund të periudhës të cilës i referohen projeksionet, në kushtet e realizimit të masave të parapara në dokumentet strategjike të Qeverisë për përsheptimin dhe

arritjen e rritjes së qëndrueshme, të plotësuara me përkrahjen e paraparë të BE-së për integrimin e përsheptuar të vendeve të rajonit. Lidhur me përbërjen e rritjes së aktiviteteve ekonomik, si dhe në Strategjinë fiskale paraprake, pritet që rritja të nxitet nga kërkesa vendore, me kontribut pozitiv si nga konsumi ashtu edhe nga investimet, ndërsa në kushtet e rritjes solide eksportet neto do të kenë kontribut negativ, por në mënyrë graduale duhet të ulen si eksporti ashtu edhe importi.

Shamngje për vitin 2024 ka edhe në normën e inflacionit, e cila është reviduar në rritje, pasi është dëshmuar të jetë më e përbalueshme krahasuar me pritjet e paraprake në nivel global, në kushtet e përshtatjes më të vogël ndaj inflacionit bazë. Projektionet për periudhën e ardhshme afatmesme nuk janë reviduar.

Lidhur me bilancin e pagesave, shihet korrigjim në rënien e deficitit të llogarisë aktuale, para së gjithash, për shkak të përmirësimit sinjifikativ të deficitit gjatë vitit 2023, kryesisht si rezultat i reduktimit të deficitit energjetik.

Në pjesën e tregut të punës ka shmangje në raport me parashikimet paraprake, për shkak të ndryshimit të metodologjisë gjatë përpunimit të të dhënave të publikuara në njoftimet tremujore për anketën e fuqisë punëtore për vitin 2023, gjë që solli pakrahasueshmërinë e të dhënave dhe ndërprerjen e serive kohore. Sipas projeksioneve, situata në tregun e punës edhe më tej pritet të përmirësohet. Lidhur me pagesat, projektionet janë reviduar në drejtim të rritjes, në kushtet e rritjes më të lartë të pagave në vitin 2023, krahasuar me pritjet e paraprake, harmonizimin e mëtejshëm të pagave me pagën minimale në vitin 2024, harmonizimin dhe rritjen e pagave në sektorin publik, si dhe rritjen e pritshme të pagave në sektorin privat.

Tabela 13. Krahasimi i projeksioneve makroekonomike me Strategjinë fiskale të reviduar 2022 - 2026.

Индикатори	Фискална стратегија 2024-2028						Ревидирана Фискална стратегија 2024-2028					
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2023	2024	2025	2026	2027	2028
БДП, реална стапка на раст (%)	2,5	4,0	5,0	5,6	5,4	5,2	2,3	3,4	4,8	5,5	5,7	6,1
Стапка на инфлација (просек)	8,9	2,5	2,0	2,0	2,0	2,0	9,2	3,6	2,0	2,0	2,0	2,0
Салдо на тековна сметка (% од БДП)	-4,2	-3,3	-2,8	-2,3	-1,6	-1,1	-1,4	-2,2	-2,1	-1,9	-1,5	-1,1
Нето-плата - номинален пораст (%)	10,6	6,4	6,1	6,0	5,8	5,7	13,5	8,4	6,6	6,0	5,9	6,0
Стапка на невработеност (просек)	14,0	13,1	11,9	10,5	9,4	8,4	12,8	11,9	11,0	10,1	9,2	8,3
Стапка на вработеност (просек)	47,7	48,6	49,9	51,3	52,6	53,9	45,5	47,3	48,6	49,7	50,6	51,3

Табела 14. Крахасими i пројексioneве афатмесме пѐр Бухетин е RMV-сѐ ме Strategjinѐ е reviduar fiskale тѐ RMV-сѐ 2024 - 2028 (нѐ милионѐ денарѐ)

	Фискална стратегија 2024-2028							Ревидирана фискална стратегија 2024-2028							Отстапување (Рев.фискална 2024-2028/ Фискална 2024-2028)							% на отстапување						
Буџет на Република Северна Македонија	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*	2022*	2023*	2024*	2025*	2026*	2027*	2028*
Вкупни приходи	243.085	282.052	299.747	322.113	345.195	369.834	392.871	243.085	282.052	310.128	330.280	352.319	378.987	406.256	0	0	10.381	8.167	7.124	9.153	13.385	0	0	3	3	2	2	3
Даночни приходи и придонеси	220.186	250.689	269.385	289.953	311.457	334.672	357.749	220.186	253.205	279.045	296.775	317.536	342.780	370.049	0	2.516	9.660	6.822	6.079	8.108	12.300	0	1	4	2	2	2	3
Даночни приходи	142.567	162.600	172.648	187.005	201.914	218.106	233.705	142.567	162.235	178.067	188.751	201.963	219.130	237.756	0	-365	5.419	1.746	49	1.024	4.051	0	0	3	1	0	0	2
Придонеси	77.619	88.089	96.737	102.948	109.543	116.566	124.044	77.619	90.970	100.978	108.024	115.573	123.650	132.293	0	2.881	4.241	5.076	6.030	7.084	8.249	0	3	4	5	6	6	7
Неданочни приходи	17.189	19.894	20.932	22.130	22.382	22.932	22.892	17.189	17.962	20.394	22.175	22.427	22.977	22.977	0	-1.932	-538	45	45	45	85	0	-10	-3	0	0	0	0
Капитални приходи	2.273	2.800	3.530	3.530	3.530	3.730	3.730	2.273	2.800	3.210	3.530	3.530	3.730	3.730	0	0	-320	0	0	0	0	0	0	-9	0	0	0	0
Донации	3.437	8.669	5.900	6.500	7.826	8.500	8.500	3.437	8.085	7.479	7.800	8.826	9.500	9.500	0	-584	1.579	1.300	1.000	1.000	1.000	0	-7	27	20	13	12	12
Вкупни расходи	278.596	324.811	331.437	351.964	378.140	402.998	423.888	278.596	324.811	343.638	361.906	386.329	412.929	438.970	0	0	12.202	9.942	8.189	9.931	15.082	0	0	4	3	2	2	4
Тековни расходи	249.959	276.059	283.505	299.394	320.252	339.781	355.171	249.959	279.833	298.459	314.137	331.141	352.212	371.253	0	3.774	14.955	14.743	10.889	12.431	16.082	0	1	5	5	3	4	5
Плати и надоместоци	32.159	34.880	37.778	41.492	44.335	46.513	48.121	32.159	37.307	41.178	42.794	45.647	48.847	52.596	0	2.427	3.400	1.303	1.312	2.334	4.475	0	7	9	3	3	5	9
Стоки и услуги	21.001	23.631	23.401	23.500	25.100	25.955	27.455	21.001	22.596	25.113	23.990	24.990	25.650	26.850	0	-1.035	1.712	490	-110	-305	-605	0	-4	7	2	0	-1	-2
Трансфери до ЕПС	23.365	26.687	28.710	28.765	30.165	32.608	35.001	23.365	27.685	29.834	31.342	32.632	34.992	37.458	0	998	1.124	2.578	2.467	2.384	2.457	0	4	4	9	8	7	7
Субвенции и трансфери	32.536	32.987	25.975	27.877	31.136	33.973	36.173	32.536	28.523	23.682	27.077	29.137	33.474	34.473	0	-4.464	-2.293	-800	-1.999	-499	-1.700	0	-14	-9	-3	-6	-1	-5
Социјални трансфери	131.758	144.951	151.667	158.388	166.387	174.580	183.021	131.758	150.607	161.842	168.373	176.299	184.303	193.330	0	5.656	10.175	9.985	9.912	9.723	10.309	0	4	7	6	6	6	6
Каматни плаќања	9.140	12.923	15.973	19.372	23.127	26.152	25.399	9.140	13.115	16.810	20.560	22.436	24.946	26.546	0	192	837	1.188	-691	-1.206	1.147	0	1	5	6	-3	-5	5
Капитални расходи	28.637	48.751	47.932	52.570	57.888	63.217	68.717	28.637	44.977	45.179	47.769	55.188	60.717	67.717	0	-3.774	-2.753	-4.801	-2.700	-2.500	-1.000	0	-8	-6	-9	-5	-4	-1
Буџетско салдо	-35.511	-42.759	-31.690	-29.851	-32.945	-33.164	-31.017	-35.511	-42.759	-33.510	-31.626	-34.010	-33.942	-32.714	0	0	-1.821	-1.775	-1.065	-778	-1.697	0	0	6	6	3	2	5
Примарно буџетско салдо	-26.371	-29.836	-15.717	-10.479	-9.818	-7.012	-5.618	-26.371	-29.644	-16.700	-11.066	-11.574	-8.996	-6.168	0	192	-984	-587	-1.756	-1.984	-550	0	-1	6	6	18	28	10
Вкупни приходи, % од БДП	29,2	30,6	31,7	31,8	31,7	31,6	31,2	29,2	31,5	31,6	31,5	31,2	31,1	30,8														
Вкупни расходи, % од БДП	33,5	35,3	35,1	34,8	34,7	34,4	33,7	33,5	36,3	35,0	34,5	34,2	33,9	33,3														
Буџетско салдо, % од БДП	-4,3	-4,6	-3,4	-3,0	-3,0	-2,8	-2,5	-4,3	-4,8	-3,4	-3,0	-3,0	-2,8	-2,5														
Примарно буџ. салдо, % од БДП	-3,2	-3,2	-1,7	-1,0	-0,9	-0,6	-0,4	-3,2	-3,3	-1,7	-1,1	-1,0	-0,7	-0,5														

Извор: Министерство за финансии и проекти на Министерство за финансии (*)

6.2 Краhasими ме пројексionет е институcioneве тѐ тјера vendore dhe нѐркombѐtare

Goditjet e мѐvonshme ме тѐ cilat ballafaqohet ekonomia globale, rigoroziteti i marrѐdhѐnieve ekonomike dhe politike нѐркombѐtare, тѐ ndjekura nga presionet inflacioniste тѐ intensifikuara dhe афатgjate dhe притshmѐritѐ пѐр uljen e tregtisѐ globale, тѐ cilat rrisin мѐ tej pasigurinѐ пѐр ecurinѐ ekonomike, kushtѐzojnѐ disa dallime lidhur ме пројексionет пѐр rritjen ekonomike dhe normѐn e inflacionit нѐ periudhѐn нѐ vijim, si dhe shfaqen edhe нѐрмјет пројексioneве тѐ институcioneве тѐ ndryshme (Табела 15).

Табела 15. Краhasими i парашикимеве пѐр rritjen e PBB-сѐ dhe inflacionit пѐр Маqedonинѐ е Veriut

Институција	Реален раст на БДП (%)						Стапка на инфлација (%)					
	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2023	2024	2025	2026	2027	2028
ММФ	2,5	3,2	3,5	3,5	3,5	3,5	10,0	4,3	2,2	2,0	2,0	2,0
Светска банка	1,8	2,5	2,9	:	:	:	9,1	3,0	2,0	:	:	:
Европска комисија	2,0	2,7	2,8	:	:	:	9,1	4,1	2,1	:	:	:
НБРСМ	1,9	3,0	4,0	:	:	:	9,5	3,5-4,0	2,0	:	:	:
Министерство за финансии	2,3	3,4	4,8	5,5	5,7	6,1	9,2	3,6	2,0	2,0	2,0	2,0

Извор: ММФ (World Economic Outlook, октомври 2023 г.), Светска банка (Western Balkans Regular Economic Report, октомври 2023 г.), Европска комисија (European Economic Forecast, ноември 2023 г.) и НБРСМ (Квартален извештај, ноември 2023 г.).

6.3 Analiza komparative e nevojave dhe burimeve të huamarrjes

Në harmonizim me projeksionet e nevojave të financimit dhe burimeve të huamarrjes të paraqitura në Strategjinë e reviduar fiskale 2023 - 2025 (me perspektiva deri në vitin 2027), në tekstin e mëtejme Strategjia fiskale e reviduar 2023 - 2027 mund të konstatohet shkallë më e ulët e realizimit të burimeve të huaja dhe vendore financiare, realizimi i të cilave krahasuar me Planin është përkatësisht 38% dhe 54.1%. Konkretisht, në kushtet e krizës energjetike dhe ekonomike, të cilat paraqesin problem global në periudhën e kaluar dhe që kanë ndikuar në rritjen e normave të interesit në tregjet ndërkombëtare, Ministria siguroi instrument financiar, përkatësisht fletobligacion të regjistruar në tregun financiar gjerman - NSV (Namensschuldverschreibungen - NSV) për financimin e deficitit buxhetor dhe për rifinancimin e detyrimeve të borxhit shtetëror për vitin rrjedhës. Ky instrument u siguroi me normë interesi dukshëm më të ulët se sa do të arrihej me emetimin eventual të fletobligacionit të ri. Në tregun vendor është siguruar hua afatshkurtër në vlerë prej 50 milionë eurove dhe është realizuar tërheqje neto e letrave vendore me vlerë, në vlerë prej 114 milionë eurove, që është më pak se vlera e planifikuar.


Pasqyrë e pagesave të planifikuara dhe të realizuara për borxhet dhe huamarrjet e Buxhetit Qendror në vitin 2022 (në milionë denarë)

Huamarrjet e planifikuara për vitin 2023 të përfshira në këtë Strategji fiskale, krahasuar me huamarrjet e planifikuara në Strategjinë fiskale të reviduar 2023 - 2027, janë identike me projektimin e burimeve vendore të huamarrjes dhe ndryshojnë në vlerën dhe strukturën e huamarrjes së huaj.

Përkatësisht, në SF të reviduar 2023 - 2027 ishte planifikuar të realizohej huamarrje e huaj në vlerë prej 66.876 milionë denarëve me mjete të siguruar nga tregu ndërkombëtar i kapitalit në formë të eurobondit, transhesë së dytë nga FMN-ja, huasë për financim buxhetor nga Banka Botërore, Banka Zhvillimore KfV, Fondi i OPEC-ut për Zhvillim Ndërkombëtar dhe tërheqjes së huave nga institucionet financiare ndërkombëtare për financimin e projekteve që implementohen nga shfrytëzuesit buxhetorë. Megjithatë, duke marrë parasysh lëvizjen e tregjeve globale të normave të interesit, të cilat janë rritur në mënyrë të theksuar krahasuar me vitet paraprake, Ministria e Financave vendosi të marrë hua me eurobonde evropiane në vlerë prej 500 milionë eurove (vlerë më e ulët sesa ishte planifikuar) dhe të sigurojë 100 milionë euro nga Bashkimi Evropian si përkrahje makrofinanciare. Burimet e tjera të huasë së financimit mbeten në të njëjtën vlerë dhe strukturë si në Strategjinë fiskale të reviduar 2023-2027. Lidhur me huamarrjen afatmesme, vlera e huamarrjes vendore dhe të huaj mbetet e pandryshuar, me përjashtim të vitit 2027, ku vlera e huamarrjes është rritur si rezultat i nevojës për rifinancimin e eurobondeve të emetuara këtë vit, ndërsa maturohet në vitin 2027. Sipas asaj që u tha më sipër, ndryshimi i vlerës së burimeve të financimit ka reflektimin e vet në nivelin e borxhit shtetëror dhe publik. Përkatësisht, nevojat e reviduara financiare janë paraparë në Strategjinë e menaxhimit të borxhit publik 2024-2026 (me perspektivë deri në vitin 2028), dhe në vazhdim vijon analiza komparative e nivelit të borxhit shtetëror dhe publik në raport me PBB-në, krahasuar me Strategjinë e reviduar të menaxhimit të borxhit publik 2023-2027.

	РСЈД 2023-27					СЈД 2024-28									
	Ревидирана стратегија за управување со јавен долг 2023-2027					Стратегија за управување со јавен долг 2024-2028					отстапување (во п.п)				
	2023	2024	2025	2026	2027	2023	2024	2025	2026	2027	2023	2024	2025	2026	2027
како % од БДП															
Државен долг	51.1	51.9	51.5	50.2	49.5	52.2	53.4	52.2	50.8	51.3	1.1	1.5	0.7	0.6	1.8
Јавен долг	60.6	61.8	60.2	57.8	56.1	61.0	63.2	61.0	58.6	58.2	0.4	1.4	0.8	0.8	2.1

Извор: Министерство за финансии и проекти на Министерство за финансии (*)



7. Risqet fiskale dhe analiza sensitive

Projeksionet afatmesme ekonomike dhe fiskale shoqërohen gjithmonë me shkallë të caktuar pasigurie dhe risqesh. Materializimi eventual i atyre risqeve, të cilat supozojnë kushte të ndryshme nga ato të marra si bazë për projeksionet afatmesme të diskutuara më sipër, do të rezultonte në shmangie të skenarit bazë afatmesëm, përkatësisht realizim të ndryshimeve kryesore fiskale. Prandaj, në këtë pjesë të Strategjisë fiskale analizohen efektet e mundshme të realizimit eventual të disa risqeve kryesore makrofiskale në deficitin buxhetor dhe në borxhin shtetëror. Gjithashtu, në këtë pjesë analizohet ekspozimi i borxhit të qeverisë ndaj riskut të tregut, si dhe efekti i strategjive të ndryshme për financimin në nivel të borxhit, shpenzimet për servisimin e borxhit dhe strukturën e portofolit.

7.1 Risqet makrofiskale dhe sensibiliteti i deficitit buxhetor dhe borxhit shtetëror

Në këtë pjesë të Strategjisë fiskale jepet pasqyrë sensibilitetit të rezultateve të analizës së sensibilitetit ndaj ndjeshmërisë së deficitit buxhetor dhe nivelit të borxhit shtetëror ndaj realizimit eventual të katër risqeve kryesore të identifikuara për politikën fiskale në periudhën afatmesme. Gjithashtu, të gjitha risqet analizohen pjesë-pjesë, ndërsa në të gjithë skenarët supozohet mungesa e shmanigieve të tjera nga skenari bazë dhe realizimi vetëm i risqeve të caktuara:

- Skenari 1 - Rritja e ulur ekonomike;
- Skenari 2 – Të hyra tatimore më të ulëta për 5%;
- Skenari 3 - Realizimi më i ulët i shpenzimeve kapitale për 25%;
- Skenari 4 - Servisimi i detyrimeve në bazë të garancive të mjeteve të dhëna nga Buxheti i RMV-së;
- Skenari 5 – Risqet e pushtetit vendor dhe
- Skenari 6 – Risqet fiskale të punës rrjedhëse të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive tregtare në pronësi shtetërore.

Duke marrë parasysh se projeksioni bazë fiskal afatmesëm bazohet në supozime të caktuara makroekonomike, ato vlerësohen si faktor parësor me ndikimin potencial në lëvizjet fiskale. Prandaj, si skenar i parë risku, supozojmë materializimin e risqeve negative të lidhura me rigozitetin e marrëdhënieve ndërkombëtare ekonomike dhe politike, vazhdimin e presioneve inflacioniste dhe shpenzimeve më të mëdha për financim, të cilat përkeqësojnë ambientin global dhe rrisin pasigurinë për perspektiva ekonomike, që ndikojnë negativisht në kërkesën e jashtme dhe në kërkesën vendore, përkatësisht në investime dhe konsum. Sipas këtij skenari, projeksioni për rritjen mesatare të PBB-së reale ndërmjet viteve 2024 dhe 2028 është 1.3 pikë përqindje më i ulët se në skenarin bazë. Njëkohësisht, rritja eventuale më e ulët ekonomike do të implikojë edhe realizim më të ulët të komponentit ciklik të të hyrave buxhetore. Prandaj, krahasuar me projeksionin bazë, ky skenar çdo vit do të rezultonte mesatarisht në deficit buxhetor më të madh me 0.7 pikë përqindje të PBB-së, ndërmjet viteve 2024 dhe 2028, ndërkohë që borxhi shtetëror do të ishte 5.8 p.p më i lartë i PBB -së në fund të vitit 2028.


Si skenar i dytë, supozohet arkëtim i reduktuar i të hyrave tatimore për 5% në nivel vjetor, krahasuar me projeksionin bazë. Në kushtet e nivelit të pandryshuar të shpenzimeve buxhetore dhe rritjes ekonomike të pandryshuar, të hyrat e të reduktuara nga tatimet do të kontribuonin në rritjen e deficitit buxhetor mesatarisht për 0.9 pikë përqindje të PBB-së në nivel vjetor në periudhën nga viti 2024 deri në vitin 2028, krahasuar me projeksionin bazë, ndërsa borxhi shtetëror do të ishte më i lartë për 4.2 pp. e PBB-së në fund të vitit 2028, krahasuar me projeksionin bazë.

Në skenarin e tretë, supozohet realizim më i ulët i shpenzimeve kapitale, përkatësisht realizim i tyre në nivel prej 75% krahasuar me projeksionin bazë të paraparë, i cili është i ngjashëm me arritjet në të kaluarën. Realizimi i ulur i shpenzimeve kapitale do të kishte pasoja negative ndaj rritjes së investimeve bruto, rrjedhimisht me këtë edhe ndaj rritjes së aktivitetit ekonomik në raport me skenarin bazë mesatarisht për 0.6 pikë përqindjeje në nivel vjetor. Ky skenar do të ndikonte negativisht edhe në të hyrat tatimore, të cilat do ta tejkalonin efektin e uljes së shpenzimeve. Prandaj, sipas këtij skenari, deficitit buxhetor do të ishte mesatarisht më i lartë për 0.3 pikë përqindje të PBB-së gjatë periudhës së parashikimit, krahasuar me projeksionin bazë, ndërsa borxhi shtetëror do të ishte më i lartë për 2.8 p.p. e PBB-së në fund të vitit 2028, krahasuar me projeksionin bazë.

Skenari i katërt supozon se detyrimet në bazë të kryegjësë dhe interesit të huave të garantuara nga shteti do të servisohen plotësisht nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, që është supozim ekstrem. Realizimi eventual i këtij skenari ekstrem do të shkaktojë rritje të nivelit të shpenzimeve buxhetore në periudhën e ardhshme. Në kushtet e nivelit të pandryshuar të të hyrave buxhetore dhe rritjes ekonomike të pandryshuar, kjo do të kontribuonte në rritje të deficitit buxhetor mesatarisht për 1 p.p. të PBB-së në nivel vjetor në periudhën 2023 - 2028 krahasuar me projeksionin bazë, ndërsa borxhi shtetëror në fund të vitit 2028 do të ishte më i lartë për 5.8 p.p. krahasuar me projeksionin bazë. Gjithashtu, efekti i këtij skenari ndaj borxhit do të ishte i pranishëm në të gjithë periudhën afatmesme.

Në mënyrë të përmbledhur, realizimi i secilit prej katër skenarëve të riskut, të cilët pasqyrojnë risqet kryesore makrofiskale të identifikuara në periudhën e ardhshme, në pjesën më të madhe do të rezultonte në efekte relativisht të kufizuara mbi deficitin buxhetor dhe borxhin shtetëror (Grafiku 16). Më konkretisht, në asnjë rast nuk cënohet qëndrueshmëria e politikës fiskale në periudhën afatmesme.

Grafiku 16: Analiza e sensibilitetit të deficitit buxhetor (majtas) dhe borxhit shtetëror (djathtas) mbi risqet kryesore makrofiscale (në % të PBB-së)



Sipas skenarit të pestë, puna financiare e komunave shoqërohet me risqe që më së shumti paraqiten si vlera të rritura të detyrimeve të maturuara të papaguara dhe plotësim i kushteve të jostabilitetit financiar.

Në drejtim të rritjes së disiplinës financiare të komunave, uljes së borxheve dhe punës së amviserive, parashihen masa reale për planifikimin të të hyrave dhe shpenzimeve të komunave, racionalizimin e punës dhe uljen e shpenzimeve të panevojshme, servisimin e rregullt të detyrimeve, disiplinën më të madhe financiare, shpalljen e jostabilitetit financiar, emetimin e fletobligacioneve të komunave dhe analizën e detyrimeve ekzistuese të komunave dhe ndërmarrjeve publike. Rritja e kontrollit nga shteti sigurohet nëpërmjet mbikëqyrjeve që i kryen Inspektimi Financiar nga pikëpamja e respektimit të dispozitave të Ligjit të Paraqitjes dhe Evidentimit të Detyrimeve, Ligjit të Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale dhe Ligjit të Disiplinës Financiare.

Sipas të dhënave nga Sistemi elektronik i paraqitjes së detyrimeve për periudhën e analizuar, vërehet rritje e detyrimeve të njësitë shfrytëzuese në nivel lokal, ndërsa, nga ana tjetër, te komunat dhe ndërmarrjet publike lokale, vërehet rënie e detyrimeve.

Ministria e Financave monitoron performancën financiare të komunave në nivel tremujor, në bazë të raporteve financiare periodike të marra dhe të të dhënave për llogaritë e bllokuara. Sipas këtyre të dhënave të analizuara, në tremujorin e tretë të vitit 2023, 15 komuna i kanë plotësuar kushtet për jostabilitet financiar (Haraçina, Vasileva, Vrapçishti, Gostivari, Dibra, Dellçeva, Zhelina, Krivogastani, Ohri, Pehçeva, Resnja, Struga, Tetova, Çeshinovë - Oblesheva dhe Saraji). Në pjesën e aktiviteteve që kanë të bëjnë me rritjen e disiplinës dhe efikasitetit financiar, uljen dhe riprogramimin e detyrimeve të maturuara dhe të papaguara të njësive të vetëqeverisjes lokale, Ministria e Financave do t'u japë mundësi komunave të shfrytëzojnë një nga tre instrumentet e kredisë, për tejkalimin e problemeve me detyrimet e maturuara dhe të papaguara, përkatësisht:

- shfrytëzimin e kredisë së kushtëzuar (standby) nga Ministria e Financave;
- emetimin e fletobligacionit të komunave për blerës të njohur - Ministria e Financave dhe
- emetimin e fletobligacionit strukturor nga Ministria e Financave.

Kjo mënyrë e zgjidhjes së problemeve me detyrimet e pashlyera lidhet me plotësimin e kushteve për shpalljen e jostabilitetit financiar. Njëkohësisht, në këtë pjesë përforcohet e gjithë procedura që nga momenti i shpalljes deri në tejkalimin e jostabilitetit financiar. Me ndryshimet e fundit në Ligjin e Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, njëri prej kushteve për përmbushjen e paqëndrueshmërisë financiare bëhet më rigoroz, përkatësisht përqindja (80%) e vlerës së përgjithshme të detyrimeve të papaguara mbi 60 ditë në periudhë gjashtëmuajore, në vazhdimësi për çdo muaj, me gjendje në fund të muajit, ulet dhe nuk duhet të tejkalojë 60% të të hyrave të realizuara të buxhetit bazë të komunës në vitin paraprak, duke filluar nga viti 2024. Përqindja në vitin 2023 nuk duhet të kalojë 70% të të hyrave të realizuara të buxhetit bazë të komunës në vitin paraprak.

Skenari i gjashtë mbulon shpenzimet që lidhen me financimin e krizës energjetike, pasiguritë globale të shkaktuara nga situata në Ukrainë, si dhe rritjen e vazhdueshme të çmimeve në ambientin ndërkombëtar.

Në periudhën e kaluar dhe në drejtim të mbrojtjes së ekonomisë vendore dhe standardit të qytetarëve, nëpërmjet përkrahjes së SHA “EMV” me mjete të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u siguria subvencionimi i çmimit të energjisë elektrike, si dhe prodhimit në sasi të mjaftueshme për përcimin e pandërprerë dhe në kohë për familjet dhe konsumatorët e vegjël. Në këtë mënyrë u zbutën pasojat e inflacionit të lartë, i cili, nga ana tjetër, ndikoi shumë në përkeqësimin e likuiditetit të ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare, të cilat, nga ana tjetër, u futën në deficitin buxhetor dhe borxhin publik.

Duke marrë parasysh se masa të tilla nuk janë të qëndrueshme në afat të mesëm, në periudhën e ardhshme organet kompetente të SHA “EMV” duhet të fokusohen në masat që parashohin rritje të të hyrave nga puna dhe kontroll të rreptë të shpenzimeve nga puna.

Efektet e ekonomisë botërore dhe kriza energjetike patën ndikim edhe në punën e SHA “Ekonomia e Ujërave e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, SHA “Posta e Maqedonisë së Veriut” dhe SHA “HM Transport”, të cilat në periudhën e kaluar ishin ballafaquar me pamundësinë për t’i shlyer detyrimet rrjedhëse, kryesisht shpenzimet e energjisë elektrike dhe shpenzimet e pagave të të punësuarve. Sipas kësaj dhe në drejtim të sigurimit të stabilitetit financiar dhe pavarësisë në punë, duhet të ndërmerren aktivitete për vazhdimin dhe përmbushjen e masave të parapara në Planin e qëndrueshmërisë fiskale dhe përkrahjen e rritjes ekonomike, të cilat përfshijnë konsolidimin e të hyrave dhe shpenzimet.

Përkrahja buxhetore në periudhën 2021 - 2023 si përqindje në PBB, e destinuar për zbutjen e goditjeve të çmimeve, përkatësisht subvencionimin e Sistemit të energjisë elektrike për ruajtjen e standardit jetësor të qytetarëve dhe likuiditetin e kompanive, arriti në rreth 0.8% në vitin 2021, 1.8 % në vitin 2022 dhe 0.6% në vitin 2023, me ç’rast nëse eliminohen këto shpenzime, deficitin buxhetor është në kuadër të rregullës fiskale.

Rezultatet e pritshme nga projeksionet afatmesme

" Në periudhën afatmesme, pavarësisht risqeve dhe pasigurisë aktuale, politika fiskale do të vazhdojë drejt konsolidimit, ristrukturimit dhe optimizimit të mëtejshëm të të hyrave publike dhe shpenzimeve duke ulur gradualisht deficitin buxhetor dhe borxhin publik, duke nxitur aktivitetin ekonomik nëpërmjet shpenzimeve kapitale dhe investimeve në infrastrukturë, duke përmirësuar kushtet për zhvillimin e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

" Korniza e ridefinuar buxhetore siguron përgjigje fiskale adekuate në kohë dhe pozicion të

qëndrueshëm të financave publike.

" Realizimi i shpenzimeve kapitale dhe projekteve infrastrukturore në fushat prioritare, në përputhje me politikat qeveritare, do të gjenerojë efekte pozitive multiplikative në rritjen ekonomike në periudhën afatmesme dhe do ta përshpejtojë konvergjencën reale ekonomike drejt ekonomive evropiane.

" Optimizimi i shpenzimeve të huazimit është në drejtim të uljes së barrës buxhetore të pagesave të interesit në afat të shkurtër dhe të mesëm.

" Ruajtja e stabilitetit makroekonomik dhe qëndrueshmërisë fiskale do të krijojë kushte më të favorshme për dinamizimin e aktivitetit ekonomik.